ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues · Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 3 TETOR 2026 · NUMËR 406 · VITI IX I BOTIMIT · ÇMIMI 50 LEKË · WWW.EXLIBRIS.AL · EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL · BOTIM I ONUFRI SHPK

Më 3 tetor të këtij viti, ora 09.25, do të mbushen 77 vjet – një jetë njeriu! – nga kalimi në amshim i Mid'hat Frashërit, *alias* Lumo Skëndo, në hotelin Winthrop të New-York-ut. Vepra e tij poliedrike, poliglote dhe politike, një plejadë shkrimesh, por edhe angazhimesh e veprimesh, e ka paracaktuar Mid'hat Frashërin të shihet si një *Janus Bifrons* kur vjen fjala të vlerësimet e pasardhësve; një personalitet shenjues, mbi mijëra të tjerë i dallueshëm, kryet e të cilit janë mësuar të mbajnë si kurorën me gjemba të mërisë në të gjallë, ashtu edhe dafinat dhe palmat postume të mirënjohjes publike. Shtegtar i kreshtave të thepisura e të braktisura, ku dielli pak ndriçon e ku ngricat ndodh të jenë të përjetshme, Mid'hat Frashëri mbetet po aq një personazh historik qendror, sa edhe një personalitet vetmitar e skajor.

PALMAT E MID'HAT BEUT

THOMAS FRASHËRI dhe AJTEN TOPTANI

Njihuni me shkrimtarët e ftuar nga Tirana Gate

Akuarel nga Ajten Toptani (fragment)

Një shkrim i shkrimtarit Naum Prifti (1982)

Tetori, muaji i letërsisë dhe arteve

SHËNIME MBI LIBRAT

Dy vëllimet e veprës së Vinçens Markut

Buzuku i lehtëlexueshëm: Një kërkim që ripërkufizon fushën e studimeve buzukiane

Nga Matteo Mandalà (fq. 10)

Fjalëformimi i neologjizmave në romanin "E kuqja e demave" të Mira Meksit

Nga Kadia Dedja (fq. 5)

Duke lexuar poezinë e Klara Kodrës

KUR FJALA KTHEHET NË DASHURI

Nga Shefkije Islamaj (fq. 9)

Rreth librit të Arbër Ahmetaj "Gruaja e ambasadorit", botoi RLBooks, Bruksel 2026

Para se të mbërrijë tragjedia, ka ndodhur jeta

Nga Luljeta Dano (fq. 8)

#RivetingReviews "Saga e Sarajevës" të Çapalikut, përkthyer në anglisht nga Vlora Konushevci

Çapaliku të çon me mjeshtëri drejt një zgjidhjeje befasuese e të papritur

Nga Morelle Smith (fq. 15)

ERSI SOTIROPOULOS

Çfarë mbetet nga nata

Përktheu nga greqishtja: Maklena F. Nika (fq. 18)

Kur në vitin 2015 u botua romani im *Çfarë mbetet nga nata*, për tri ditët e Konstandinos Kavafisit në Paris, në qershor të vitit 1897, shumëkush më pyeste se çfarë ishte e vërtetë dhe çfarë e sajuar në këtë libër. Më pyesnin gjithashtu përse kisha zgjedhur këtë udhëtim në Paris në vitin 1897 dhe jo udhëtime të tjera të tij, për të cilat ekziston më shumë material, madje edhe poezi, si udhëtimi në Konstandinopojë (1882-1885) ose vizita e tij e parë në Athinë, në vitin 1901?

MARTINA HEFTER

Zero

(fq. 22)

fragment nga romani

Përktheu nga gjermanishtja Anna Kove

DAMIR KARAKAŠ: Ballkani gjithmonë ka përjetuar një post-përvojë të tragjedisë greke

(fq. 20)

Intervistoi: Liridon Mulaj

BIBLIOTEKË

Xhelal Tosku (fq. 12)
I vetëm pa miq pa shokë

Katerina Gogu (fq. 14)
Si më vështron kështu
Përktheu: Armela Hysi

Besa Kalaja (fq. 14)
Vdekjet e vogla

Behar Jacaj (fq. 16)
Pas shembjes!

Klevisa Bardeli (fq. 17)
"/5/2025"

Arben Meksi (fq. 13)
Karikatura e së shtunës

Vijon nga numri i kaluar

Roli i huazimeve në formësimin e gjuhës dhe kulturës moderne shqiptare

Nga Diana Kristo (fq. 6)

Pse flasim kaq pak për përkthimin e letërsisë joartistike?

Nga Jola Tasellari (fq. 23)

Libri shqip në SHBA & KANADA

Dërgesa të shpejta dhe të sigurta

www.alblibris.al

alblibris Powered by Onufri

PALMAT E MID'HAT BEUT

THOMAS FRASHËRI
Kancelar i Urdhrave dhe Medaljeve të Republikës
Laureat i Çmimit Kombëtar "Lumo Skëndo" 2025

AJTEN TOPTANI
Ekspert në Kancelarinë e Urdhrave dhe Medaljeve të Republikës

Më 3 tetor të këtij viti, ora 09.25, do të mbushen 77 vjet – një jetë njeriu! – nga kalimi në amshim i Mid'hat Frashërit, *alias* Lumo Skëndo, në hotelin Winthrop të New-York-ut.

Vepra e tij poliedrike, poliglote dhe politike, një plejadë shkrimesh, por edhe angazhimesh e veprimesh, e ka paracaktuar Mid'hat Frashërin të shihet si një *Janus Bifrons* kur vjen fjala të vlerësimet e pasardhësve; një personalitet shenjues, mbi mijëra të tjerë i dallueshëm, kryet e të cilit janë mësuar të mbajnë si kurorën me gjemba të mërisë në të gjallë, ashtu edhe dafinat dhe palmat postume të mirënjohjes publike. Shtegtar i kreshtave të thepisura e të braktisura, ku dielli pak ndriçon e ku ngricat ndodh të jenë të përjetshme, Mid'hat Frashëri mbetet po aq një personazh historik qendror, sa edhe një personalitet vetmitar e skajor.

Një "margjinal", teknikisht.

Për të zgjeruar fushëpamjen studimore mbi Mid'hat Frashërin, si edhe mbi shumë të tjerë të ngjashëm me të, është e rëndësishme t'u biesh rreth e rrotull margjinave, skajeve të jetëve të tyre. Lypset t'u përshkohen kreshtat ku ata gjetën paqe dhe distancë nga e zakonshmja, t'u vizitohen kopshtet intime, t'u shquhet, t'u preket e t'u kuptohet çka për ta ishte çiltazi apo fshehtazi ideale, e dashur, e vlefshme, e shenjtë, e paprekshme; nga njerëzit te gjësendet, nga idetë te simbolet. Hollësi më hollësi. Skaj më skaj.

Një qasje e tillë të çon te instrumentet e hulumtimit dhe interpretimit që përdorin sot ata të cilët mund të quhen "historianë të margjinalitetit" - të skutave dhe të skajeve, e për rrjedhojë, të vetë të skajuarve. Instrumente hulumtimi dhe interpretimi të një mikrohistorie të mentaliteteve shpënë deri në limite, të cilat përligjin, duke parafrazuar një specialist, studimin e subjekteve të pakta në numër, por të karakterizuara nga një veçori: të qenit konstitutive të skajeve sa të largëta aq edhe të larta të shoqërisë, me një plasticitet mbijetese përkundër krizave dhe me aftësi për të qëndruar vetvetja në mënyrë të palëkundur[1].

I izoluar dhe "i skajuar", dokumenti diplomatik që përbën pikënisjen e këtij studimi do të kishte mbetur një gjurmë e thatë nëse do të ishte parë dhe hulumtuar me një sy përgjithësues. Mirëpo i parë nga "skajet" e një jete, një veprimtarie dhe një tradite të "skajuari" gjithënjëherësh, ai merr dimensionet e një burimi të mirëfilltë ndihmës për historinë dhe prosopografinë, një çelës që e gjen më në fund portën të cilën duhet të çkyçë, duke i hapur njëkohësisht rrugën këndvështrimeve të reja brenda të njëjtit stok ekzistues dijesh[2]. Promovimin e një qasjeje të tillë i ka dhënë porosi ligji, në njëfarë mënyre, Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve të Republikës, si "konservator kujdesi", për të ruajtur "*kujtesën materiale të dekoratave dhe të mbajtësve të tyre*". Në diapazon të kësaj porosie u ndërmor edhe shkrimi që i propozohet lexuesit.

Në skajet e jetës së tij, i skajuari "Mid'hat Bej" ose "Zoti Mid'hat" ka mbajtur me egon, *aura*-n, vetëvlerësimin, nderin – në të gjitha ngjyresat që i jepte këtij nocioni polisemik Lucien Febvre[3] –, marrëdhënie të cilat nuk është e lehtë t'i depërtosh. Por një gjë është e sigurt: imazhi i tejçuar nga jeta dhe veprimtaria e tij plot tallaze, ka mbetur ajo e një refraktari ndaj nderimeve, e një përbuzësi të vlerësimeve. Një imazh i kultivuar nga vetë Mid'hati, i ndjeshëm ndaj efektit të misterit, parakusht i dinjitetit dhe i autonomisë personale, sepse imunizues ndaj parodive urbane dhe lajthitjeve tëhuajëzuese të mexhlisit të kohës së tij. Nën cipën ironikisht proletare të cilësimit "dyqanxhi", që i ngjishte vetes sa herë i bënte bisht anëmarrjeve të rrezikshme ku e ngusnin të faktorizohej[4], spikaste ndoshta edhe më shumë natyra skajore e elitarit, e sojliut tekanjoz por të kthjellët në qëndrime, e "konservatorit romantik" siç është quajtur dikur[5], ose e "liberal-konservatorit" – siç do të konsiderohej sot pas kallëpeve bashkëkohore – plot kundërthënie, por pa lëshime.

Ishte Mid'hati ai, i cili, kur në dhjetor 1923 iu lutën të merrte drejtimin e Qeverisë, u përgjigj me shpërfillje: "*Nuk mund ta çnderonj shtëpinë time*"[6]; i njëjti me Mid'hatin, i cili në mërgim i mëkonte mbesës këto fjalë në frëngjisht për ta nxitur në luftën kundër totalitarizmit:

"*Il m'est impossible de ne pas plaindre mon pays; nous avons cette obligation Selma, non seulement moi, mais toi aussi, car nous sommes des Frasheris, et que nous ne pouvons pas être des mécréants*". (*E kam të pamundur të mos t'i qaj hallin vendit tim; e kemi këtë detyrim Selma, jo vetëm unë, por edhe ti, sepse ne jemi Frashërllinj dhe sepse nuk mund të jemi të pafé*)[7].

Mid'hati i vetëcilësimeve "ouvrier"[8] dhe "dyqanxhi", ishte po i njëjti që në një tjetër korrespondencë të panjohur drejtuar Selma Zavalanit i përgjërohet të mos harrojë se nga vjen:

"*Frëngu thotë Noblesse oblige. Do të shtonj se gjaku ujë s'bëhet*"[9].

Shumëkush ia ka kritikuar Z. Mid'hat prirjen, të cilën e fshihte jo gjithmonë me shkathësi, për të mos shkelur mbi hierarkitë shoqërore të sojit e të klasës, mbi simbolet e epërsisë në udhëheqësi të elitës. Që të ecte "me hapin e kohës", ai duhej t'i sakrifikonte ato në emër të idealeve gjithëpërfshirëse, kryesisht egalitarizmit, të cilat përparonin natyrshëm bashkë me ngritjen e shtetevekombe. Por askush nuk ka guxuar të vërë në dyshim sinqeritetin e parimeve të tij demokratike, thellësisht republikane madje, e respektit gati fetar ndaj të drejtave kombëtare dhe, njëkohësisht, ndaj lirive themelore të individit, tok me besimin që ushqente ndaj progresit lëndor dhe zhvillimit njerëzor integral.

"*Ai ishte një republikan i vendosur* (...) *me sjellje të rrepta, një konservator romantik, i përshkuar nga një patriotizëm i zjarrtë dhe një besim katonian në virtytet e aristokracisë*"[10].

Milan Šufflay, në një fotografi-portret që i dërgonte, i skiconte në dedikim Mid'hat beut trajtat e një "kalorësi" që mishëronte idealet e kohëve antike, plot me fisnikëri morale, vlera, elegancë dhe shquarsi vetjake (καλοκἀγαθία):

"*16.I.1931.*

Mikut tim Mid'hat Frashëri (Lumo Skendo), plot me καλοκἀγαθία klasike, xhentëlmen modern i përsosur, i kushtoj këtë kujtim të qëndrimit tim në Tiranë"[11].

"Kalorësi" Mid'hat nuk u bë asnjëherë Kalorës me dekret, sa qe gjallë, nga shteti që aq shumë kontribuoi të mëkëmbej. Duke lënë mënjanë konfliktet dhe hatërmbetjet personale me potentatët e kohës, me raste fort akute[12], është e qartë se dekorimet në urdhrat e kalorësisë të Republikës, e më pas të Monarkisë, atij i janë shmangur dhe ai vetë as që i ka mëtuar.

Nuk ka dyshim se Z. Mid'hat e dinte që shihej si një simbol i gjallë:

"*Gëzohet dhe nderohet ajo Djalëri, kur sheh se Dera e Frashërit jua ka lënë Zotërisë tuaj trashëgimin e idealit kombëtar, q'i përkitte në kohërat më të errëta të regjimit despotik*".

(Letër e Avni Rustemit, 1920)[13]

E ndiente, jo vetëm për shkak të respektit që u frymëzonte të tjerëve:

"*Një fisnikëri aq e madhe si ajo e zotnis suaj është shumë zor të harrohet*".

(Letër e Kristaq Tutulanit, 1936)[14]

"*Kishim një adhurim edhe për djalin e Abdyl Frashërit që ishte Mitat beu, ose Lumo Skëndoja* (...) *Ai ishte i biri i Abdyl Frashërit. Plak i mbajtur mirë, me flokë të bardhë, veshur me elegancë* (...) *Respekti për Lumo Skëndon ishte i pakufishëm*".

(Musine Kokalari)[15]

por edhe nga përmasat që merrnin, nganjëherë në mënyrë të tepruar, kritikat që i adresoheshin:

"*Nuk mjafton të kesh emrin dhe të krenohesh për gjakun fisnik të Frashërllinjve,*

Mid'hat Frashëri i dekoruar me Palmat e Oficerit të Arsimit Publik
(akuarel nga Ajten Toptani, 2026)

---

[1] MENSION-RIGAU, Eric: *La noblesse en France est une survivance, Le Figaro*, 15 shtator 2026.
[2] SCHMITT, Jens Oliver: *Tito und Ceausescu machten viel Geld mit ihrer Schaukelpolitik: Ein Gespräch über die Geschichte des Balkans – und sein schlechtes Image, Neue Zürcher Zeitung*, 29 korrik 2026.
[3] FEBVRE, Lucien: *"Honneur et Patrie". Une enquête sur le sentiment de l'honneur et l'attachement à la patrie*, Librairie Académique Perrin, Paris, 1996.
[4] FRASHËRI, Mid'hat: *Vepra të zgjedhura*, vëll. IX (përg. Uran Butka), Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo"/ Onufri, Tiranë, 2024, f. 203.
[5] AMERY, Julian: *Sons of the Eagle. A Study in Guerilla War*, Macmillan & Co. Ltd, London, 1948, f. 189.
[6] VLLAMASI, Sejfi: *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)* (përg. Marenglen Verli), bot. 2të, Neraida, Tiranë, 2000, f. 355.
[7] Letër e pabotuar e Mid'hat Frashërit dërguar Selma Zavalanit nga Reggio, 15 mars 1946, (verso). Kortezi e Z. Bejtullah Destani.
[8] FRASHËRI, Mid'hat: *Vepra të zgjedhura*, vëll. IX, *vep.cit.*, f. 212.
[9] Kartolinë e pabotuar e Mid'hat Frashërit dërguar Selma Zavalanit nga Roma, 20 shtator 1946, (verso). Kortezi e Z. Bejtullah Destani.
[10] AMERY, Julian: *Sons of the Eagle*, *vep.cit.*, po aty.
[11] AQSH, F. 35, D. 36/7, 1662.1 (verso).
[12] FRASHËRI, Mid'hat: *Vepra të zgjedhura*, vëll. IX, *vep.cit.*, ff. 178-179.
[13] FRASHËRI, Mid'hat: *Vepra të zgjedhura*, vëll. VI, Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo"/ Onufri, Tiranë, 2021, f. 323.
[14] FRASHËRI, Mid'hat: *Vepra të zgjedhura*, vëll. IX, *vep.cit.*, f. 176.
[15] KOKALARI, Musine: *Një Yllësi*, vëll. I (përg. Uran Butka), Instituti i Studimeve "Lumo Skëndo", Tiranë, 2025, ff. 192; 194.

kur veprimet që bëni të dëmshme janë për faqe të zezë. Në veprimet e lavdinë e të parëve ne kemi pjesën tonë dhe duhet të përpiqemi që t'u ngjajmë atyre dhe kemi barrën që t'u zbardhim faqen, të ecim në gjurmët dhe të shtojmë bëmat, në qoftë se duam të jemi të tyre".

(Letër e Bajo Topullit, 1907-1908)[16]

Si i tillë, Z. Mid'hat duhej të kujdesej që emri i tij të mos përballej e, në fund të fundit, të mos "asgjësohej" nga simbole që lëshonin mbi tokë hijen e tyre. Urdhrat e kalorësisë në atë kohë ishin vërtet, dhe mbeten edhe sot e kësaj dite, shenja honorifike, por në thelb ata e ruajnë natyrën e bashkësisë së të barabartëve, të dallueshëm mes tyre vetëm prej llojit dhe rëndësisë së meritës dhe kontributeve: të atyre meritave dhe kontributeve, megjithatë, që shteti i konsideron të denja për vlerësim.

Në vitin 1900, në faqet e *Kalendarit Kombiar*, Mid'hat beu, atëherë në të njëzetat, nuk pati drojë të shkruante një pamflet kundër parësisë, në të cilin qesëndiste pa u ndalur gjatë edhe "nishanet", dekoratat, simbolet honorifike që përdorte sulltani për të joshur në bindje krerët e Shqipërisë:

"*Qeverija, kur do që t'i bëjë vendit tënë no një të ligë, u thotë parësisë "ndihmëmi pa t'u ap nishane, rytbe dhe memurijet", edhe parësia që, lakmimi u-nxi sytë, gënjehenë, bëhenë një me qeverinë, dhe, mbase pa dashurë, bëhenë nëpërka për të kafshuarë e për të vrarë vëllezërit e tyre*!"[17].

Sa më sipër do të mjaftonte të dilej në përfundimin e përgjithshëm se Mid'hat be Frashëri ka pasur njëfarë alergjie ndaj simboleve-funksione shtetërore, ndaj elementit honorifik në hapësirën publike. Në të vërtetë, mosha e re lënë mënjanë, përçmimi i "mehmureve" nga ana e atij, i cili, vetëm një vit pas shkrimit të sipërcituar u punësua në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Stamboll dhe më 1905 mori "mehmur" jo më pak se Drejtorinë politike të vilajetit të Selanikut, lypset të relativizohet[18]. Njësoj vlen të nuancohet edhe "alergjia" ndaj simboleve honorifike.

Mid'hat beu e kuptonte në fakt krejt mirë peshën dhe vlerën e këtyre simboleve, aspektin e tyre arketipal, magjinë dhe efektet irracionale, subjektive dhe emocionale me të cilat janë të mbarsura. Por, në ndjeshmërinë e tij, simboli përfaqësonte diçka që duhet të ishte në koherencë me angazhimin dhe idealin e brendshëm; ai duhet të bënte bashkë brenda vetes (*συμβάλλω*), në mënyrë koherente dhe kuptimplotë, përjetimet kontradiktore të nderit vetjak, vetëvlerësimit dhe modestisë. Vlera që ai i njihte simbolit ishte intime dhe madhështore njëherazi, mjaftueshëm "e shenjtë" sa për të mos u trajtuar në mënyrë folklorike dhe me mendjelehtësi. Për t'i dhënë fund një polemike të tejzgjatur shkaktuar nga një shkrim, ku një flamur i dhuruar nga Aladro Kastrioti cilësohej prej tij si "*levere e ndyrë*", Mid'hat Frashëri i kujton patriotëve domethënien e simbolikës së shenjave:

"*Vetëm përdorimi është i shenjtë; ngjyra dhe pëlhura padyshim s'kanë asnjë dëftim. I përdorur në një luftë, në një punë dhe në një rasje patriotike, thjesht një pëlhurë merr një karakter të shenjtë. Përkundër, me ngjyrat e një flamuri mund të bëhen edhe më të thjeshtat dhe më të poshtërat e gjërave* (...)

(...) *Simbolet e sotme janë të shenjtëruara, se i ka shenjtëruar jo ngjyra dhe forma, po përdorimi ose shërbimi*"[19].

Palmat e Oficerit të Arsimit Publik
në vitet kur është dekoruar Mid'hat Frashëri

Citimi i mësipërm jep dorë të kuptohet një moment skajor i jetës së Mid'hat be Frashërit, mesa duket i rëndësishëm për të, por deri më sot krejt i panjohur. Më 3 prill 1923, kreu i Legatës franceze në Shqipëri, me seli në Shkodër, i drejtohej zyrtarisht me një shkresë ministrit të atëhershëm të Punëve të Jashtme, Pandeli Evangjelit. Bëhet fjalë për ministrin Jean Béguin-Billecocq, diplomat i rrahur herët me andrallat levantine, i cili do të luajë një rol politiko-diplomatik jo të vogël në Shqipëri deri në vitin 1928. Kryetari i Republikës Shqiptare do ta dekorojë Oficer të Madh të Urdhrit të Skënderbeut. Béguin-Billecocq-u çoi në fund, atë vit, plotësimin e një dëshire të Z. Mid'hat, ashtu siç rezulton nga shkresa që po përcillet këtu e plotë në shqip.

"*Zoti Ministër,*

Z. i Ngarkuar me Punë ad interim i Shqipërisë në Paris i ka bërë me dije tani së fundmi Shkëlqesisë së Tij Zotit Kryetar të Këshillit dhe ministër i Punëve të Jashtme, dëshirën e Ahmet Mid'hat bej Frashërit (Ahmed Midhat Bey Fraschéri) për t'u pajisur me certifikatën e Oficerit të Arsimit Publik që i është akorduar më 1908, atëherë kur ai ushtronte funksionet e Drejtorit të Zyrës politike osmane në Selanik me emrin Mid'hat Bej (Midhat Bey).

Për t'iu përgjigjur kësaj dëshire, Shkëlqesia e Tij Zoti Kryetar i Këshillit më përcolli, dhe kam nderin t'ia dërgoj me këtë zarf Shkëlqesisë Suaj, një kopje (duplicata) të kësaj diplome, për të cilën do t'Ju isha mirënjohës të siguronit dorëzimin te i interesuari.

Lutem të pranoni, Zoti Ministër, etj. etj."[20].

Shkresa, e cila gjendet në Arkivin Diplomatik të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, është kërshërore. Kalimthi të vihet re përdorimi i emrave të dyfishtë: *Ahmed* (i denji për lavdërim), fare rrallë i përmendur, shoqëruar nga *Mid'hat* (bartësi i cilësive të lavdërueshme), traditë islame e parapëlqyer në Shqipëri, sidomos nga shtresat e larta.

Ajo që tërheq vëmendjen më shumë në këtë shkresë është megjithatë fakti që Mid'hat beu ka qenë i dekoruar nga Republika Franceze me Palmat e Oficerit të Arsimit Publik, madje në një moshë të re, 28 vjeç, në kohën kur drejtonte Zyrën politike osmane në Selanik. Me interes është gjithashtu fakti që i dekoruari ka "dëshiruar" të pajiset me një dublikatë të certifikatës 15 vjet pas ngjarjes. Pajisja me një dublikatë mund të vinte si pasojë e humbjes së diplomës origjinale. Tjetër shkak mund të ketë qenë mungesa e saj në momentin e dorëzimit të dekoratës, praktikë e rëndomtë në një kohë kur diplomat dërgoheshin shpesh pas aktit të dekorimit. Por në rastin në fjalë vihet re se kjo kërkesë nuk ka ndonjë qëllim praktik. Mid'hat beu nuk duket ta ketë vënë në punë certifikatën për të plotësuar dosjen e personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, madje as për t'i kërkuar Kryesisë së shtetit lejen për mbajtjen e dekoratës së huaj. "Dëshira" për të pasur një dublikatë duket se i përgjigjej më shumë një nevoje sentimentale: dokumentimin e një vlerësimi honorifik të cilin kishte plot arsye ta kishte për zemër. Jo sepse ai rezulton – deri më sot – i vetmi i kësaj natyre që Z. Mid'hat ka marrë gjatë jetës, por sepse, i dhënë nga Republika Franceze, ai merrte në sytë e tij vlerën e një simboli me një lloj "shenjtërie", "*jo nga ngjyra dhe forma, por prej përdorimit dhe shërbimit*".

E gjitha kjo meriton një shpjegim.

Oficeri i Arsimit Publik (*Officier de l'Instruction Publique*) ishte shkalla eprore e një vlerësimi honorifik të krijuar nga Napoleoni I Perandor më 17 mars 1808, i cili u kthye në dekoratë të mirëfilltë më 1866 nga Napoleoni III nën emrin e Urdhrit civil të Palmave Akademike. Në kohën kur Mid'hat beu është dekoruar, Palmat nuk ishin një dekoratë e rëndomtë, por një simbol luftarak, një flamur militant i shkollës publike përkundër arsimit privat të mbajtur nga kleri dhe rregulltarët. Palmat përbënin stimulin kryesor për të çimentuar në një komunitet merite të gjithë ata që kontribuonin me bindje në konsolidimin e shkollës së modelit francez: republikane, falas, e detyrueshme, laike. Urdhri çonte përpara një projekt universalizmi të arsimit, mbajtur mbi supe nga arsimtarët dhe arsimtaret e shkollës publike, të quajtur në atë kohë, me një shkelje syri ndaj përparëses së punës, "kalorësit e zinj të Republikës" (*les hussards noirs de la République*). Ishin ata që formonin "fabrikën e heronjve", nga e cila duhet të dilnin të edukuar, të formuar dhe të emancipuar, qytetarët e Francës republikane të Lirisë, Barazisë dhe Vëllazërisë[21].

Një model shkolle i cili përkonte pikë për pikë me atë që babai, Abdyli, dhe ungjit e Mid'hat beut – Naimi e Samiu – patën ëndërruar, ku më pak e ku më shumë, për Shqipërinë, e për të cilin u përpoqën me çdo mënyrë e pa u kursyer. Në fjalimin e tij mbresëlënës të 14 janarit 1878, në Parlamentin osman, Abdyl be Frashëri "*kërkoi zgjerimin sa më shpejt të rrjetit arsimor duke hapur shkolla plotore në fshatra, gjimnaze në qytete, kurse në kryeqytet një universitet të plotë dhe një akademi shkencore me një varg institutesh kërkimore*"[22]. Në disa numra të revistës osmane "*Hafta*" (Java), të cilën Mid'hati e lexonte që në fillimet e adoleshencës[23], Sami be Frashëri parashtronte nga ana e tij se arsimi publik ishte në rrënjë të lumturisë dhe të mirëqënies së një populli dhe se modeli për ta shpërhapur atë si duhet ishte shkolla republikane franceze e ngritur mbi idealet e Shekullit të Dritave. Vektori më i mirë për suksesin e tij, sipas Sami beut, mbetej mësimi i gjuhës frënge[24]. Më konkretisht, për sa i përket Shqipërisë, Samiu e zbërtheu modelin francez të shkollës publike në kapitullin XIII të "*Shqipëria, ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë*":

"*Gjithë katundetë e gjithë pshatratë a dy tre pshatra t'afërta bashkë duhetë të kenë shkolla të para dhe qytetetë të kenë nga më shumë se një, pas madhërisë së tyre. Gjithë djemt'e vashatë që më 7 vjeç e gjer më 13 do të jenë të shtrënguarë të venë domosdo në shkollë edhe ata qërtohen e të shtrëngohenë t'i dërgojnë. Mësimi do të jetë pa ndonjë pagesë, edhe të varfëret do t'u epenë edhe fletoretë e karta etj. pa pagesë. Në mest të çdo nëngastre do të jetë një shkoll'e dytë për djemt dhe një për vajzat*"[25].

Me fare pak përditësime, të njëjtin vizion për arsimin do të shpalosë, fjalë për fjalë, Z. Mid'hat, *alias* "Adriatiku", në një artikull botuar te "*Dielli*", më 25 maj 1921, me titull "*Arsimi duhet të jetë i detyrueshëm për të tërë fëmijët*"[26].

I ndikuar nga i tillë mjedis familjar, ku shkruheshin vepra voluminoze në

---

[16] TOPULLI, Bajo: *Topullarët e Gjirokastrës, Bajo e Çerçizi. Pararendësit dhe pasardhësit*, Albin, Tiranë, 2008, f. 143.

[17] *Sa e varfërë është sot Shqipëria. Si mund të shpëtojë nga kjo varfëri*, *Kalendari Kombiar*, 1900, f. 41.

[18] BUTKA, Uran: *Vepra madhore e Mid'hat Frashërit (Lumo Skëndo)*, në FRASHËRI, Mid'hat: *Vepra të zgjedhura*, vëll. I, Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo"/ Onufri, Tiranë, 2017, f. 18.

[19] FRASHËRI, Mid'hat: *Vepra të zgjedhura*, vëll. II, Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo"/ Onufri, Tiranë, 2018, f. 126.

[20] ADMEJP, D. 25, V. 1923, fl. 2.

[21] THIVEND, Marianne: *L'école républicaine et ses héros. Les institutrices et instituteurs décoré(e)s des "Palmes académiques" au début de la Troisième République*, në DUMONS, Bruno; POLLET, Gilles: *La fabrique de l'honneur. Les médailles et les décorations en France, XIX^e-XX^e siècles*, Presses Universitaires de Rennes, 2009, ff. 143-149.

[22] FRASHËRI, Kristo: *Abdyl Frashëri, Jeta, veprimtaria dhe shkrimet (1839-1892)*, Botimet M & B, Tiranë, 2013, f. 83.

[23] AQSH, F. 35, D. 2, V. 1893, fl. 8 (verso) (përkthimi nga Haki Sharofi më 1963).

[24] ÇOLLAKU, Shaban: *Mendimi iluminist i Sami Frashërit*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1986, ff. 112; 118; 137.

[25] FRASHËRI, Sami: *Vepra*, vëll. II (përg. Zija Xholi), Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1988, f. 76.

[26] FRASHËRI, Mid'hat: *Vepra të zgjedhura*, vëll. I, Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo"/ Onufri, Tiranë, 2017, ff. 399-400.

frëngjisht, madje edhe libra mbi historinë e Francës – si "*Histori e shkurtër e Francës*" (*Tarih-i Mücmel-i Fransa*) botuar nga Samiu më 1872 – dhe ku kushërinjtë më të mëdhenj shkonin të gjithë në shkolla franceze, Mid'hati përjetoi me idetë dhe gjuhën frënge një histori të vërtetë dashurie që në vitet e para të nxënies. Në një përkujtesë shkruar në osmanisht, kur ende nuk kishte mbushur 14 vjeç, ai kujtonte si vijon (sipas përkthimit të Haki Sharofit më 1963):

"*Në moshën 12-13 vjeç, mbrenda vitit qi erdhëm së parit në Këzëll-Toprak kam mësue me të ndjerin baban t'im* (...) *Histoire d'un petit homme – frëngjisht me përkthim, Imlai fransevi – diktat frëngjisht* (...) *Edhe në moshën 13-14 vjeç, përsëri po në Këzëll-Toprak, por në nji shtëpi tjetër, vajta në shkollën e Fretënvet tetë muaj* (...) *Këtu studjova gramer, lektur, arithmetikë (katër veprime)* (...) *Në këtë kohë i ndjeri baba em u sëmur randë nga sytë; e ndroi shtëpinë. Atje m'u ngjall nji dëshirë e madhe për studim. U përpoqa shumë. Vet më vehte studjova gramer frëngjisht, Zhenovefën, roman, e shumë romane të vegjël turqisht e frëngjisht. E ma në fund, në prill e në maj, studjova pranë nji profesori grek* (...) *sindaksë frëngjisht* (...) *Në këtë periudhë studjova vet më vehte edhe shumë romane frëngjisht* (...)"[27].

Më 27 maj 1309/1893, Mid'hati shkruan po aty:

"*Në frëngjisht kam zotësi e kompetencë të gjanë. Persishten e marrë vesht disi – arabisht kuptoj – gjermanishten e lexoj – edhe greqishten e lexoj*"[28].

Deri në vitin 1923, kur Mid'hat beu shprehu dëshirën për të marrë një dublikatë të certifikatës së Palmave që i patën qenë akorduar, mbi 15% e veprës së tij të shkruar rezulton e hartuar në frëngjisht nga vetë autori. Nëse i shtohet prodhimit të tij shkrimor edhe letërkëmbimi, atëherë me siguri pjesa e trashëgimisë së shkruar në gjuhën frënge merr përpjestime më të mëdha. Shkrimi i parë në frëngjisht i Mid'hatit duhet konsideruar, pas çdo gjase, një artikull gazete nën emrin dhe siglën Lumo Skëndo Frascheri/ L.S.F., botuar më 1901-1902, mbi qëndrimin politik të Abdyl Frashërit ndaj Greqisë[29].

Në propagandimin dhe çuarjen përpara të modelit francez të arsimit publik, arsimtarët francezë nuk ishin të vetmit që duheshin mikluar dhe vlerësuar. Për këtë arsye, Palmat i destinoheshin gjithashtu të gjithë atyre, përfshirë edhe të huaj, anëtarë shoqërish savante, shkrimtarë, dijetarë, të cilët kishin merita në mësimdhënie ose që kishin mbështetur në mënyrë domethënëse zhvillimin e arsimit në çdo shkallë dhe në çdo mënyrë[30]. Është e saktë se Palmat Akademike jepeshin atëherë edhe për motive kortezie protokollare, shpesh si një parapërgatitje për të marrë Legjionin e Nderit pas një periudhe më të gjatë kohore. Për rrjedhojë mund të mendohet se Mid'hat beu ka përfituar nga statusi i tij prej notabli politik të Selanikut për të marrë të tillë nderim.

Në të vërtetë, sado me status të lakmueshëm shoqëror ose profesional, askush nuk mund të dekorohej me Palmat e Oficerit të Arsimit Publik, nëse nuk i justifikoheshin merita ose kontribute në fushën përkatëse të nderimit. Më 1908, përtej statusit të tij personal, mund të thuhet padyshim se Mid'hat beu i plotësonte, edhe në këtë aspekt, kushtet për vlerësim. Personalitet i elitës së Selanikut, Mid'hat beu nuk do të jetë, më 1908, vetëm kryetari i Kongresit të Manastirit, i cili vuri në rrugë të mbarë njësimin e alfabetit të shqipes, kushti *sine qua non* për zhvillimin e qëndrueshëm të arsimit. Ai do të nisë botimin e "*Liria*"-s, njërës prej fletoareve më emblematike të botës shqiptare, e cila problemin arsimor në Perandorinë osmane, dhe më veçanërisht në trojet shqiptare, do ta ketë në krye të çështjeve të debatuara në faqet e saj. Në lidhje me zanafillën e kësaj gazete kombëtare, autoriteteve franceze nuk do t'i ketë shpëtuar fakti që numri i parë doli më 14 korrik 1908 qëllimisht, për të kremtuar datën historike të shogruar të triumfit të Lirisë, Barazisë dhe Vëllazërisë, njëkohësisht festë kombëtare e Republikës Franceze[31]. Autoriteteve që kanë propozuar dekorimin e Mid'hat beut nuk do t'i kenë shpëtuar as kuvendimet dhe as shkrimet e tij në frëngjishte të përsosur në përditshmërinë e shkëmbimeve zyrtare dhe personale. Veçanërisht e vlerësuar duhet të ketë qenë edhe futja e disa orëve mësimi të frëngjishtes në shkollën shqipe të Klubit të Selanikut, në tetor 1908, si faktor për ngritjen e nivelit të nxënësve[32].

Vëzhgues i mprehtë dhe pa iluzione i politikave të Fuqive të mëdha, Mid'hat Frashëri nuk ka qenë naiv mbi projeksionet franceze në Juglindjen europiane, të cilat nuk shkonin doemos paralel me dashurinë dhe admirimin që popujt mund të ushqenin për gjuhën, qytetërimin dhe modelin arsimor frëng. Qëndrimet e diplomacisë franceze të Republikës III, shpeshherë jo në sintoni me interesat e menjëhershme të Shqipërisë, Z. Mid'hat nuk e ka pasur të vështirë t'i denoncojë haptazi. Mirëpo, kërkues siç ishte ndaj vetes dhe ndaj shqiptarëve, mungesën e afrimitetit me Francën republikane, ai e shihte edhe si një problem tonin: pamundësinë e një shteti në shpërgënj për të tërhequr pas vetes partneritetin e një fuqie me peshë vendimtare në fatet europiane të Shqipërisë. Mbi këtë, si edhe mbi një dëshmi të atashimit – sentimental në sipërfaqe, por praktik në thelb – ndaj Francës si pjesë e qenësishme e *Realpolitik*-ës që shteti shqiptar duhet të formësonte brenda strategjisë së vet kombëtare, Mid'hat Frashëri ka lënë një shkrim në frëngjisht në vitin 1921, "*Les Albanais*". Shkrimi i bënte jehonë vizitës në Shqipëri të senatorit francez Justin Godard. Prej tij vlen të sillen këtu disa kalesa:

"*Për Francën, sidomos, ka vend këtu për një politikë krejt të re dhe shumë të frytshme, për një horizont të ri që po çelet. Prej shumë kohësh madje, shqiptarët kishin kthyer vështrimin e tyre në drejtim të Francës. Bashkëpunimi i vetvetishëm dhe i ngrohtë, të themi, midis ushtrisë së Orientit dhe shqiptarëve (në Korçë), kujtimi i shkëlqyer që lanë oficerët dhe trupat franceze tek shqiptarët dhe kujtimi jo më pak i mirë që ata morën me vete, janë prova të tilla të ndjenjave të bashkëlindura, që vërtetojnë praninë e një simpatie të natyrshme mes dy popujve* (...)

Është, pra, krejt e natyrshme që Shqipëria të bëhet aleate e Francës: gjithçka është inkurajuese në këtë drejtim: marrëdhëniet shpirtërore, interesi politik dhe vetë forca e gjërave, që i bëjnë shqiptarët të ndiejnë se Franca mund të jetë për ta një mbrojtëse pa interes dhe se ata vetë mund të mbrohen ndaj të papriturave që sjellin zhgënjimet, vetëm po qe se vendosin marrëdhënie të vazhdueshme me republikën e madhe (...)

Është me vend të theksojmë se tërë të rinjtë shqiptarë, që kanë marrë njëfarë arsimimi, e kanë mësuar frëngjishten si gjuhë ndihmëse, madje do të thosha si mjet përçues i mendimit modern dhe i ideve globale (...).

- Atëherë, u dashka që Franca të adhurohet në Shqipëri? – pyeti një profesor një të ri shqiptar.

- Kjo nuk mjafton, - ia ktheu shqiptari, - duhet që edhe francezët ta duan Shqipërinë".

Dhe në veprën e saj rilindëse e ripërtëritëse, Shqipëria mendon për Francën, miken e saj të dashur shpirtërore. Dhe pikërisht asaj ajo i drejtohet për organizatorë e specialistë, për të riorganizuar apo krijuar nga e para mekanizmat e ndryshëm të administratës. Dhe konkretisht, qeverisë së Republikës Franceze i është drejtuar tashmë një kërkesë për një oficer të lartë dhe për inxhinierë civilë"[33].

Sivëlla i vogël i Palmave Akademike është sot Urdhri i Lisit Akademik, dekoratë e lartë që akordon Republika e Shqipërisë për merita dhe kontribute të veçanta në fushat e artit, kulturës, dijes, shkencës, arsimit, sportit, gazetarisë, si edhe në zhvillimin e shoqërisë shqiptare dhe vlerave demokratike. Në vitin 2025, Urdhri i Lisit Akademik u përfshi në ekspozitën e 70-vjetorit të reformës së Palmave Akademike dhe të rrezatimit të tyre në botë, ekspozitë e cila vazhdon në formë itinerante në një pjesë të madhe të universiteteve franceze edhe gjatë këtij viti[34]. Palmave Akademike dhe trashëgimisë së tyre shekullore, të cilën Mid'hat Frashëri e ruajti si një kujtim të vyer të rrugëtimit personal, dekorata shqiptare nuk i mbetet pas për nga domethënia dhe simbolet. Ngjyrat naimiane të manushaqes dhe të gjelbërimit të peisazheve shqiptare në shiritin e tij, emri fisnik marrë nga "lisat e gjatë" te "*Bagëti e Bujqësi*", 7 marsi i përcaktuar me ligj si dita e tij festive, janë dëshmi e një vazhdimësie idealesh, e një kontinuiteti të ambicies së një Shqipërie të emancipuar – e të shëlbuar – prej arsimimit, kulturës, dijes dhe dinjitetit të shkollës së saj: ambicie e cila ka qenë në zemër të veprës dhe të veprimtarisë së Z. Mid'hat[35].

Një falënderim i veçantë për ndihmën e dhënë në përgatitjen e këtij artikulli i shkon Znj. Mira Hoxha, Drejtor i Arkivit Diplomatik të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Z. Bejtullah Destani, studiues dhe diplomat.

[27] AQSH, F. 35, D. 2, V. 1893, fl. 6-8.
[28] Po aty, fl. 9.
[29] FRASHËRI, Mid'hat: *Vepra të zgjedhura*, vëll. XI (përg. Uran Butka), Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo"/ Onufri, Tiranë, 2025, f. 53, nr. 57.
[30] THIVEND, Marianne: *L'école républicaine et ses héros*, *vep.cit.*, ff. 144-145.
[31] BUTKA, Uran: *Vepra madhore e Mid'hat Frashërit*, *vep.cit.*, f. 21.
[32] FRASHËRI, Mid'hat: *Vepra të zgjedhura*, vëll. XI, *vep.cit.*, f. 60, nr. 117.
[33] FRASHËRI, Mid'hat: *Vepra të zgjedhura*, vëll. II (përg. Uran Butka), Instituti i Studimeve "Lumo Skëndo"/ Onufri, Tiranë, 2018, ff. 402-403 (përkthyer nga frëngjishtja nga Fotaq Andrea).
[34] "*Les Palmes académiques. Un ordre au service du savoir*", https://ifg.univ-lorraine.fr/manifestations/70-ans-des-palmes-academiques-un-ordre-au-service-du-savoir/
[35] FRASHËRI, Thomas: *Naimi i dekoruar dhe Naimi dekoratë*, Onufri, Tiranë, 2026, ff. 109-111.

Shenjat e Kalorësit dhe Komandarit të Urdhrit Kombëtar të Lisit Akademik

Fjalëformimi i neologjizmave në romanin “E kuqja e demave” të Mira Meksit

Nga Kadia Dedja

Kur nisa të lexoj romanin “E kuqja e demave”[1] të Mira Meksit, ribotuar rishtazi nga Shtëpia Botuese Onufri, përveç stilit të lartë letrar, botës së pasur imagjinare dhe trajtimit të ngjarjeve, ajo që më mahniti që në faqet e para të librit, si në të gjithë krijimtarinë e saj, është mjeshtëria e përdorimit të gjuhës.

Mira Meksi është një mjeshtre e shqipes, e cila ka dhënë një kontribut të çmuar në pasurimin dhe skalitjen e gjuhës, gjë që ka rënë gjithmonë në sy të studiuesve dhe kritikëve që janë marrë me veprën e saj. Madje, Floresha Dado e quan edhe “arkeologe” gjuhësore, e cila “kërkon në libra e dokumente të hershme, në tekste origjinale apo të përkthyera, të hershme gjithashtu, vitalitetin dhe pasurinë e shqipes”.[2]

Shkrimtarja është shuguruar edhe si shërbestare e gjuhës shqipe[3] (siç është shprehur vetë), të cilën e konsideron të shenjtë. Si një njohëse e patëdytë e shqipes dhe e historisë së saj, për të krijuar universin e vet letrar të mbushur me simbole, ikona, elemente fetare, mitike dhe magjike, Mira Meksit jo rrallë i është dashur të nxjerrë nga fondi i pluhurosur i shqipes fjalë të vjetruara, shpesh të harruara. Po ashtu, ajo gjurmon edhe në dialekte, që gjithmonë kanë shërbyer si një gurrë e pashtershme për ta pasuruar dhe për ta pastruar gjuhën tonë të bukur nga huazimet e huaja të panevojshme. Ngulmuese ndaj këtij “dëlirësimi” të dobishëm, autorja e pasuron gjuhën duke e veshur pasurinë leksikore me ngjyrime të reja emocionale, duke zgjeruar strukturën kuptimore për të krijuar kuptime të figurshme, duke i veshur fjalët me koloritin e përshtatshëm historik dhe më kryesorja, me anë të neologjizmave, gjë që vihet re edhe në përkthimet e saj brilante.

Përvoja e gjatë përkthimore me korifenjtë e letërsisë botërore, si Gabriel García Márquez, Ernesto Sabato, Federico García Lorca, Milan Kundera, Jorge Luis Borges etj., ka bërë që ajo të fusë në gjuhën shqipe një sërë fjalësh të reja, siç është hamaku. Gjithashtu, duke përkthyer autorë të këtij niveli, që i kanë pasuruar gjuhët në të cilat kanë shkruar me fjalë dhe koncepte të reja, për t’i sjellë në shqip me të gjithë magjinë dhe ngarkesën leksikore, asaj i është dashur jo vetëm të ngulmojë për të gjetur variantin e duhur, të gjurmojë për fjalë pak të përdorura ose që kanë dalë nga përdorimi, por edhe të krijojë fjalë të reja, gjë që ka qenë e mundur edhe falë elasticitetit që shpërfaq gjuha shqipe si në rrafshin gramatikor edhe në atë stilistik.

Shqipja shfaqet si një lëndë e përsosur me kapacitete të mëdha fjalëformuese që, ndryshe nga shumë gjuhë të tjera indoeuropiane, na lejon të formojmë pambarimisht fjalë të reja, duke qenë se tek ajo janë të pranishme dhe prodhimtare pothuajse të gjitha mënyrat e fjalëformimit.

Nisur nga këto veçori, ky studim synon të analizojë proceset e fjalëformimit të neologjizmave në romanin “*E kuqja e demave*”, duke evidentuar mënyrat e krijimit të tyre, funksionin stilistik dhe kontributin që japin në pasurimin e leksikut të shqipes. Përmes kësaj analize synohet të vlerësohet jo vetëm individualiteti gjuhësor i Mira Meksit, por edhe roli i saj si një nga krijueset që kanë shfrytëzuar në mënyrë të ndërgjegjshme potencialin fjalëformues të gjuhës shqipe.

[1] Mira Meksi, “E kuqja e demave”, Onufri, 2026.
[2] Floresha Dado, “Thellësitë e strukturës në prozën e Mira Meksit”, Onufri, 2025.
[3] Mira Meksi, “Jam shërbestare e gjuhës shqipe, të cilën e konsideroj të shenjtë”, ExLibris, nr. 58, 21 dhjetor 2019.

Mënyrat më të njohura të fjalëformimit (në gjuhën shqipe) janë prejardhja, kompozimi dhe përzierja.[4] Edhe Mira Meksi në romanin “E kuqja e demave” shfrytëzon këto mënyra fjalëformimi të shqipes për të krijuar fjalë të reja, të cilat po i ilustrojmë me disa shembuj: **diamantin** (shumëfaqëshit diamantin); **leprozike** (poshtë galerisë leprozike); **opiumike** (fanitjes opiumike); **hijerake** (sajonin lojëra çmendurake dhe hijerake); **këtillësinë** (shpaloset në tërë këtillësinë e saj); **pasëndrre** (si çdo mëngjes pasëndrre); **jetëvdekje** (të kapërceje kufirin e jetëvdekjes); **mendjepërhitur** (mendjepërhitur nga mjegullimet e verës) etj.

Megjithatë, është e ditur tashmë se “kompozimi (përbërja) në gjuhën shqipe është një mënyrë formimi mjaft produktive dhe me prirje në rritje, sepse përmes tij emërtohen nocione komplekse dhe mjaft nocione të reja”.[5] Edhe në romanin “E kuqja e demave” pjesa më e madhe e neologjizmave janë formuar me anë të përbërjes. Për këtë arsye do t’i paraqesim më poshtë bashkë me nënndarjet, duke i ilustruar edhe me shembuj nga romani:

Kompozita emërore:

E+E (emër + emër) = **rrëzëkofshë** (përshkon rrëzëkofshën); **idengulitje** (në një lloj idengulitjeje); **fundpranverë** (atë fundpranverë qyteti ish mbërthyer); **zemërdhembje** (sa shumë zemërdhembje); **fundditë** (dritën e fundditës, disa rreze dielli të fundditës); **perëndimdiell** (lëndës së kuqëluar të perëndimdiellit, përflakja e perëndimdiellit, me qiell të përflakur nga perëndimdielli); **pragmagji** (të një pragmagjie); **fillbisedë** (fillbiseda u zu te simboli i rubinit); **ëndërrzhgjëndërr** (m’u shfaq në një ëndërrzhgjëndërr); **jetëvdekje** (të kapërceje kufirin e jetëvdekjes); **fillimthinje** (si prej një fillimthinjeje e beftë) etj.

N+E (ndajfolje + emër) = **brendaëndërr** (labirinteve të brendaëndrrës); **përtejdashuri** (në përtejdashuri nuk janë të njëjtat rregulla si në dashuri) etj.

P+E (përemër + emër) = **gjithëkohë** (në universin tonë dhe në gjithëkohë); **gjithëprani** (duke e mbushur me gjithëpraninë e tij) etj.

Kompozita mbiemërore:

E+M (emër + mbiemër) = **kohëgjatë** (me soditjen kohëgjatë); **mjegullzezë** (qindra mendime mjegullzeza); **zemërçjerrës** (i njëjti fat zemërçjerrës); **çapshtruar** (të shëtiste çapshtruar); **takalartë** (këpucë sateni të zeza takalarta); **zajebardhë** (rruginat zajebardha); **syzgjuar** (për shpirtin syzgjuar); **hekurgjembta** (me bedena të thepëta e hekurgjembta) etj.

E+E (emër + emër) = **fijeari** (me të njëjtat motive fijeari); **syzjarr** (vegullinë e një gruaje syzjarr); **vegullimbërës** (tymrat vegullimbërëse të opiumit) etj.

Kompozita ndajfoljore:

E+M (emër + mbiemër) = **mendjepërhitur** (mendjepërhitur nga mjegullimet e verës); **zemërshkallmuar** (zemërshkallmuar nga emocionet); **mendjeqëruar** (mendjeqëruar nga tymi i opiumit); **syfikur** (syfikur dhe si i thyer më dysh); **trupçlirët** (qëndronim trupçlirët në shtratin e papafingos) etj.

Kompozita foljore:

E+F (emër + folje) = **jetëndizem** (jetëndizeshin dhe ktheheshin sërish në sublime) etj.

Si përfundim, duke u mbështetur në shembujt e analizuar më sipër, mund të themi se në romanin “E kuqja e demave” Mira Meksi shfrytëzon disa mënyra fjalëformimi për krijimin e neologjizmave, por mbizotërojnë fjalët e përbëra, veçanërisht kompozitat emërore dhe mbiemërore, gjë që dëshmon edhe një herë aftësinë e autores për të shfrytëzuar potencialin fjalëformues të shqipes në funksion të pasurimit të leksikut dhe të individualizimit të gjuhës së veprës.

[4] Rami Memushaj, “Hyrje në gjuhësi”, Toena, Tiranë, 2006, fq. 233.
[5] Ethem Likaj, Maklena Çabej, “Morfologji e shqipes standarde”, Juvlin, Tiranë, 2010, fq. 25.

Literaturë:

Mira Meksi, “E kuqja e demave”, Onufri, 2026.
Floresha Dado, “Thellësitë e strukturës në prozën e Mira Meksit”, Onufri, 2025.
Mira Meksi, “Jam shërbestare e gjuhës shqipe, të cilën e konsideroj të shenjtë”, ExLibris, nr. 58, 21 dhjetor 2019.
Rami Memushaj, “Hyrje në gjuhësi”, Toena, Tiranë, 2006.
Ethem Likaj, Maklena Çabej, “Morfologji e shqipes standarde”, Juvlin, Tiranë, 2010.

Vijon nga numri i kaluar

Roli i huazimeve në formësimin e gjuhës dhe kulturës moderne shqiptare

Nga Diana Kristo

Ndikimi i italishtes

Afërsia gjeografike dhe marrëdhëniet shumë shekullore me qytetet italiane, veçanërisht me Republikën e Venedikut, krijuan kushte të favorshme për ndikimin e italishtes në gjuhën dhe kulturën shqiptare. Ky ndikim lidhet me kontaktet më të hershme të shqipes me latinishten dhe përbën, në një kuptim më të gjerë, vazhdimësi të pranisë romano-latine. Ai nisi në Mesjetë, u fuqizua gjatë Rilindjes Evropiane dhe vijoi në kohët moderne, duke formuar një nga shtresat më të rëndësishme të leksikut të shqipes.

Gjatë regjimit komunist, megjithëse marrëdhëniet zyrtare ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë ishin të kufizuara, lidhjet kulturore të shqiptarëve me botën italiane nuk u ndërprenë. Radioja dhe sidomos transmetimet televizive italiane, të ndjekura shpesh fshehurazi — brezat më të vjetër i kujtojnë mirë "kanoçet" e përdorura për të kapur sinjalin — u shndërruan për shumë familje në një dritare drejt Evropës Perëndimore. Përmes tyre, shqiptarët u njohën me zhvillimet bashkëkohore në muzikë, kinema, teatër, art, modë, sport, shkencë dhe politikë.

Pas viteve 1990, hapja e Shqipërisë dhe emigracioni masiv drejt Italisë i intensifikuan këto marrëdhënie. Bashkëpunimi në arsim e shkencë, përkthimet letrare, mediat, turizmi dhe shkëmbimet ekonomike e tregtare e forcuan më tej praninë e italishtes në jetën shqiptare. Njohja e saj u përhap gjerësisht, sidomos te brezat e rinj dhe në familjet e emigrantëve, duke e bërë italishten një nga gjuhët e huaja më të njohura në Shqipëri.

Gjurmët më të dukshme të këtij ndikimi vërehen në leksik. Nga italishtja ose përmes saj kanë hyrë fjalë që lidhen me administratën, ekonominë, financat, tregtinë, detarinë, arkitekturën, artin, muzikën dhe jetën qytetare, si *bankë, faturë, firmë, studio, operë, koncert, violinë, piano, pilot, makinë, trafik, valutë, valixhe, adresë, apartament* dhe *vitrinë*.

Gjatë dekadave të fundit janë përhapur terma të rinj sidomos në biznes, turizëm dhe gastronomi. Në përdorim ndeshen fjalë e togfjalësha si *autostradë, rezidencë, agjenci imobiliare, espresso, kapuçino, pica, pasta, parmixhano* dhe *karpaço*. Një pjesë e tyre është përshtatur plotësisht me sistemin fonetik, morfologjik dhe drejtshkrimor të shqipes, ndërsa të tjera ruajnë ende tipare të gjuhës burimore. Italishtja ka shërbyer gjithashtu si gjuhë ndërmjetëse për hyrjen e një pjese të terminologjisë ndërkombëtare.

Ndikimi italian nuk është kufizuar vetëm në fjalor. Përkthimet letrare dhe kontaktet e vazhdueshme kulturore kanë ndihmuar në pasurimin e mjeteve shprehëse, të prozës artistike dhe të publicistikës shqipe, pa sjellë ndryshime të qenësishme në strukturën gramatikore të gjuhës.

Ndikimi i frëngjishtes

Gjatë shekujve XVIII–XX, frëngjishtja fitoi prestigj të veçantë në Evropë si gjuhë e diplomacisë, e kulturës dhe e mendimit shkencor. Ndikimi i saj në shqipe u përcoll kryesisht përmes arsimit, letërsisë, përkthimeve, administratës dhe marrëdhënieve kulturore me Evropën Perëndimore.

Një rol të rëndësishëm në këtë proces luajti Rilindja Kombëtare Shqiptare. Shumë rilindës, intelektualë dhe diplomatë shqiptarë u arsimuan në shkolla frankofone ose u njohën me kulturën franceze gjatë qëndrimit të tyre në Evropë. Në këtë mënyrë, ata ndihmuan në përhapjen e terminologjisë moderne politike, juridike, shkencore dhe kulturore. Edhe gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, modeli francez ndikoi në organizimin e arsimit, të administratës dhe të institucioneve shqiptare.

Një kontribut të veçantë dha Liceu Kombëtar i Korçës, i themeluar më 1917 sipas modelit arsimor francez. Për disa dekada, ai ishte një nga qendrat kryesore të arsimit frankofon në Shqipëri dhe përgatiti një pjesë të rëndësishme të elitës intelektuale, administrative dhe politike të vendit. Mësimdhënia në frëngjisht dhe përdorimi i teksteve franceze i njohën nxënësit me terminologjinë e shkencës, filozofisë, letërsisë, historisë dhe administratës. Më pas, kjo terminologji u përhap në arsimin shqiptar, në administratën shtetërore, në publicistikë dhe në përkthimet letrare e shkencore.

Ndikimi i frëngjishtes është veçanërisht i dukshëm në gjuhën e diplomacisë dhe të administratës. Në këtë fushë ndeshen terma si *protokoll, ambasadë, ambasador, konsull, delegacion, negociatë, kabinet, byro, komunikatë* dhe *memorandum*. Shumë prej tyre i përkasin terminologjisë ndërkombëtare dhe mund të kenë hyrë në shqipe drejtpërdrejt nga frëngjishtja ose nëpërmjet gjuhëve të tjera evropiane.

Prania e saj vërehet edhe në art, letërsi, teatër dhe kinema, me terma si *kinema, regji, regjisor, dekor, ansambël, repertor, premierë, debutim, avangardë, siluetë, fejton, ese* dhe *atelie*. Me kulturën dhe terminologjinë franceze lidhet edhe përhapja e emërtimeve të rrymave artistike e letrare, si *iluminizëm, romantizëm, realizëm, natyralizëm, simbolizëm, impresionizëm, modernizëm* dhe *surrealizëm*. Këto koncepte u bënë pjesë e gjuhës së kritikës, të publicistikës dhe të studimeve shqiptare.

Në fushën e modës, kozmetikës dhe gastronomisë u përhapën fjalë si *modë, parfum, makijazh, siluetë, manekin, butik, bizhuteri, meny* dhe *restorant*. Këto huazime pasqyrojnë prestigjin që gëzonte kultura franceze dhe rolin e frëngjishtes në përhapjen e terminologjisë moderne evropiane.

Përtej leksikut, letërsia dhe mendimi francez ndikuan në formimin e shijeve estetike, në zhvillimin e kritikës letrare e artistike, të publicistikës dhe të kulturës moderne shqiptare. Ndërsa italishtja pati një prani më të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme dhe në kulturën popullore, frëngjishtja u shqua kryesisht si gjuhë e arsimit, diplomacisë dhe elitës intelektuale. Huazimet nga italishtja dhe frëngjishtja dhanë një ndihmesë të rëndësishme në modernizimin e leksikut të shqipes. Nëpërmjet tyre u emërtuan institucione, profesione, shpikje, rryma artistike dhe koncepte politike të lidhura me zhvillimet e reja të shoqërisë shqiptare. Me kalimin e kohës, shumë prej këtyre fjalëve u integruan në sistemin fonetik, gramatikor dhe drejtshkrimor të shqipes, duke u bërë pjesë e fondit të saj aktiv. Në këtë kuptim, ndikimi i italishtes dhe i frëngjishtes ndihmoi në evropianizimin e leksikut të shqipes dhe në zgjerimin e mundësive të saj shprehëse.

Ndikimi i rusishtes

Ndikimi i rusishtes në gjuhën shqipe lidhet kryesisht me periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht me vitet 1948–1961, kur Shqipëria vendosi marrëdhënie të ngushta politike, ekonomike, ushtarake dhe kulturore me Bashkimin Sovjetik. Gjatë kësaj kohe, qindra studentë shqiptarë u arsimuan në universitetet sovjetike, ndërsa nga rusishtja u përkthyen tekste shkollore e universitare, vepra shkencore, teknike dhe letrare. Këto kontakte sollën përhapjen e termave dhe të koncepteve që lidheshin me organizimin socialist të shtetit, politikën, ekonominë, shkencën dhe teknologjinë.

Për shkak të kohëzgjatjes relativisht të shkurtër dhe të karakterit kryesisht institucional të marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike, ndikimi i rusishtes, ndryshe nga ai i latinishtes, turqishtes osmane ose italishtes, nuk solli ndryshime të rëndësishme në strukturën fonetike dhe gramatikore të shqipes. Gjurmët e tij u shfaqën kryesisht në leksik dhe në ligjërimin politik, ideologjik, shkencor e teknik. Në studimin e këtij ndikimi është e rëndësishme të dallohen huazimet me prejardhje të mirëfilltë ruse nga termat ndërkombëtarë që u përhapën nëpërmjet rusishtes.

Përmes rusishtes u përhap ose u konsolidua terminologjia e ndërtimit të shtetit socialist dhe organizimit politik të shoqërisë së asaj kohe, si *kolkoz, sovkoz, hozrashot, stahanovist, bolshevik, komsomol, sovjet, Komintern, agjitprop, aparatçik dhe politbyro,*. U përhapën gjithashtu terma dhe formula të diskursit marksist-leninist, si *centralizëm demokratik, diktaturë e proletariatit, luftë e klasave, internacionalizëm proletar, Byroja Politike, armik i popullit* dhe *kulti i individit*. Në këtë kontekst, edhe fjala *nomenklaturë* mori kuptimin e posaçëm të hierarkisë së funksionarëve të partisë dhe të shtetit.

Në fushën e ekonomisë dhe të organizimit të punës u përdorën gjerësisht shprehje si *kolektivizim, ekonomi e planifikuar, fermë shtetërore, kooperativë bujqësore, plan pesëvjeçar, brigadë socialiste* dhe *emulacion socialist*. Ndërkaq, formulime si *njeriu i ri, realizëm socialist, edukim ideopolitik, ndërgjegje socialiste,* dhe *moral komunist* shprehnin synimin për formimin e individit dhe të kulturës sipas idealeve të sistemit.

Terma si *socializëm, komunizëm, industrializim, kolektivizim, mekanizim, elektrifikim, kooperativë, kombinat, planifikim* dhe *specializim* nuk janë me origjinë ruse, por përdorimi i tyre në shqipe u zgjerua dhe u konsolidua përmes përkthimeve të literaturës sovjetike dhe diskursit politik të kohës. E njëjta gjë vlen për terma shkencorë e teknikë si *atom, molekulë, reaktor, turbinë, transformator* dhe *traktor*, të cilët i përkasin terminologjisë ndërkombëtare me bazë kryesisht greke ose latine. Në këto raste, rusishtja shërbeu si kanal ndërmjetës dhe jo si burim etimologjik.

Sistemi arsimor dhe botues luajti një rol të rëndësishëm në përhapjen e këtij ndikimi. Përkthimi i teksteve të matematikës, fizikës, kimisë, inxhinierisë, bujqësisë, mjekësisë dhe filozofisë ndihmoi në përpunimin dhe njësimin e terminologjisë shkencore e teknike në shqip. Nga mjedisi shkencor sovjetik u përhapën edhe terma si *sputnik* dhe *kozmonaut*, të lidhur me kërkimet hapësinore, si dhe *miçurinizëm* e *jarovizim*, lidhur me biologjinë, gjenetikën dhe agronominë.

Një ndikim të dukshëm kulturor ushtruan përkthimet e letërsisë ruse. Veprat e Aleksandër Pushkinit, Leon Tolstoit, Fjodor Dostojevskit, Anton Çehovit, Ivan Turgenievit dhe Maksim Gorkit u botuan dhe u lexuan gjerësisht në shqip. Përballja me gjuhën dhe stilin e këtyre autorëve i nxiti përkthyesit shqiptarë të kërkonin zgjidhje të reja në rrëfim, dialog dhe përshkrim psikologjik, duke pasuruar praktikën përkthimore dhe mjetet shprehëse të shqipes letrare.

Bashkëpunimi me Bashkimin Sovjetik ndikoi edhe në zhvillimin e kinematografisë shqiptare. Kinostudioja "Shqipëria e Re", e themeluar më 1952 me ndihmën sovjetike, u bë qendra e prodhimit të filmave, dokumentarëve dhe kronikave shqiptare. Ky bashkëpunim ndihmoi në formimin e kineastëve dhe të teknikëve, si dhe në përvetësimin e metodave të reja të prodhimit filmik. Një nga frytet e para të tij ishte filmi shqiptaro-sovjetik *Skënderbeu*. Në këtë mënyrë, ndikimi sovjetik u shtri përtej leksikut dhe përkthimit, duke prekur edhe organizimin institucional, formimin profesional dhe zhvillimin teknik e artistik të kinematografisë shqiptare.

Pas prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike më 1961, ndikimi i drejtpërdrejtë i rusishtes u dobësua ndjeshëm. Shqipëria u orientua më pas politikisht dhe ekonomikisht drejt Kinës, ndërsa pas vitit 1990 anglishtja u bë burimi kryesor i terminologjisë së re shkencore, teknologjike dhe ekonomike. Megjithatë, rusizmat dhe modelet terminologjike të përhapura gjatë bashkëpunimit me Bashkimin Sovjetik mbeten dëshmi e një etape të veçantë në historinë politike, arsimore, shkencore dhe kulturore të Shqipërisë.

Ndikimi i anglishtes

Në fund të shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI, anglishtja u bë burimi kryesor i huazimeve të reja në gjuhën shqipe. Ky ndikim lidhet me globalizimin, zhvillimin e teknologjisë së informacionit, përhapjen e internetit, ekonominë e tregut, shkencën, arsimin, emigracionin dhe kulturën ndërkombëtare. Ndryshe nga shtresat më të hershme të huazimeve, ndikimi i anglishtes është një proces ende në zhvillim, i cili sjell vazhdimisht terma, kuptime dhe modele të reja shprehëse.

Shumë fjalë angleze janë përvetësuar pa ndryshime ose me përshtatje të vogla fonetike dhe drejtshkrimore. Në teknologji dhe komunikimin digjital përdoren gjerësisht

terma si *internet, blog, podkast, server, softuer, smartfon, laptop, skaner, printer, monitor, link, ueb, aplikacion, çip, Wi-Fi, online, streaming, emoji* dhe *hashtag*. Për shkak të shpejtësisë së zhvillimeve teknologjike, këto fjalë hyjnë shpesh në përdorim përpara se të krijohet ose të përhapet një barasvlerës i qëndrueshëm në shqip.

Në ekonomi dhe në botën e biznesit janë përhapur fjalë si *marketing, menaxher, menaxhim, startup, biznes, brend, sponsor, tender, audit, lidership, bord, staf, partneritet* dhe *frilancer*. Disa prej tyre janë me prejardhje më të hershme latine ose franceze, por përdorimi dhe kuptimet e tyre bashkëkohore janë përhapur në shqip kryesisht nën ndikimin e anglishtes.

Prania e anglishtes është e dukshme edhe në media, reklamë, muzikë, sport dhe kulturën rinore. Fjalë si *show, reality show, hit, klip, DJ, rep, rok, pop, fan, trajner, rekord, ekip, gol, derbi* dhe *fair play* janë bërë pjesë e komunikimit të përditshëm. Në rrjetet sociale përdoren gjithashtu *influencer, follower, story, reel, like, selfie, post, chat, live* dhe *fake news*, shpesh krahas formave shqipe ose pa ndonjë përshtatje drejtshkrimore.

Një pjesë e fjalëve angleze është përshtatur sipas sistemit fonetik dhe morfologjik të shqipes. Kështu, *computer* është bërë *kompjuter*, *scanner* është përshtatur si *skaner*, *software* si *softuer* dhe *podcast* si *podkast*. Nga tema të huazuara janë krijuar edhe folje e emra sipas rregullave të shqipes, si *menaxhoj, menaxhim, skanoj, printoj, formatoj, klikoj, postoj, programoj* dhe *programues*. Kjo dëshmon aftësinë e shqipes për t'i integruar elementet e huaja në sistemin e saj gramatikor dhe fjalëformues.

Megjithatë, përshtatja nuk është gjithmonë e njëtrajtshme. Në përdorim ndeshen njëkohësisht forma të huaja dhe të shqipëruara, si *scanner/skaner, software/softuer, podcast/podkast* dhe *online/në internet*. Kjo luhatje është karakteristike për huazimet e reja, norma e të cilave nuk është konsoliduar ende plotësisht.

Ndikimi i anglishtes nuk shfaqet vetëm nëpërmjet huazimeve të drejtpërdrejta. Në shumë raste, shqipja ka krijuar terma duke përkthyer elementet përbërëse të shprehjeve angleze. Shembuj të tillë janë *rrjet social* (*social network*), *faqe interneti* (*webpage/website*), *fjalëkalim* (*password*), *shfletues* (*browser*), *motor kërkimi* (*search engine*), *postë elektronike* (*electronic mail*), *inteligjencë artificiale* (*artificial intelligence*), *mësim në distancë* (*distance learning*), *punoj nga shtëpia* (*work from home*) dhe *ruajtje në renë kompjuterike* (*cloud storage*). Këto krijime tregojnë aftësinë e shqipes për të emërtuar realitete të reja me mjetet e veta.

Në raste të tjera, nën ndikimin e anglishtes, fjalë që ekzistonin më parë në shqip kanë fituar kuptime ose përdorime të reja. Terma ndërkombëtarë si *platformë, profil, aplikacion, rrjet, virus, dritare* dhe *adresë* përdoren sot edhe në kuptime informatike. Në këto raste nuk kemi domosdoshmërisht huazimin e një fjale të re, por zgjerimin kuptimor të një fjale ekzistuese.

Anglishtja është bërë gjithashtu gjuha kryesore e komunikimit shkencor ndërkombëtar. Përmes artikujve, konferencave, teksteve universitare dhe bashkëpunimeve akademike, në shqipe kanë hyrë terma të shumtë nga informatika, mjekësia, ekonomia, biologjia dhe inxhinieria. Shprehje si *big data, machine learning, deep learning, blockchain, startup, know-how* dhe *open source* përdoren shpesh në trajtën angleze, megjithëse për disa prej tyre ekzistojnë forma shqipe, si *të dhëna masive, të nxënit makinerik, zinxhir blloqesh, njohuri praktike* dhe *kod me burim të hapur*.

Në arsimin e lartë është shtuar përdorimi i literaturës në anglisht, ndërsa disa programe studimi zhvillohen pjesërisht ose plotësisht në këtë gjuhë. Kjo ka lehtësuar qarkullimin e dijes dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, por ka krijuar edhe vështirësi në zhvillimin dhe njësimin e terminologjisë shkencore shqipe.

Anglishtja ushtron ndikim të fortë edhe në gjuhën e medias, politikës dhe administratës. Në ligjërimin publik përdoren shpesh fjalë si *implementoj, targetoj, adresoj, aksesoj, suportoj, draft, feedback, update, deadline, task, workshop* dhe *event*, edhe kur shqipja ofron barasvlerës të qartë: *zbatoj, synoj, trajtoj, përdor ose hyj, mbështes, projekt, vlerësim ose përgjigje, përditësim, afat, detyrë, seminar* dhe *veprimtari*.

Ky përdorim nuk buron gjithmonë nga nevoja për të emërtuar koncepte të reja. Ndonjëherë ai lidhet me prestigjin e anglishtes dhe me dëshirën e folësve, sidomos në media, politikë dhe biznes, për t'u paraqitur si modernë, të arsimuar ose të lidhur me mjedisin ndërkombëtar. Kur përdoren pa nevojë, këto fjalë mund ta bëjnë ligjërimin më pak të qartë dhe të shmangin fjalë shqipe të sakta e të kuptueshme.

Në gjuhën e medias, reklamës, përkthimeve dhe komunikimit digjital vërehen edhe ndërtime të ndikuara nga anglishtja. Përkthimi fjalë për fjalë mund të prodhojë togfjalësha që nuk përputhen plotësisht me natyrën e shqipes. Po kështu, përdorimi i shpeshtë i emrave në vend të foljeve dhe fjalitë e shkurtra sipas modelit publicitar anglez kanë ndikuar në stilin e komunikimit publik.

Një dukuri tjetër është ndërthurja e shqipes me anglishten brenda së njëjtës fjali, veçanërisht në komunikimin e të rinjve dhe në mjediset profesionale: *ta bëjmë update, më dërgo linkun, kemi një meeting, bëj download dokumentin* ose *më jep feedback*. Kjo dukuri pasqyron kontaktin e vazhdueshëm të folësve me anglishten, por, kur përdoret pa nevojë, mund të kufizojë përdorimin aktiv të fjalëve shqipe.

Përballë hyrjes së vazhdueshme të anglicizmave, gjuhëtarët, institucionet shkencore, universitetet dhe specialistët e fushave të ndryshme përpiqen të përpunojnë dhe të njësojnë terminologjinë shqipe. Nëpërmjet fjalorëve terminologjikë, teksteve normative dhe botimeve shkencore rekomandohen forma shqipe për terma të teknologjisë, shkencës dhe komunikimit. Megjithatë, shpejtësia me të cilën krijohen dhe përhapen konceptet e reja e vështirëson standardizimin e menjëhershëm të tyre.

Ndikimi gjithnjë e më i madh i anglishtes po shndërrohet në një sfidë për shqipen, veçanërisht kur fjalët e huaja përdoren pa nevojë në vend të fjalëve shqipe ekzistuese. Përdorimi i pakontrolluar i anglicizmave në media, politikë, administratë, biznes dhe komunikimin e përditshëm mund të dobësojë përdorimin aktiv të një pjese të leksikut vendës, ta bëjë ligjërimin më pak të kuptueshëm dhe të krijojë vështirësi komunikimi ndërmjet brezave ose grupeve të ndryshme shoqërore. Prandaj, sfida nuk qëndron në kundërshtimin e çdo huazimi, por në dallimin ndërmjet termave që emërtojnë realitete vërtet të reja dhe atyre që zëvendësojnë pa arsye fjalë të sakta e të rrënjosura në shqip.

Në këtë kuptim, ndikimi i anglishtes përfaqëson jo vetëm fazën më të re të zhvillimit të leksikut të shqipes, por edhe një sfidë për ruajtjen e qartësisë dhe të individualitetit të saj. Përvetësimi i termave të domosdoshëm duhet të shoqërohet me përshtatjen e tyre sipas rregullave të shqipes, me krijimin e barasvlerësve të përshtatshëm dhe me përdorimin e përgjegjshëm të gjuhës në arsim, media, administratë dhe jetën publike. Në këtë mënyrë, shqipja mund t'u përgjigjet zhvillimeve të reja, duke ruajtur njëkohësisht fondin e saj leksikor dhe veçoritë që përbëjnë identitetin e saj.

Në përfundim, huazimet nga gjuhë dhe kultura të ndryshme përbëjnë një pjesë të rëndësishme të historisë dhe të zhvillimit të shqipes. Ato pasqyrojnë kontaktet shumëshekullore të shqiptarëve me popujt e tjerë dhe kanë ndihmuar në pasurimin e leksikut, në zgjerimin e mundësive shprehëse dhe në emërtimin e realiteteve të reja. Shqipja i ka përvetësuar dhe përshtatur këto elemente sipas natyrës së saj, duke ruajtur vazhdimësinë dhe individualitetin gjuhësor. Sot, përballë ndikimeve të reja, veçanërisht atyre të anglishtes, sfida qëndron në ruajtjen e një ekuilibri ndërmjet hapjes ndaj zhvillimeve bashkëkohore dhe mbrojtjes së pasurisë së vetë gjuhës shqipe.

TETORI, MUAJI I LETËRSISË DHE ARTEVE

Nga Naum Prifti

Tetori - muaji i letërsisë dhe arteve, i takimeve të shkrimtarëve dhe artistëve me lexuesit dhe artdashësit anembanë atdheut. Nga e kemi huajtuar këtë formë burokratike dhe formale? Më duket se historiku plekset me ndryshimet politike. Në kohën e aleancës së pathyeshme me Bashkimin Sovjetik, shtatori qe shpallur " muaji i miqësisë" dhe anembanë vendit zhvilloheshin aktivitete të larmishme artistike me recitime, këngë, muzikë. Pas prerjes së marrëdhënievet diplomatike me Bashkimin Sovjetik, e humbi kuptimin, përmbajtjen dhe qëllimin, prandaj u zëvendësua me muajin e letërsisë dhe arteve. Më vonë, Kryesia e Lidhjes e spostoi në tetor që të përkonte me ditëlindjen e udhëheqësit dhe të mos dubloheshin aktivitetet me diten e poezisë (16 tetorin). Lidhja e konsideron aktivitetin më të rëndësishëm të vitit, si bashkëbisedim midis artistëve dhe masës së lexuesve dhe dëgjuesve, prandaj parapërgatitej duke hartuar lista ekipesh me shkrimtarë, piktorë, aktorë, rrethet ku do të shkojnë dhe datat. Në fund të shtatorit, te salla e madhe e Lidhjes, organizohet ceremonia e hapjes se muajit festiv. Kryetari mban fjalën e rastit për detyrat aktuale, pastaj Sekretari shpall përbërjen e ekipeve. Të krisurat e para të programit nisin që aty, për shkak se mjaft artistë duan të këmbejnë destinacionin, ekipin, ose datat. Ngjasin edhe gjëra komike. Disa nga kolegët tanë më të shkathët e më të patureshëm, menjëherë pas mbledhjes shkojnë te llogaria e Lidhjes, tërheqin paradhënien për shpenzime udhëtimi e dieta dhe pastaj vrapin e lënë te rostiçeritë e Tiranës, ku vazhdojnë festën me të ngrëna e të pira, duke ngritur shëndete për njëri tjetrin e për Lidhjen. Po t'u teprojnë para, i vazhdojnë davetet edhe ditët e tjera. Gjithkush mund të pyesë ku e si do t'i gjejnë të hollat për të mbuluar shpenzimet e vajtjes në rrethet e caktuara? Zakonisht kjo kategori nuk shkon për takime letrare as në rrethet e largëta, as në të afërtat, madje as në shkollat e kryeqytetit. Për ta muaji i letërsisë është më i dashur se u jep mundësi të zhvatin të ardhura suplementare. Pas trekatër muajsh llogaria e Lidhjes i thërret të shlyejnë paradhënien. Atëhere prej tyre dëgjohen zakonisht replika komike. Biletat e udhëtimit i "kanë humbur", fatura hoteli s' kanë, se gjasme "harruan t'i merrnin", ose fjetën nëpër miqtë e tyre, etj. Sidoqoftë muaji i letërsisë u krijon mundësi anëtarëve të Lidhjes të vizitojnë rrethet që nuk i kanë parë, të pushojnë disa ditë larg kryeqytetit të shkojnë nëpër qytetet ku kanë familjet e tyre, ose punë personale. Sivjet, sapo mbaroi ceremonia e hapjes së muajit të letërsisë dhe arteve, Lame Çekani m'u afrua dhe më pyeti nëse doja të shkoja me të në Lunxhëri. Lamen e njihja prej kohësh si autor tregimesh dhe gazetar të shtypit ushtarak. E pranova ftesën pa u mëdyshur asnjë çast se nuk më pëlqente as përbërja e ekipit, as rrethi ku më kishte caktuar Lidhja.

Nëndor 1982.

Rreth librit të Arbër Ahmetaj "Gruaja e ambasadorit", botoi RLBooks, Bruksel 2026

PARA SE TË MBËRRIJË TRAGJEDIA, KA NDODHUR JETA

Nga Luljeta Dano

Në librin e tij më të ri, autori Arbër Ahmetaj sjell një hartë trashëgimie zakonore AD HONOREM të individit, të shoqërisë, të epokave kufitare në prag të përmbysjeve fatale të pushteteve që mendoheshin të pazhbëshme, që nga fundi i Perandorisë Otomane, nëpër mbarimin e Luftës së Dytë Botërore dhe falimentimit të shtetit socialist.

Lënda letrare në të katër novelat e librit e fton lexuesin të njohë kohërat e mëparshme të historisë, si dhe psikën shqiptare, të cilën e trashëgojmë në nënvetëdije si traumë kolektive. Një galeri e pasur personazhesh, shqiptarë dhe joshqiptarë, bëjnë jetën e tyre në katër novelat.

Novela e parë "Letra e një vrasësi"

Novela me të cilën fillon libri, "Letra e një vrasësi", mendoj se ka një peshë specifike në libër dhe në vetë krijimtarinë letrare të Arbër Ahmetajt, me një intensitet ngjarjesh dhe dilemash morale që përfshijnë të gjithë aktorët, qoftë vrasësit, qoftë të vrarët. Kështu ndodh.

Novela më kujtoi një paralele historike në jug, në fshatin Vranisht, që e sjell hulumtuesi i etnokulturës Gëzim Zilja, me këngën-vaj të Aishe Kalemit për tre gjermanët e vrarë në fshatin e tyre nga partizanët. Ushtria gjermane do të pushkatonte nga dhjetë burra të fshatit për secilin gjerman të vrarë. Komandanti gjerman i kompanisë dha urdhër për anulimin e pushkatimit të njëzet burrave të tjerë, pasi i përkthyen vajtimin e gruas. I njëjti popull, i njëjti kanun, e njëjta peshë universale e humanitetit që, edhe në kohë lufte, nuk e humb nderin, edhe kur përballë ka armikun. Vajtimi i Aishe Kalemit: "Biro, u bëre kërcu,/çdeshe që erdhe këtu?/ Vajti gjaku gjer në gju,/Gjak nga ne e gjak nga ju./O bir, o e zeza mëma, derëzeza./O gjerman, o djalë i ri,/mjerë mëma që të dha gji,/do t'i mbesë loti në sy./Unë qaj se jam vetë mëmë,/mëmave zemra u dhemb".

Në novelën "Letra e një vrasësi" mund të nxirren mjaft skeda antropologjike për njeriun shqiptar, të ndrydhur nga pushtimi i fuqive ushtarake të huaja që shkojnë e vijnë, nga një liri e shtetit të vet që do t'i vijë si pushtet diktature, nga barra e dokeve zakonore që formësojnë karaktere njerëzore të padepërtueshme, si kreshtat e Alpeve të tyre. Por edhe i huaji që vjen veshur me uniformën ushtarake të pushtuesit, nën të cilën gjendet edhe një zemër njeriu, përfshihet në jetën që vazhdon pa kufij të qartë mes të mirës dhe të keqes, mes nderit dhe fajit, mes detyrës dhe shkeljes së ligjeve, mes pasqyrave ku njeriu nuk sheh më tjetrin, por veten.

Novela e dytë "Gruaja e ambasadorit"

Brenda një kornize të larzuar, kur Perandoria Otomane është në fundin e kohës së vet, shpërthen subjekti i novelës "Gruaja e ambasadorit". Përfaqësia diplomatike perandorake në Paris drejtohet nga një shqiptar me origjinë nga Përmeti, Rifat Pasha.

Misteret, të themi që nga koha e piramidave, që mbartin shoqëritë sekrete apo rrjetet e agjentëve ndërkombëtarë në lobimet hartëformuese ballkanike në fillimshekullin XX, janë pjesë e intrigave në këtë novelë. Siç e përshkruajnë në veprën e tyre letrare edhe lojtarët e Shërbimit Inteligjent Britanik, shkrimtarët e njohur Graham Greene dhe John le Carré, këtë botë llagëmesh që e thyen vullnetin e njeriut duke krijuar humnera morale, faji, përbaltjeje e tradhtie, spiunët e të gjitha kohërave nuk mund të kenë dot moral të pastër, sepse morali i tyre është përherë i kompromentuar. Edhe ambasadori në Paris, shqiptaro-osmani Rifat Pasha, i porsamartuar me zonjën e bukur Frida, bijë e rumunit të pasur që është kryeagjenti i Portës së Lartë, nuk mund të ketë fat më të mirë. Titullari i lartë i Perandorisë Osmane, që punon paralelisht për pavarësinë e popullit të tij të drobitur shqiptar, tipizon mjaft figura të mirënjohura të historisë shqiptare që kontribuuan për atdheun mëmë. Çmimi i kërkuar nga qeveritari më i lartë i shtetit të madh francez — gruaja e tij e bukur për një natë, në këmbim të pavarësisë së shtetit të ardhshëm amtar — nuk do të kishte zgjidhje tjetër veç fatalitetit. Autori thotë se ka dashur të tregojë se shpesh në fatet e popujve vendosin edhe rrethana ordinere, jo vetëm peshorja diplomatike e Fuqive të Antantës.

Në këtë novelë gëlojnë personazhe të larmishme ballkanike e më gjerë, para dekoresh të inskenuara në pritje të një ngjarjeje, "Shqipërisë së palindur akoma", siç e quan autori.

Novela e tretë "Ereksioni i të vdekurit"

Bazuar në një prej faqeve më tronditëse të traumave të shkaktuara nga lufta civile që shoqëroi vendosjen e pushtetit pas Luftës së Dytë, është dënimi i Prek Calit, bajraktarit legjendar, kreshnik i gjallë i shek. XX, siç shfaqet dhe në fotografitë e Marubit e filmimet e arkivës italiane, i cili, në faqet e historisë shqiptare të një kohe të mëparshme, ktheu mbrapsht mushka të ngarkuara me thasë me flori nga Krajl Nikolla dhe nuk e shiti lirinë e trojeve të të parëve. Në novelën "Ereksioni i të vdekurit", nëpërmjet personazhit të Prend Camës — Giga-Burri e quan atë autori A. Ahmetaj — është sjellë një personazh letrar krejt i ngjashëm me Burrin e Malësisë, edhe pa qenë ai vetë, Prek Cali.

E përbindshmja Zejnep do të marrë jetën e një figure malësore, racë gjigandësh në pamje e në bëma gjithashtu. Ajo e zhvesh nga kostumi kombëtar Giga-Burrin dhe i hedh një kapotë ushtarake gjermane, i pret flokët, mjekrën, mustaqet, jep urdhrin për pushkatim, e godet të vdekurin me plumbin e fundit në ballë nga dora e saj, vëren fenomenin e quajtur me termin latin "mors erectio" dhe e përfshin në raportin sekret. Komisari Memo gjykon me të folurin e brendshëm se ishte Zejnepi vetë një ereksion vdekjeje.

Veçanërisht për tre-katër faqet e fundit që përfundojnë këtë novelë, do t'i thosha shkrimtarit Arbër Ahmetaj, si Viktor Hugo Sharl Bodlerit për poezinë jashtëdimensionale "Shtatë pleqtë", që i kushtohej vetë Hygoit: Miku im, ju i keni dhënë artit një rreze makabre, ju i keni shtuar botës një rrënqethje të re!

Novela e katërt "Qumështi armik"

Pas Bardhoshes, dhisë së Zotit Sëgen, në novelën e famshme të Alfons Dodesë, që arriti një rekord në qëndresën ndaj ujkut natën në pyll gjersa ai e mbyti në mëngjes, do të kemi dhe Bardhoshen e Arbër Ahmetajt në novelën e fundit "Qumështi armik".

Në çdo klasë shkollarësh e më gjerë kishte nisur fushata e propagandës, që mbulonte gjithë Shqipërinë, në fakt. "U tha se prona private ndalohej me kushtetutë. Aty u ngrita si villak i njomë dhe kërkova leje të bëja një pyetje: – A është dhia ime pronë private?" Shpendët dhe kafshët e dashura të shtëpisë që na ushqenin ndalohej tanimë t'i mbanim nëpër oborret tona, sepse kjo nënkuptonte përfitime nga prona private dhe ne ishim shtet me ekonomi të përbashkët socialiste.

E kujtoj dhe unë atë kohë në Fier, që ka qenë rreth viteve 1976–1981; gjyshja ime u trondit që nuk do të na lejohej të mbanim më asnjë shpend a kafshë shtëpiake në kopshtet e shtëpisë. Meraku i saj më i madh ishte gjeli: si mund të ndalohej me ligj të mbaje të paktën një gjel fushe, i cili duhej të këndonte çdo mesnatë, sepse kënga e tij largonte hijet, gjë që e thotë dhe Shekspiri, si te "Makbethi" - fantazma e Bankos - ashtu edhe te "Hamleti": hijet do të zhdukeshin sapo të këndonte gjeli i parë. "Njeriu duhej të kujdesej për çdo fjalë të folur e çdo hap të hedhur nga perëndimi i diellit gjer në mesnatë, sa të këndonte gjeli i parë, se mos e dëgjonin apo se mos shkelte hijet", ishte porosia e gjyshes. Madje u betua se do ta lidhte për këmbë te krevati i saj, do ta ushqente brenda një torbe poshtë krevatit, sa për të mos i munguar shtëpisë kënga mbrojtëse e gjelit.

Fushata e dha rezultatin e pritur nga ideologjia komuniste. Mbaj mend që Vitin e Ri 1981 e kemi festuar me peshk, sepse nuk gjeje mish as në dyqan dhe as në shtëpi nuk kishim më shpendë. Kjo ndodhte dhe në Myzeqe, që konsiderohej hambar ushqimor, e ku gjeli i detit është tipik i zonës në festën e fundvitit! Dikush që nuk e ka jetuar vetë atë kohë nuk e kupton dot absurdin e kësaj fushate propagandistike, që varfëroi në ekstrem ushqimin e shqiptarëve.

Çfarë grotesku ngrihet nga autori në novelë për fatin e Bardhoshes! Ne jemi brezi që e kemi përjetuar në realitet. Ja, për gjëra si këto, Beckett shkruan: "Mbërthyer tek disa detaje të shkretëtirës, syri mbushet me lot"!

Dhia Bardhoshe në novelë tanimë nuk quhet as dhi, as Bardhoshe, por ka marrë emrin: pronë private që ushqehet nga gjethet e bisqet e pyllit, pronë e përbashkët, dhe duhet të tufëzohet në kooperativë për të dhënë qumësht si pronë e përbashkët socialiste. Pak rrënjë domate e bistakë rrushi në bahçe janë gjithashtu prona private që kërcënojnë besimin tek rendi socialist. Termat e kohës: çeta e pionierit, shalli i kuq i pionierit që simbolizon gjakun e dëshmorëve, fletërrufeja, janë instrumente të darës shtrënguese në ndjeshmërinë e fëmijës për kafshën e tij të dashur, Bardhoshen, që përfundon e therur mbi dëborë.

Skena e fundit i përket një kohe tjetër, ku personazhi kandidon për deputet i Partisë Liberale. Dikush ngrihet sërish t'ia tjetërsojë kuptimet e autokritikës së fëmijës me detyrim - përcaktim ndaj fletërrufesë, sepse ndërron vetëm terminologjia. Fushata mbetet fushatë edhe në pluralizëm. Autori, që e tregon historinë në vetën e parë, e mbyll novelëzën: "M'u qesh. Gjithçka e së kaluarës sime mund të përdorej kundër të ardhmes time. Sa herë kthehem në vendlindje, atje në pyjet me mjegulla, më duket se shoh trupin sa një lis të çobanit pararojë, duke i grahur jo një tufe dhish, por një kopeje njerëzish të mërdhirë pas një dimri të gjatë".



Personazhet e vijës së dytë dhe ata episodikë në prozën e Arbër Ahmetajt, si Nik Mira i Franës; plaka Fazë me formulat e vjetra të shërimit në laboratorin e saj të magjisë, që plakat si ajo i praktikonin me sukses të plotë; dervishi që shpjegon ëndrrat edhe më saktësisht se Frojdi vetë; mirditori Orosh Mirko, ky spiun tipik shqiptar që shet informacione konfidenciale me para në dorë dhe nuk ka asnjë shef; komisari Memo, një tjetër xhelat i së njëjtës gijotinë, që kishte vrarë njerëz në shtëpinë e të cilëve kishte ngrënë, edhe pse vet stepet para të përbindshmes kolege Zejnep; e çdonjë tjetër personazh i tillë në novela, janë sjellë me profil të spikatur nga autori Arbër Ahmetaj, sa jo vetëm ndihmojnë, siç pranohet nga kritika letrare, në zhvillimin e ngjarjes me personazhet kryesore, por edhe, në miniaturë, qëndrojnë brenda historisë vetiake, si një tjetër ngjarje e pavarur brenda besueshmërisë antropologjike.

Në fund të leximit, novelat e këtij libri vijnë si mënyra të ndryshme për të dëshmuar të njëjtën gjë: historia e madhe përzihet tragjikisht në fatin e njerëzve. Ajo hyn në vatrën familjare të secilit, lë gjurmët e saj në ndërgjegje, në trup, në kujtesë. Personazhet, nën peshën e ngjarjeve, marrin vendime që përcaktojnë fatin e tyre, por siç na dëshmon leximi i këtij libri, para se të mbërrijë tragjedia, jeta ka ndodhur.

Duke lexuar poezinë e Klara Kodrës

KUR FJALA KTHEHET NË DASHURI

(Vështrim eseistik)

Nga Shefkije Islamaj

Njësia më e vogël në gjuhë që bart kuptim dhe vlerë fonetike është fjala.[1] Ky përkufizim nëpër kohë u zgjerua duke u veshur me tipare të tjera, si fjala vjen: njësi që shënjon nocion ose veprim, njësi kuptimore që mund të qëndrojë e pavarur, njësi themelore e të folurit, njësi marrëveshjeje (konvencioni), shenjë që nyjëton mendimet dhe komunikimin (të folurit logjik), përkufizime këto të mbështetura në përshkrimin e hershëm bazë të të paharrueshmit Aristotel në veprën e tij "Organon". Por, Aristoteli s'u mjaftua me kaq, përkufizoi edhe artin poetik, përkatësisht fjalën poetike në "Poetikën" e tij famshme themelvënëse për poetikën e sotme. Fjala poetike sipas tij nuk është vetëm simbol i ndjesive, i përvojave dhe i sendeve, por është shenjë e përjetimeve shpirtërore që përfaqësojnë sendet, prandaj ajo është i mjeti patjetërsueshëm i poetit. Pa të nuk ka poezi. Poeti lind e vdes me fjalën poetike.[2]

Ndonëse fëmijë, që në fazën e hershme të jetës së saj, Klara Kodra u magjeps pas fjalës, pas fshehtësisë e magjisë së saj, pas fjalës si mendim, pas fjalës si ndjenjë, pas fjalës si ide, në të vërtetë u josh pas fuqisë së fjalës, sepse vetëm ajo, fjala, mund t'i japë njeriut ngrohtësi, shpresë, guxim dhe dashuri. Fjala, pra fjala poetike, e shoqëroi deri sot, në të vërtetë Klara Kodra nuk iu nda kurrë asaj, por shtegtoi sa te fjala poetike e sa te fjala ta quajmë "shkencore". I ndërlidhi, i gërshetoi mrekullisht dhe i krijoi vetes një zonë rehatie mes dy fushave krijimtarie, të tillë që mund ta ndiejnë, mund ta kuptojnë e mund ta dashurojnë vetëm ata që kanë jetuar mes të dyjave, që kanë jetuar me to gjithë jetën.

Ndryshe nga fjala asnjanëse, e pangjyrosur, e arsyeshme, e ftohtë, serioze, e rreptë fjala poetike, pra e ngjyrosur, që jeton brenda poezisë e përvijuar ndër shekuj si e tillë, është tjetër, është ndryshe, është e paparashikueshme, është e epshme, është shkëlqyese, është joshëse, shkurt është shpirtërore. E shkruar ose e shqiptuar, e heshtur ose e zëshme, e kënduar ose e vajtuar, fjala në poezi bëhet poetike, bëhet dritë e shpirtit të gjallë, merr shkëlqim qiellor, thjesht bëhet shpirtërore, sepse fjalët lidhen me shpejtësinë e dritës në vargje figurash që nuk janë nga kjo botë, por i përkasin asaj. Fjala derdhet në fuqinë e vetë krijuesit që ka krijuar muzikën dhe kuptimin, prandaj thuhet se boshtin qeniesor të fjalës në poezi e përcakton bashkëjetesa e dhuntisë artistike dhe asaj semantike. Nuk ka fund fuqia poetike e një gjuhe e as fjala e saj. Edhe poetika e fjalës shqipe, poetika e gjuhës shqipe është e pafundshme. Dhe këtë na e kanë dëshmuar folësit e saj, na e kanë dëshmuar krijuesit e saj më të mirë, poetët e shkrimtarët shqiptarët, na e ka dëshmuar këngëtari popullor nëpër shekuj. Që me lindjen në gjuhën amtare, shkrimtari, poeti, nxitet e ndikohet nga energjia e veçantë e lëndës melodike dhe nga shkëlqimi semantik i fjalës, në të vërtetë kështu lind talenti poetik. Shkrimtari i njohur Wystan Hugh Auden e përkufizon poetin kështu: "Poeti është, para së gjithash, një njeri i dashuruar me pasion për gjuhën." Poetët "vjedhin", i gjejnë e i rigjejnë, i përtërijnë e i ripërtërijnë, i aktualizojnë e i riaktualizojnë nga arka e harresës, ndonjëherë me lehtë e ndonjëherë me mundin e gjurmuesit të arit, por edhe duke i krijuar e duke i modifikuar. Ata janë përkushtuesit më të mëdhenj të fjalës e të gjuhës amtare.

Studiuesja Klara Kodra ka lindur me fjalën e me dhuntinë poetike, por në jetën e saj fjala poetike nuk është përkushtimi i saj i vetëm sepse në jetën e saj si krijimtaria shkencore, si krijimtaria poetike, përfaqësojnë shprehjen qenësore të mendimeve, të emocioneve dhe të integritetit të saj njerëzor, intelektual, shkencor dhe artistik, duke vepruar si një urëlidhëse ndërmjet botës së saj të brendshme dhe njëmendësisë së jashtme në të cilën ka jetuar nëpër kohën e saj tetëdhjetëvjeçare e deri sot. Fjala e saj ka formësuar jetën e saj përmes fuqisë së premtimit, të komunikimit dhe të krijimit, sepse të përdorësh fjalën, ta duash fjalën, ta krijosh fjalën, t'i qëndrosh besnike fjalës, do të thotë të zotohesh për të vërtetën dhe për të bukurën njëkohësisht, të qëndrosh fuqishëm midis të dyjave. Klara Kodrës nuk i ka mjaftuar të qenët vetëm poete, ose vetëm studiuese e poezisë, ajo ka rendur pas fjalës e pas mendimit shkencor por ka shtegtuar edhe pas fjalës poetike, pa e lënë anash asnjërën. "Poeti në fillim shkruan, e më pas – këndon" e thotë Ezra Pound.

Prof. dr. Klara Kodra është studiuese e shquar dhe është shumë prodhimtare në fushën e studimeve letrare, duke studiuar me dashuri e me përkushtim të rrallë poezinë më të bukur arbëreshe, më shumë se gjithë të tjerët. Ajo është autore vështrimesh kritike, studimesh monografike shkencore kushtuar shkrimtarëve arbëreshë, studime këto të vlefshme e të rëndësishme në filologjinë shqiptare[3]. Monografitë e saj **"Poezia e De Radës", "Vepra poetike e Zef Serembes", "Tipologjia e poemës arbëreshe", "Dramaturgjia e arbëreshëve të Italisë, "**Jul Variboba në kontekstin e letërsisë shqiptare", "Santori, poet dhe dramaturg" bashkë me përmbledhjet me studime " Rrënjët e lisit" "Paralele dhe kryqëzime", Vallja e rrezeve", I, II, janë kontribute të shquara jo vetëm për studimet e letërsisë arbëreshe, por edhe për letërsinë shqipe në përgjithësi.

Por, Klara Kodra është edhe përkthyese nga gjuha shqipe në gjuhën italiane dhe nga italishtja në shqipen. Ndër veprat e përkthyera në italisht nga shqipja vlen të përmenden krijimet poetike dhe ato në prozë të De Radës: "Odiseu", "Diana" si dhe disa përmbledhje me poezi të shkrimtareve shqiptare, ndërkaq nga italishtja në shqipen ka përkthyer tregimet e shkrimtarit bashkëkohor italian Tomazo Landolfi; romanin "E fshehta e Lukës" e autorit italian, po kështu shkrimtar bashkëkohor, Injacio Silone; "Bija e mallkuar" të F. Paolo Santori; veprën "Jeronim De Rada, poeti arbëresh" të Vittorio G. Gualtierit; një përmbledhje të artikujve kritikë të Benedeto Kroçes të titulluar "Poezia antike dhe bashkëkohore", e deri romanin për fëmijë "Një udhëtim i rrezikshëm" të Bedri Dedjes.

E lindur, këtu e tetëdhjetë e një vjet më parë, më 1945, nga prindër intelektualë (babai Malo Kodra i diplomuar në Austri, e ëma Jolanda Kodra, italiane, studiuese dhe përkthyese e letërsisë), e rritur me dashurinë prindërore mes librash, mes leximesh e kulturës dygjuhëshe, s'ka se si të shmangte rrugën nga ajo e së ëmës. E vogla Klara mori nga nëna shumëçka të dashur, të vlefshme, të dobishme e të nevojshme për të trasuar rrugën e saj drejt e suksesshëm. Na e thotë edhe ajo vetë në kujtimet e saj: " Mamaja kishte vendosur me ne vajzat (me mua dhe me time motër, Etelin), që nga fëmijëria e hershme, një frymë afërsie dhe dialogu. Ajo luante me ne, duke u bërë si të thuash, edhe vetë fëmijë, duke dramatizuar përralla, duke rikrijuar personazhe përrallash me anë të kukullave tona..."[4]

Klara Kodra filloi të shkruajë herët që në moshën fëmijërore. "Poezia është dashuria e parë, sepse ka filluar që kur isha fëmijë" e thotë poetja në një intervistë[5]. Poezitë e para iu botuan që nga mosha 14 vjeçe në revistën "Nëntori" dhe në gazetën "Drita", ndërsa nga mosha 23 vjeçe nisi të botojë përmbledhjet e para me poezi në kohën kur ende numri i poeteve shqiptare ishte modest. Edhe ajo vetë ka shkruar për këtë mungesë e vonesë në letërsinë shqipe edhe së fundi në shkrimin me titullin "Mungesa e grave krijuese në historinë e letërsisë shqiptare – një zbrazëtirë e ndjeshme[6]. Por, ajo s'mbeti vetëm poete. Me të mbaruar studimet në moshën 20 vjeçe dhe me të filluar punën në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë nisi studimet mbi letërsinë, më konkretisht nisi të studio poezinë arbëreshe fillimisht për t'u specializuar siç e thotë ajo dhe nuk iu nda asnjëherë asaj poezie. Por, krahas studimit të poezisë arbëreshe dhe shkrimtarëve arbëreshë, ajo u mor në vazhdimësi dhe me vëmendje të veçantë edhe me poezinë bashkëkohore shqipe, për çka ka botuar disa përmbledhje me vështrime e artikuj shkencorë..

Sot poetja Klara Kodra paraqet zë të veçantë poetik në poezinë shqipe. Ajo është autore e disa përmbledhjeve në poezi e prozë [7] si për të rritur ashtu edhe për fëmijë, që kanë tërhequr dhe që tërheqin vëmendjen e lexuesve për një reflektim më të thellë mbi temat e ndryshme jetësore që ka trajtuar ajo dhe ndër to po përmendim **"Buzëqeshje", "Rrugë të hapura", "Ne rendim", "Bisedë me vëllezërit", "Fjalë të pathëna", "Vjen pranvera", "S'janë lulebore", "Pasqyra magjike", "Erdhi dita e Arbrit", "E vogla e shtëpisë", "Ku janë zanat",** "Kush është më i miri", "Epopeja e maceve, **"Fjalë të pathëna" dhe, së fundi "E-maile nga deti", "Ana e vogël dhe dhelpra Lili", Agora, 2024.**

Përmbledhja me poezi për të rritur "E-maile nga deti" që u botua më 2019 përmbledh 158 poezi dhe 2 poema. Ashtu si titulli i kësaj përmbledhjeje edhe titujt e poezive të përfshira në të, bartin figurshmëri e simbolikë të dalluar, duke hapur kështu dyert drejt temave të ekzistencës, të ritualeve të përditshmërisë, të marrëdhënieve me jetën dhe me njerëzit e dashur. Poezia e poetes jo vetëm nxit lexuesin të mendojë, por ajo shquhet edhe për gjuhën poetike të veçantë, me të cilën lidh në mënyrë të hollë vetjaken me universalen, marrëdhënien e botës së saj të brendshme me botën e jashtme.

Krijimtaria e saj shkencore dhe krijimtaria e saj poetike janë biografia dhe autobiografia e saj. Derisa në krijimtari shkencore ka ndjekur, ka gjurmuar, ka njohur, ka studiuar, ka analizuar poezinë më të bukur arbëreshe të shkrimtarëve më në zë të përtej detit tonë Adriatik, duke përgjithësuar, vlerësuar, arsyetuar idetë e mendimet e saj me forcën e mendjes, krijimtaria e saj poetike ka lindur vetiu që në hapat e saj të parë për ta shoqëruar gjithë jetën deri sot. Poezia e saj ka bashkuar forcën e mendjes dhe forcën e zemrës.

Cila është poezia e Klara e Kodrës?

Është poezia ku ka derdhur mendimet, shpresat, pritjet, sprovat, humbjet, arritjet, frikën, mëdyshjen dhe dashuritë që e kanë shoqëruar shtigjeve të një jete të gjatë të mbushur përvojë e njohje. Poezia për çdo poet është dhuratë, edhe për Klarën tonë, prandaj ajo niset nga brigjet e saj dhe gjithmonë u kthehet atyre, siç u është kthyer edhe në përmbledhjen e saj të fundit. E ka thënë bukur shkrimtari Riçard Bah: "Mund t'i ndryshojmë jetët tona vetëm në atë çast të vogël të përjetësisë që na përket tani." Poezia e saj dëshmon bindshëm shprehjen e saj të fuqishme lirike, e cila në këtë përmbledhje ka arritur qëllimin e synuar. Poezia e saj është mendimore, emocionale, jo rrallë baladike, me një ton rrëfimtar (të brendshëm) dhe me elemente ndërtekstorësie që përshkojnë sidomos vëllimin e fundit. Poezitë e saj paraqesin edhe një dhimbje të fshehur, një kërkim të pandërprerë për kuptimin e jetës.

Jo rastësisht është marrë në shqyrtim përmbledhja e saj fundit poetike "E-maile nga deti", si më e arrira artistikisht, për të shquar lirizmin e saj dhe për të shpalosur Klarën e sotme, mendjen dhe shpirtin e saj të paqetësuar. Këtë e dëshmon tematika e saj e larmishme – fillimisht familjare, e drejtuar shpesh edhe kah e shkuara dhe prejardhja personale, për t'i hapur portën jo vetëm poezisë së dashurisë, por edhe asaj refleksive, patriotike, sociale – që ndriçojnë rrugën e vetënjohjes dhe të kuptimit të shoqërisë bashkëkohore në të cilën ka jetuar e jeton poetja. Si në jetën reale dhe në poezi ajo niset nga fillesa, nga hapat e parë të biografisë së saj personale. Në fjalët, në vargjet, në të shumtën e herës me rima të rregullta, poetja përpiqet të gjejë vendin e saj te lexuesi. Imazhet poetike ndërrohen njëra pas tjetrës, duke lënë pas një gjurmë të ndritshme si fari në det të largët, që jep shpresë dhe tregon rrugën drejt brigjeve. Kjo përmbledhje përfaqëson një lloj ditari lirik i karakterizuar me meditime filozofike të pjekura ndër vite jo të pakta. Hetohet qartë se në mjaft poezi ku shquajnë ndjenjësia e ndjeshmëria e poetes, rrëfimi emocional shndërrohet në nevojë për zbulimin e identitetit personal dhe të impulseve që i vijnë nga jashtë.

Kishte nëntë vjet që s'ishe më,
Nëntë vjet që unë që s'dija gjë
Prisja të të shihja me ankth, me mall,
Nëntë vjet që për ne ishe ende gjallë.
....
Nga larg me aq mall munde ti
Të puthësh veç një fotografi,
S'më rroke dot në krahë të gjallë,
S't'i putha dot flokët e bardhë,
("Gjyshes Marie")

(Vijon në faqen 11)

[1] Aristotel, "Organon", "Kultura", Beograd, 1965 (përkth. nga greqishtja).

[2] Aristotel, "O pesničkoj umetnosti", përktheu Miloš N. Đurić, Beograd, 1988; AristoteL, "Kako ispričati priču. Drevni vodič za pripovedanje, za pisce i čitaoce" (Aristotel, "Si të tregosh një histori. Një udhëzues i lashtë për rrëfimin, për shkrimtarët dhe lexuesit"), MIBA BOOKS, Neven, Beograd, 2023, f.19.

[3] "Poezia e De Radës", monografi, Tiranë, 1974; "Vepra poetike e Zef Serembes", monografi, Tiranë, 1975; "Tipologjia e poemës arbëreshe", monografi, Tiranë, 2001; "Dramaturgjia e arbëreshëve të Italisë", monografi, Tiranë, 2004; "Jul Variboba në kontekstin e letërsisë shqiptare" Tiranë, 2011, "Santori, poet dhe dramaturg" 2020, "Rrënjët e lisit" (përmbledhje studimesh), Tiranë, 2013, "Paralele dhe kryqëzime" (përmbledhje studimesh), "Vallja e rrezeve", I, II, (përmbledhje studimesh), Tiranë, 2020, etj.

[4] Prof.dr. Klara Kodra, "Mamaja dhe ne vajzat" (Fragment nga libri biografik "Jolanda nëna ime"), në gazetën "Exlibris", nr. 318, 23.1.2025 Tiranë, f. 11.

[5] Intervistë dhënë gazetares Vera Pelaj, në Radio *Blue Sky,* 14.6.2009, Prishtinë.

[6] Prof. dr. Klara Kodra, "Mungesa e grave krijuese në historitë e letërsisë shqiptare – një zbrazësirë e ndjeshme", në gazetën "Exlibris", nr. 325, 8.3.2025, Tiranë.

[7] "Era e Revolucionit", poezi, Tiranë, 1968; "Buzëqeshje", poezi, Tiranë, 1970; "Rrugë të hapura", poezi, Prishtinë, 1972; "Ne rendim", poezi, Tiranë, 1974; "Bisedë me vëllezërit"; Tiranë, 1984; "Fjalë të pathëna", poezi, Shkodër, 2001; "Vjen pranvera", poezi, Tiranë, 2008; "S'janë lulebore", poezi për fëmijë, Tiranë, 1986; "Pasqyra magjike", poezi për fëmijë, shqip dhe italisht, Tiranë, 1999; "E-maile nga deti", Tiranë, 2019; "Erdhi dita e Arbërit", novelë, Tiranë, 2003, "Erik"; "E vogla e shtëpisë", tregim shqip dhe italisht, Tiranë, Konica 2005; "Ku janë zanat", përrallë, Tiranë, Erik 2010; "Kush është më i miri", Erik, 2011, "Epopeja e maceve", poezi për fëmijë, Erik 2022 etj.

Dy vëllimet e veprës së Vinçens Markut

Buzuku i lehtëlexueshëm: Një kërkim që ripërkufizon fushën e studimeve buzukiane

Nga Matteo Mandalà

Dy vëllimet e veprës së Vinçens Markut, *Buzuku i lehtëlexueshëm* I dhe II (Botime Françeskane "At Gjergj Fishta", Shkodër, 2025 dhe 2026), vijnë në vëmendjen e komunitetit shkencor si një kontribut origjinal dhe me rëndësi të veçantë metodologjike në panoramën e studimeve kushtuar *Mesharit* të Gjon Buzukut, librit më të hershëm të shtypur që njohim deri më sot në gjuhën shqipe. Rëndësia e veprës së Markut nuk qëndron vetëm në pasurimin e dijeve tona mbi një tekst themeltar për historinë kulturore shqiptare, por mbi të gjitha në përpunimin e një perspektive kërkimore risore, të aftë ta zhvendosë qendrën e rëndesës kërkimore nga një përmasë kryekëput gjuhësore dhe filologjike drejt aspekteve fizike dhe materiale të objektit libror, të cilat deri më sot ishin lënë pas dore.

Për më se një shekull kërkimet mbi *Mesharin* u përqendruan kryesisht mbi tiparet gjuhësore, leksikore, tekstologjike dhe historiko-letrare, duke privilegjuar analizën e tekstit si dokument themeltar në rindërtimin e fazës më të hershme të shqipes së shkruar. Ky impostim prodhoi rezultate të jashtëzakonshme, falë kontributit të një aradhe studiuesish, si Pal Skiro, Mario Roques, Justin Rrota, Eqrem Çabej, Selman Riza, Namik Resuli, Martin Camaj, Wilfried Fiedler, Rexhep Ismajli, Anton N. Berisha e shumë të tjerë, të cilët hodhën dritë në një mori çështjesh të shtruara për zgjidhje mbi gjuhën, burimet dhe traditën kulturore të Buzukut. Gjithsesi, pikërisht larmia e kërkimeve filologjike dashur pa dashur shkaktoi lënien në hije të një aspekti jo më pak të rëndësishëm: vetë librin si objekt material, si prodhim editorial dhe tipografik, si dëshmi konkrete të proceseve kulturore dhe teknologjike që karakterizuan Europën e shek. XVI. Pikërisht në këtë hapësirë kërkimi e gjen vendin vepra e Vinçens Markut. Në fakt hulumtimi i tij e zë fillin nga vetëdija se *Meshari* përbën një dokument të jashtëzakonshëm jo vetëm për çka na thotë me përmbajtjen e vet, por edhe për çka na paraqitet për nga forma dhe aspektet e jashtme fizike, pamore dhe materiale. Nëse të dhënat historike që mund të nxjerrim drejtpërdrejt nga kolofoni na rezultojnë të pamjaftueshme, sidomos për sa i përket prodhimit dhe shtypit të librit, ksombla e vetme që na ka mbërritur përmban një sasi të konsiderueshme gjurmësh dhe të dhënash materiale të cilat, po të studiohen me vëmendje, na ofrojnë një sërë treguesish të çmueshëm mbi mjedisin kulturor, tipografik dhe artistik ku e pa dritën e diellit vepra e Buzukut. Miniaturat, germat nistore të historizuara, zbukurimet, kornizat ksilografike, shkronjat e lëvizshme, shkurtimet, grafemat e veçanta, defektet e shtypit, madje edhe gjurmët e konsumimit të matricave të shtypit, në dritën e veprës së Markut shndërrohen në burime autentike historike me informacione që përndryshe vetëm teksti si i tillë nuk mund të na i japë.

Vepra e Markut na vjen si pjesë e një reflektimi më të gjerë mbi raportin mes shtypit, alfabetizimit dhe ndërtimit të identiteteve kulturore në Europën e periudhës së hershme moderne. *Meshari* nuk na paraqitet më vetëm si monumenti i parë i shqipes së shkruar, por edhe si një prodhim i hershëm shqiptar i revolucionit kulturor që e zuri fillin me shpikjen e shtypshkrimit. Në fakt, në shek. XVI libri i shtypur përbënte një mjet me rëndësi vendimtare në përhapjen e dijes, për qarkullimin e ideve fetare dhe për lindjen e formave të reja të veprimtarisë kulturore. Në këtë suazë vepra e Gjon Buzukut fiton një vlerë që shkon përtej përmasës ngushtësisht gjuhësore dhe letrare: ajo shndërrohet në një dëshmi të qartë të vullnetit të qarqeve kulture të kohës për ta ngritur shqipen në nivelin e një gjuhe të kulturës, duke hedhur kësisoj themelet e një procesi alfabetizimi që do të shpinte gradualisht drejt ngjizjes së një vetëdijeje kulturore të përbashkët. Nga kjo pikëpamje, figura e Buzukut mund të përqaset me atë të Lekë Matrangës, që është një nga pararendësit e traditës letrare të shqipes së vjetër. Nën shtysën e të njëjtit kontekst kulturor dhe fetar, paçka se në rrethana të ndryshme, të dy këta autorë u bënë protagonistë të po atij procesi historik: futjes së shqipes në hapësirën e kulturës së shkruar. Kërkimet e fundit kanë dëshmuar se alfabeti që përdori Matranga për shkrimin e veprës *E Mbsuame e Krështerë* buronte nga synimet konkrete didaktike dhe katekizmore, por edhe nevoja e një alfabetizimi sa më praktik dhe të volitshëm. Po ashtu, studimet filologjike të kryera mbi veprat e Pjetër Budit kanë nxjerrë në pah një vijimësi kuptimplotë grafiko-alfabetike me traditën e *Mesharit*, duke konfirmuar kështu praninë e një hullie zhvillimi kulturor që përshkon gjithë letërsinë shqipe të shekujve XVI dhe XVII. Në këtë kuadër, merita kryesore e Vinçens Markut qëndron në faktin se ai ka vërtetuar që edhe aspektet në dukje dytësore a të parëndësishme materiale të librit të Buzukut mund të shndërrohen në burime të dijes historike. Puna e tij kërkimore dëshmon se shtypshkrimi i vjetër nuk duhet parë thjesht si mjet transmetimi i përmbajtjes, por si një dukuri komplekse ku përmblidhen veçori teknike, zgjedhje artistike, strategji editoriale, nevoja fetaro-kulturore dhe procese shoqërore. Çdo element i *Mesharit* fiton kështu rëndësi dokumentare dhe kontribuon në rindërtimin e një konteksti kulturor që, për shkak të të dhënave të pakta, vazhdon të mbetet pjesërisht në hije.

Merita e bazës teorike të punës së Markut, sikurse e pohon vetë autori, i duhet njohur kontributit të studiueses Lucia Nadin, veçanërisht librit të saj *Albania ritrovata* (Shtëpia botuese Onufri, Tiranë, 2012), si edhe një artikulli të botuar në revistën *Hylli i Dritës* (*Ancora sul* Meshari *di Gjon Buzuku*, nr 1-2 (2015), f. 43-66). Në këto studime kushtuar pranisë dhe rolit të shqiptarëve në kulturën venedikase të shek. XVI, Nadin ishte e para që kuptoi dhe vuri në dukje se shkronjat nistore ksilografike dhe dekorative të *Mesharit* nuk ishin thjesht zbukurime, por dokumente materiale që hedhin dritë në lidhjet dhe marrëdhëniet e autorit me mjediset tipografike venedikase. Evidentimi i këtij fakti i hapi udhën një revolucioni të vërtetë metodologjik në studimet buzukiane, i cili qëndron në lëvrimin e një fushe kërkimi të parrahur më parë.

Vlera e dy vëllimeve të Vinçens Markut qëndron në pranimin e kësaj sfide dhe në zhvillimin e kësaj trashëgimie në mënyrë sistematike dhe rigoroze. Çka bie më së shumti në sy është puna e madhe e identifikimit, e katalogimit, dhe e ballafaqimit të burimeve tipografike që ruhen në bibliotekat europiane, sidomos e inkunabulave dhe librave të shtypur gjatë shek. XVI, përfshirë repertorët ikonografikë dhe koleksionet e specializuara bibliografike. Autori ka kryer një analizë krahasimore të hollësishme, që ka përfshirë dhjetëra botime të shtypura gjatë periudhës mes fundit të shek. XV dhe gjysmës së dytë të shek. XVI. Nga ky ballafaqim ka dalë në dritë një rrjet i dendur marrëdhëniesh që e lidh *Mesharin* me shtypshkronjat venedikase të kohës, duke bërë të mundur në këtë mënyrë ngushtimin e qerthullit të hamendjeve mbi vendin, rrethanat, aktorët dhe faktorët e botimit të librit, si edhe duke konfirmuar, në analizë të fundit, hipotezën e shtruar nga Lucia Nadin.

Me rëndësi të veçantë është pjesa e veprës që u kushtohet miniaturave ksilografike dhe germave nistore të historizuara. Përmes një pune ballafaquese që kërkon një kompetencë të madhe në njohjen e matricave të shtypit dhe përgjithësisht në historinë e shtypshkrimit të periudhës së Rilindjes europiane, autori ka vërtetuar se shumë nga ksilografitë që gjejmë te *Meshari* përkojnë kryekëput me ato të disa tipografëve venedikas, si Bernardino Benali, Lazzaro de Soardi, Luca dhe Antonio Giunta, Bernardino Bindoni, Andrea Arrivabene, Melchiorre Sessa dhe Giovanni Battista Pedrezzano. Ky përfundim nuk mbështetet thjesht në ngjashmëri të përgjithshme, por në matje, krahasime dhe identifikime të përpikta. Nga pikëpamja metodologjike, kjo procedurë merr një rëndësi të veçantë, sepse bën përfundime të verifikueshme nga ana e studiuesve.

Edhe më e rëndësishme është pandehma se do të ketë qenë pikërisht Bernardino Bindoni botuesi i *Mesharit*. Gjithë duke mbetur në suazën e hamendësimeve historike, pasi ende nuk kemi prova të sigurta dokumentare, rindërtimi i Markut karakterizohet nga një koherencë e brendshme që nuk mund të anashkalohet. Prania e përsëritur e germave nistore, përdorimi i matricave të njëjta, qarkullimi i repertorëve ikonografikë të përbashkët dhe veprimtaria e dokumentuar e Bindonit gjatë viteve që paraprinë dhe pasuan botimin e *Mesharit* dëshmojnë një sërë bashkëpërkimesh mbi aspektet më bindëse të gjithë kësaj pune hulumtuese. Kemi të bëjmë me një shembull efikas të një metodologjie gjurmëqëmtuese, ku fuqia e provës nuk mbështetet vetëm te një element i veçantë, por te tërësia e elementeve bashkëpërkuese.

Vëllimi i dytë vjen si plotësim i rezultateve të paraqitura në të parin. Nëse studimi i germave nistore dhe i miniaturave bëri të mundur zbulimin e lidhjeve të ngushta me mjedisin venedikas, rindërtimi i kornizës së frontespicit përbën një hap të mëtejshëm me rëndësi të madhe. Duke u nisur nga një fragment i vogël që ka mbetur në ksomblën vatikane të *Mesharit*, autori ndërmerr një kërkim të gjerë krahasues që e shpie drejt identifikimit të së njëjtës kornizë në një sërë veprash të shtypura në Venecie mes viteve 1491-1525. Bashkëpërkimet që hasen në botimet e *Komedisë hyjnore* të Dante Alighierit, të poemës *Triumfet* e Petrarkës, *të veprave të* Marsilio Ficino-s dhe në shumë botime të tjera mundësojnë rindërtimin virtual të gjithë strukturës së frontespicit të humbur.

Rëndësia e këtij zbulimi shkon përtej identifikimit të thjeshtë të një elementi ornamental. Në të vërtetë ai përforcon thelbësisht gjithë impiantin interpretues të zhvilluar në të dy vëllimet. Prania e së



njëjtës kornizë në vepra që i përkasin traditës tipografike veneciane vendos një lidhje të mëtejshme mes *Mesharit* dhe mjediseve kulturore e shtypshkrimore të Venedikut. Edhe në këtë aspekt spikat hullia që hapi Lucia Nadin, pasi qasja e saj metodologjike mbante parasysh imazhet, matricat dhe zbukurimet jo si detaje të dorës së dytë, por si dokumente historike me rëndësi parësore.

Interes paraqet edhe ndjeshmëria që ka dëshmuar autori ndaj përmasës artistike të shtypit të epokës së Rilindjes europiane. Ksilografitë analizohen jo vetëm si mjete në funksion të prodhimit libror, por si vepra artistike që dëshmojnë qarkullimin e modeleve ikonografike dhe përhapjen e repertorëve figurativë në shtypshkronja të ndryshme. Prej këtej na del imazhi i *Mesharit* si prodhim i integruar plotësisht në kulturën pamore të Rilindjes venedikase, dhe jo si vepër e izoluar a periferike, sikurse e ka përfytyruar një pjesë e historiografisë së mëparshme.

Së fundi, meriton të vlerësohet pozitivisht edhe synimi divulgativ që shoqëron këtë punim. Riprodhimi i disa faqeve anastatike të tekstit me fontin e posaçëm kompjuterik "Buzuku" dhe vëmendja ndaj lexueshmërisë dëshmojnë vullnetin për të pajtuar rreptësinë shkencore dhe përhapjen kulturore të veprës. Kjo përmasë e dyfishtë përbën një vlerë më vete, pasi përhap mes publikut të gjerë rezultatet e një kërkimi shumë të specializuar. Në këtë perspektivë divulgative, do të ishte i dëshirueshëm transkriptimi i *Mesharit* me fontin e ri: një botim i tillë i veprës buzukiane do të përbënte një nxitje të mëtejshme për studimet filologjike dhe njëherazi, një shtysë për ta njohur më mirë librin e parë që kemi në gjuhën shqipe.

Së bashku, këto dy vëllime përfaqësojnë një ndihmesë të vyer për njohjen e *Mesharit* dhe përgjithësisht të historisë së kulturës librore shqiptare. Vlera e tyre nuk qëndron vetëm në zbulimet e veçanta që sjellin, por mbi të gjitha në modelin metodologjik që ofrojnë. Ato dëshmojnë se studimi i një teksti themelor mund të ripërtërihet përmes analizës së përmasës materiale dhe se elemente në dukje të parëndësishme, si fjala vjen, një germë, një miniaturë, një kornizë, një matricë ksilografike e konsumuar nga koha, mund të shndërrohen në mjete të vyera për rindërtimin historik. Në këtë kuptim vepra na vjen si një nga zbatimet e fundit më të rëndësishme të metodologjisë së përuruar nga Lucia Nadin, në funksion të zhvillimit të një faze të re të studimeve buzukiane, të bazuar mbi bindjen se historia e librit dhe filologjia materiale janë po aq të rëndësishme sa edhe analiza gjuhësore për të rrokur plotësisht kuptimin dhe peshën e monumentit të parë të traditës shkrimore të shqipes. Bashkohemi jo vetëm me shpresën e mikut dhe kolegut të dashur Anton N. Berisha, se studime të tilla mund të sjellin elemente të dobishme për të gjetur një kopje të plotë të *Mesharit*, por edhe me nevojën e ngutshme për të ndërmarrë projekte kërkimore të mëtejme që të thellojnë njohjen e tekstit dhe të kontekstit të librit të parë në shqip. Një nga këto projekte është përvijuar kohët e fundit nga një grup albanologësh, – mes të cilëve janë Lucia Nadin, Monica Genesin, Gëzim Gurga dhe autori i këtyre radhëve – në bashkëpunim me disa ekspertë paleografë dhe arkivistë të Bibliotekës së Vatikanit, që shpresojmë të sjellë së shpejti rezultate të frytshme në këtë stinë të re studimesh buzukiane.


Lbet⁊ ſane enſill teb ſtate Pſalmat
penetialle bi part anſte condra
ireſſe : ezore. antiena.
Eot mos ⁊ cuitob.
E OT mos meb
endiſcho ende fu
riet tande : as mos meb
caſtigoh endeb iret tan
de : Eot cbii miſerier en
meteb : p ſe ⁊iam ſemu
neb : ſendoſmeb p ſeb e
ſtenate emii lenkogneues
E ſpirei em anſte turbuom fort : ma tib
Eot dierſeb cur temeb apas endimeb?
Abjes preib meteb Eot : e libero ſpiri
tine tem : emuoh meb ſelbo p miſerier
tande. Der ſeb ende mort ſaſte cus teb

(Vijon nga faqja 9)

Në poezinë e Klara Kodrës dhembja për gjyshen që s'e pa për të gjallë e për nënën që iku shumë herët përvijohet shpesh poezinë e saj ashtu si edhe dashuria ndaj babait, mbesave, nipit e djalit.

Sa herë shkruaj në faqet
Gjithnjë mbetet një hapësirë,
Një hapësirë e bardhë ku shfaqet
Fytyra jote aq e mirë.

Ti m'ike aq shpejt, moj nënë,
Ti ike e s'më the lamtumirë
Nga pema e jetës degëgjerë
Ti re porsi fryt i arrirë.
("Asaj që s'harrohet")

Motivet e detit janë të pranishme dendur dhe përvijohen me një filozofi të hollë jetësore:

Kanë thënë për detin
Se është djepi i Afërditës.
Kanë thënë për detin
Se është djepi i vetë jetës.

Si qielli i kaltër,
Po jo si ai – pafundësi
I ngjan njeriut
Që të pasqyron Ty, Perëndi.
("Deti dhe njeriu")

Jo rrallë poetja përpiqet të shmangë stereotipat e poezisë bashkëkohore. Fjala shfaqet si gjurmë themelore e kërkimeve të pafundme, ndërsa loja midis dritës dhe errësirës bëhet thelb i vargjeve:

Mos vajto për ditët që kanë shkuar,
Kur rinia ka qenë e zjarrtë dhe e sertë.
Bredhi është vërtet gjithnjë i blertë,
Porse bredhi nuk çel lule kurrë.
("Mos vajto")

Sa janë? Pesë, dhjetë, njëzetë?
Me vrap rendin porsi retë,
Si krushq rendin për në Vlorë,
Nuse t'bëjnë Shqipërinë e thinjur
Nga aq shekuj robërie,
Duan t'i thurin një kurorë...
("Vjen nga deti fllad lirie")

Në poezinë e Klara Kodrës, fjala dhe mesazhi bëhen simbol i dritës dhe i trazimit njerëzor. Përmasa meditative dhe ajo filozofike paraqitet e mprehtë dhe e rreptë për jetën, kurse njeriu na shfaqet njëkohësisht si simbol dhe si njëmendësi.

Një qëndistare e shquar është jeta.
Gjithnjë qëndis, gjithnjë qëndis.
Me fije të arta, gri, të zeza
Përherë fatin tonë stolis.

Një qëndistare e shquar është jeta,
Po ne e shajmë se për çudi,
Qëndis pas tekave të veta,
Dhe jo pas sonës porosi.
("Qëndistarja")

Në shumë poezi shquhet përpjekje për modernizimin, intelektualizimin dhe individualizimin sidomos të poezisë patriotike. Patriotizmi për Klara Kodrën është forcë morale dhe identitare. Hetohet shpesh një aforizim i lehtë i shprehjes poetike.

Donim të mbanim në krahë Atdheun,
Po s'ishim Atlasë.
E lamë të shkasë.
("Për brezin tim")

Diellit aq të lashtë pse s'i vjetrohen rrezet?
Sepse rilind përherë nëpër mëngjese.
("Rilindje")

Klara Kodra me përmbledhjen "E-mailet nga deti' trupëzon universin e vet poetik të formuar në një kohë e në një vend shpesh të ashpër. Poezia e saj dallohet për trajtimin e shtresëzuar të temave të përditshme që shndërrohen në simbole universale të ankthit dhe të humbjes, ndërsa në mënyrë të tërthortë thekson kontekstin social pse jo edhe politik, përfshirë këtu temat intime, por edhe ato universale, si ankthi ekzistencial dhe pamundësia e komunikimit me botën dhe me njerëzit, përmes përshkrimeve dhe fragmenteve nga e kaluara dhe njëmendësia duke përfaqësuar një hap drejt gjurmimit të mundësive të reja poetike, duke theksuar tjetërsimin dhe përpjekjen për të gjetur kuptim në një botë që duket jo vetëm e fragmentuar por edhe kaotike.

Ishin binjake
Ishin vigane
Mrekullisht të bukura
Një mahnitje pa anë.

S'janë më.

Vjell qielli
Shkëndija,
Tym,
Zjarr.
S'është zemëruar Perëndia.
Po kush?
Njeri
A djall?
("Rekuiem për kullat vigane")

Përmbledhja "E-mailet nga deti" e Klara Kodrës është një udhëtim i bukur poetik i mbushur ndjenjë dhe përpjekje për t'u shkëputur nga bota e madhe që e rrethon për të gjetur bregun ideal, një ishull a një strehë të ngrohtë. Çdo varg është bashkëjetesë e fëmijërisë, e atdheut, e familjes, e miqve, e dashurisë, e natyrës dhe e vetë jetës me të mirat e të këqijat. Është poezi intime, që shpesh duket se pyet lexuesin: "Çfarë është ajo që marrim më vete në përjetësi?"

Jam e bindur se përmbledhja "E-mailet nga deti' është një nga librat poetikë më të pjekur artistikisht të poetes Klara Kodra. Stili i poetes në këtë përmbledhje përfaqëson një hap përpara përmes një lloj minimalizmi ku skena në dukje të zakonshme mbushen me kuptime të thella dhe me meditime filozofike.

S'është e lehtë të biesh për
Lirinë.
Po nuk është më e lehtë të jetosh.
("S'është e lehtë")

Gaboi Zeusi dikur
Kur Prometheun
Në shkëmb të tmerrshëm
E pat mbërthyer
Kryet t`ia kish stolisur me një
Degë dafine
Do ta kishte thyer.
("Një degë dafine")
Ose:
Mora një copë qiell,
Mora një re të bardhë
Që ty të të mbështjell.
("Manteli që bleva për ty")

Përmes kësaj përmbledhjeje, poetja ndërton një gjuhë poetike të veçantë, gjuhë që shpreh përvojën e saj artistike dhe temat globale që prekin çdo individ.

Për Klara Kodrën poezia është impulsi më shpirtëror i qenies në gjuhë drejt njohjeve të thella, vertikalja shpirtërore e ekzistencës njerëzore, është bota ku dashuria është shtysa kryesore e njeriut, është kuptimi i qenies së tij dhe mjeti shërues për çdo sëmundje shpirtërore ose fizike, mjet me të cilin na fut në botën e saj shpirtërore, përkatësisht na e shfleton botën e saj shpirtërore ndër vite, më mirë të thuhet gjithë jetën e saj. Poezia e saj është dëshmitarja besnike e jetës së saj.

Si përfundim: e nisa këtë vështrim me fjalën dhe po e përfundoj me fjalën dhe me mendimin se poezia është ajo që e pavdekëson fjalën, që e pavdekëson gjuhën, që e ruan më së shumti e më së lehti pavdekësinë e saj duke zgjeruar mundësitë e mjetet e saj, duke e rilindur dhe duke e fisnikëruar. Si forma më e lartë e shkrimit letrar, poezia është, në thelb, paradigma shpirtërore dhe ontologjike e jetës së gjuhës, por në kontekst të ngushtë këtu është edhe paradigma shpirtërore e dhe ontologjike e jetës së Klara Kodrës, është shpirti i saj.

Vlen të thuhet prandaj: jo vetëm "jeto për të treguar", por edhe shkruaj për të jetuar.

25 mars 2026

XHELAL TOSKU

i vetëm pa miq pa shokë

poezi

* * *

i vetëm pa miq pa shokë
do dal në qytet
do hyj
në pijetoren më t'parë
për ty do pi verë
gjersa të më vijë përqark e gjithë bota
qyteti pijetorja dhe unë vetë
dhe nëse nuk do më hapen më sytë
aq më mirë
se pa ty nuk rrihet

* * *

era që frynte vinte nga deti
ti ike
tek unë filloi dhimbja

bota shihte jetën e saj

* * *

netëve më duhet pakëz dritë
dhe Zoti im më jep pakëz dritë
dritë të butë hënore dhe dritë yjesh
gjithë ditën më duhet dritë shumë
dhe Zoti im gjithë botën e vesh me dritë
dhe dashuria jote që më vjen prej teje
ndriçon shpirtin tim
të dua

* * *

në kopësht unë kam mësuar të rri vetëm
vetëm ai që rri vetëm e di pse ka mësuar të rrijë vetëm
në kopësht unë kam mësuar të flas me veten
vetëm ai që flet me veten
e di pse flet me veten

në kopësht unë kam mësuar të hesht
vetëm ai që hesht e di pse hesht

në kopshtin tim rri i varur i gjithë qielli

* * *

Luigj Gurakuqit

erërat dimërore ende nuk kanë shkuar
marsi çel lule gjaku

o gjaku im
o gjaku im
qenka e thënë :
vetëm gjaku na bën të mosvarmë

marsi yt
marsi im
erërat dimërore ende nuk kanë shkuar

* Luigj Gurakuqi vrarë më 2 mars 1925

* * *

dhe i pushkatojnë vetë maskat e tyre
dhe maskat nuk kanë të mbaruar
dhe nuk dorëzohen kurrë
dhe kurrë nuk kryejnë vetëvrasje

fishekun e fundit nuk e ruajnë për veten

fishekun e fundit e ruajnë për mua

* * *

lumi im
Shkumbini

rrjedh në vërshimin e vet
në qetësinë e tij
vjen nga larg
mbush kohën me udhëtim

unë nuk mund të jem tjetër
veç çfarë jam

endem brigjeve të mia

dhe pres të vijë përsëri

lumi im
brigjeve të Shkumbinit

* * *

një shqiptar shkon në luftë
kur lufta nuk dihet kur ka filluar
(dhe as dihet se kur një luftë mbaron)
me të huajt lufton
me të vetët lufton

ky është fati i shqiptarit

në luftë

* * *

hëna e veshur me natë
ti e veshur me dritë
gëzimi i jetës time gjithë freski
dhe shpirti im i zhveshur

* * *

pemët bëjnë atë që dinë të bëjnë

dhe kafshët atë që dinë të bëjnë bëjnë

zogjtë bëjnë atë që dinë të bëjnë

vetëm njerëzit
çfarë nuk dinë të bëjnë

* * *

këtu rrija unë me padurimin dhe ankthin tim të pritjes
andej nga ana tjetër vinte ajo

këtu qëndroja unë
që nuk më bëhej të ikja
gjersa silueta e saj humbiste në fund të rrugës

e kush do t'ja dijë
për dhimbjet dhe brengat
në shpirtrat e dy njerëzve që duhen.

* * *

miku im i shtrenjtë Volter
(askush nuk më ndalon të kem mik)
më në fund u ktheva dhe unë në kopshtin tim

tamam si më pate thënë ti
këtu e në mote të shkuara

të jam përjetë mirënjohës miku im

* * *

nëse ndodh që bota të zhytet në errësirë
ti do jesh drita ime

dhe kaq më mjafton

* * *

ku do shkonim
kush na thërriste

mirë do ishte
të kishim humbur rrugën
mirë do ishte të ishim kthyer prap atje

edhe yjet mbështillen me natë
me errësirë të mbështilleshim edhe ne

më mirë ishte të kishim humbur rrugën
më mirë do kishte qenë të qëndronim atje

tek çastet që nuk përsëriten

* * *

e dashura ime

ka të ngjarë që ne të dy nuk vijmë nga Eva dhe Adami

ka të ngjarë që Adami nuk e ka dashur Evën sa unë ty

ka të ngjarë që Eva nuk i jepte Adamit kaq dashuri sa ç'më jep ti

a fillojmë një botë tjetër
a fillojmë një botë të re

* * *

sonte nuk mu dashka as shkëlqimi i yjeve
as ndriçimi i hënës
nuk mu dashka as kjo qetësi e kësaj nate që shtrihet gjithkund
më paska marë malli për shkrepëtimat e qiellit
për përplasjen e shiut mbi tjegullat e çatisë
për përplasjen e shiut në xham të dritares
më paska marrë malli për shiun
për shiun
dhe sidomos për zërin tënd që më thërret në emër

* * *

kam vendosur kokën mbi duart e mija të kryqëzuara
dhe kam mbyllur sytë
nëse ajo ikën e para do më presë me krahët hapur
nëse unë iki i pari do ta pres me krahët hapur
kështu e kemi vendosur
këtu jemi të ndaluar

ky është sekreti i jetës time dhe do ta marr me vete

gati po më merret fryma

* * *

si t'i harroj unë sytë e tu
nuk mund ti harroj dot sytë e tu

si ti harroj unë duart tuaja
duart tuaja qëndronin në duart e mija

si ti harroj unë flokët e tu
gishtërinjtë e mi në flokët e tu

si të harroj unë ty
ti e mbështetur e gjitha tek unë

teksa mbrëmja binte mbi det

* * *

Sizif edhe guri im mori rrokullimën

paskam pasur fatin tënd

* * *

imzot Noli
e provova dhe unë me mullinjtë e erës

dhe falë teje nuk u bëra as deputet as president as kryeministër

të falem imzot

* * *

mendova se dola nga çmendina
mendova se shpëtova nga çmendina

prapë dëgjoj duartrokitje

* * *

qysh çastin që u pamë
lashë përgjithmonë jetën time
në duart e saj

duart e saj
qysh prej çastit që u pamë
qëndrojnë gjithmonë në duart e mija

* * *

shpirt i vogël
ti mos qaj

bilbili nuk qëndron vetëm në trëndafilin tënd

bilbili nuk këndon vetëm mbi trëndafilin tënd

gjithmonë
ngjitur me kopështin tënd ndodhet një kopësht tjetër

po ti mos qaj
shpirt i vogël

* * *

më mungon dielli që për pak po binte matane detit
më mungon anëdeti me rërën e lagur
dhe guaskat e vogla
më mungon deti

më mungon mbrëmja aromë leshterikësh deti
më mungon
mbrëmja aromë portokajsh dhe mërsinash
dhe hëna që sapo del

më mungon ti me gishtërinjtë e tu
bashkuar me gishtërinjtë e mi
më mungon ti e mbështetur tek unë

sa shumë ti më mungon

po ku të kërkoj
po ku të gjej

Migjeni

iku nga jeta fare i ri
na e sjell vdekja gjithmonë e më të ri
duke ndërtuar përjetësinë

* * *

me duart plot lule
nga shpella njerëzimi arriti në shtëpi

jo të gjithë

* * *

fill i vetëm
kam thirrë
e kam thirrë
emrin tënd

ende më vjen
e më vjen
jehona
e zërit tënd

* * *

tek mbeti atje e vetme
ulur në stolin prej druri
duke pritur autobuzin e linjës
mu duk sikur e lashë në mes të katër rrugëve

kjo dhimbje që kam
do vdesë bashkë me mua

* * *

në luginë
vjen e pushon era e pyllit

mbi trëndafil
këndon një bilbil

në thelb kënga e tij thotë :
jeta është edhe fat

* * *

ndriçonte hëna
si sonte

në natën
kur kam qarë
për pikëllimet e gruas që me mua qeshte
me lot

dhe ajo e di

* * *

* * *

Në stacionin e trenave në Rrogozhinë

çuditërisht u ndjeva vetëm
vetëm dhe bosh
bosh si ky stacion treni
që dikur ishte plot njerëz
ku dikur pa pushim kalonin dhe qëndronin
trenat

* * *

dal dhe unë në qytet
mbase ka mbetur ende ndonjë njeri që më
njeh
mbase ndonjë grua mi hedh sytë edhe kot

* * *

Tetidë, nënë e pavdekshme e Akilit
ti e dije se Troja do binte
ti e dije që yt bir do vritej
ti e dije që yt bir do vdiste
pse nuk e ndalove
pse e lejove për luftë të nisej

* * *

për mrekulli këtu tani filloi shiu
se edhe dielli që është diell
(kur thonë)
bëhet i bezdisshëm
në të vërtetë hëna dhe yjet jo
po unë dua të rri vetëm me ty
vetëm me ty dhe të endemi rrugëve nëpër
shi

* * *

ajo më tha : në botën tjerët do martohem
me një mbret

në botën tjetër unë do jem mbret

* * *

në fund të fundit
unë kam lindur prej dasburisë
në fund të fundit
unë jam rritur prej dashurisë
në fund të fundit
gjithë jetën unë kam kërkuar dashurinë
në fund të fundit
ti e di që je e zgjedhura ime
në fund të fundit
ti e di që të dua
në fund të fundit
unë do vdes prej dashurisë

* * *

edhe në netët me hënë
edhe në ditët me diell

të isha në ty
i pasqyruar
si shkëmbi mbi det

përgjithmonë

* * *

të gjitha mbrëmjet e mia
kanë aromën e një mbrëmjeje

e gjithë nata mbahet tek hëna

* * *

rrethi zvogëlohet e zvogëlohet dhe bëhet
pikë
rrethi zmadhohet e zmadhohet dhe bëhet
univers i tëri

ti pika dhe universi im

* * *

ti je qielli im

dhe hera herës fytyrën time e lag shiu

* * *

fiksuar si bilbili mbi trëndafil

këndoj unë për ty
natë për natë

* * *

më dhuroi verë nga vreshtat e Greqisë
dhe nuk deshi ta pimë bashkë

nuk besonte as në Zot
vetëm Zoti e di ç'do bëhet me këtë grua

* * *

koha thjeshtë ikën

as e shohim
as na sheh

(të ikshëm jemi dhe ne)

ç'trishtim i madh të shkosh
pa të parë me sy
qoftë edhe një herë të vetme

ty

Karikaturë nga Arben Meksi



KATERINA GOGU

Si më vështron kështu

Përktheu e përgatiti: **Armela Hysi**

Katerina Gogu (**Κατερίνα Γώγου 1Qershor 1940 - 3 Tetor 1993**) qe një aktore dhe poete e shquar greke. Ka filluar aktrimin që në moshën parashkollore dhe u cilësua si një fëmijë gjeni, teksa më vonë veç skenës së teatrit dhe kinematografisë, shpalosi edhe talentin e saj në poezi. Si poete shkruante poezi moderne dhe vargje të lira ku vinte në dukje vetminë, padrejtësitë sociale dhe njerëzit e "padukshëm", me karakter revolucionar në mjaft raste, kundër sitemit politik, me frymë simbolike ndaj përshkruhet si një shpirt anarshik që nuk gjente prehje. Në biografinë e saj cilësohet se karakteri i vet i papajtueshëm dhe gjendja e saj e lëkundur psikologjike e çuan nga abuzimet e ndryshme me substanca e alkool deri në vetëvrasjes në vitin 1993.

Si më vështron kështu
Si më vështron kështu
kjo copë e bardhë letre
si më vështron kështu hëna...
Si fëshfërin brenda meje
kjo hartë e akulluar thellësisë
si më vështron kështu hëna...
Së cilës kohe gishti i trishtuar
fshehur pas pyjesh e malesh
dëfton kudo e askund
çfarë dëshiron hëna...
Së cilit kalë të ndërkryer
hingëllima
përçon kaq fort jehonën brenda meje
sa bymen Egon time...
Së cilës hëne eklipsi
së cilës hëne venitja
së bashku shtijnë brenda meje
baticë e zbaticë motërza binjake
të mijat...
si më vështron...
Si përkulet kështu mbi gojën time
të shohë
në po marrë frymë ende, Kariotaki.*

*Kosta Kariotaki **(Κώστας Καρυωτάκης, 1896–1928)** poet i shquar grek me frymë ekzistencialiste.

BESA KALAJA

Vdekjet e vogla

tregim

Në katin e dytë të shtëpisë, aty ku kujtimet e fëmijërisë kishin filluar t'i zbeheshin, iu desh të ngjitej. I thanë se gjyshes, që mendonte se shumë afër do të vdiste, i ishte tekur që të gjitha rrobat e saj të laheshin, të paloseshin me kujdes dhe të vendoseshin në bohçe, për t'u shpërndarë më pas te shoqet e saj. U qe lutur që ato të mos hidheshin, sepse ishte e bindur se do t'u pëlqenin.

"Ec e bjeri në fije kësaj pune", mendoi. Dukej sikur gjyshja donte ta vazhdonte ekzistencën e saj në këtë botë përmes rrobave. Çfarë u duheshin rrobat e bajtura grave të tjera, që edhe ato nuk e kishin fort të gjatë?

Duke u ngjitur shkallëve, filloi të bënte llogaritë. Gratë do të vdisnin një ditë dhe familjarët do t'ua kthenin rrobat. Dhe ato rroba, me shumë gjasë, do të ktheheshin prapë te gjyshja. Veç mendimi e bëri t'i shkonin djersë të ftohta trupit.

U drodh, por jo nga frika e vdekjes. Asaj nuk i ishte frikësuar kurrë.

Një gjë nuk po e kuptonte pse gjyshja mendonte kaq shumë për vdekjen, kur nuk ishte e sëmurë dhe nuk kishte asnjë shenjë që ta paralajmëronte fundin.

I ra lehtë ballit kur kuptoi se ajo ishte caktuar për shpërndarjen e rrobave. Pesë shoqe të gjyshes do të përfitonin nga kjo dashamirësi e fundit. Në secilën bohçe gjendeshin shënimet me emrat dhe adresat e tyre.

Kur i pa, kuptoi se për t'i gjetur duhej të shkonte në vende të ndryshme. Kjo shpërndarje gjeografike filloi t'ia shpërqendronte mendimet. Kush do t'i përballonte gjithë ato shpenzime të rrugës? Pak banale, mendoi.

Për një çast i shkoi në mendje se, nëse gjyshja do t'ia mbulonte shpenzimet, ajo mund t'i kthente këto udhëtime në diçka të bukur, të vizitonte disa vende njëherësh, secili më i ndryshëm se tjetri. Sapo i erdhi kjo dëshirë, iu duk e turpshme ta mendonte në këtë mënyrë.

I erdhi keq për këto mendime. Gjyshja për të kishte qenë njeriu më i dashur i shtëpisë, prej së cilës ishte larguar vite më parë. Kur i kishin thënë të kthehej, nuk kishte ditur ta përjetonte si ankth apo si kënaqësi, sepse asgjë më nuk i lidhej me atë vend.

Edhe shkallët po ia rëndonin trupin, ndërsa zbriste me bohçet në duar.

Megjithatë, një kureshtje nuk po e linte rehat.

I kujtohej se disa prej rrobave të gjyshes, ato të kohës së nusërisë, i kishte veshur tinëz disa herë. Qëndronte para pasqyrës dhe merrte poza, sikur donte të shihte nëse kishte trashëguar diçka prej saj, pak elegancë, një gjest, një qëndrim apo cfarëdo qoftë.

A ishin ato rroba në bohçe mund ta dinte vetëm nëse i hapte, e ketë natyrisht nuk do ta bënte. I mjaftonte që të gjitha pyetjet për to t'i bënte në heshtje s'e nuk mund që këto mendime t'ia shprehte askujt, aq me tepër kur ne pyetje ishte ajo.

...

E gjendur në një udhëkryq rrugësh, ajo mori frymë thellë. Qyteti ishte i bukur, me një lloj rregullsie që nuk e kishte hasur kurrë, ani pse kishte udhëtuar shumë. Nuk dinte nëse duhej të ulej në një stol në parkun e vogël të qytetit apo të vazhdonte kërkimin. Edhe një kafe i pihej.

Lokali që pa pak metra më tutje ishte i vogël, i fshehur nën hijen e një druri të madh. Ia mësyu. Një grua në moshë të mesme e priti me buzëqeshje. E kuptoi menjëherë se nuk ishte e atij vendi, prandaj mysafires i gjeti vendin më të bukur, në qoshen e verandës, mes vazove me trëndafila.

-Tani do t'jua marr porosinë, - i tha me një zë të butë.

E gjendur mes aromës së trëndafilave, ajo u përhumb për disa çaste. Nuk dinte nëse duhej ta merrte në telefon apo t'i shkonte drejt te shtëpia, e cila ndodhej vetëm pak metra larg. Frika që kishte pasur nga ai takim dukej se po zbehej dalëngadalë, ndërsa thithte aromën e luleve dhe vështronte njerëzit që kalonin qetësisht.

Pas pak, dera e vogël e oborrit përballë u hap. Dy gra dolën jashtë. Njëra ishte në moshë të thyer, por fytyra e saj ruante një bukuri të rrallë, të qetë, thuajse fisnike. Për një çast mendoi se kishin dalë për kafe dhe nuk u kushtoi shumë vëmendje. Sapo gruaja e moshuar ngriti kokën, sytë e tyre u takuan.

Ajo buzëqeshi lehtë, sikur ta kishte pritur prej kohësh.

-Paske ardhur?

Mbeti pa fjalë. Nuk dinte nëse pyetja kishte të bënte me adresën që kërkonte apo me gjithë udhëtimin që e kishte sjellë deri aty. Për herë të parë që kur kishte marrë bohçen në duar, ndjeu se ndoshta nuk kishte ardhur vetëm për

t'i dorëzuar disa rroba.

Kur ia dorëzoi bohçen, ajo e mori me një lloj përkushtimi të çuditshëm.

-Ah, ajo... -tha dhe buzëqeshi. Dinte ta mbante veten, rrobat kanë po të njëjtën aromë.

E hapi bohçen ngadalë, duke i ndarë fustanet në njërën anë e bluzat në tjetrën. Veçoi një fustan të lehtë dhe, pa pyetur, e vuri mbi vete.

-I rrinte mirë. Ka ditur gjithmonë të zgjedhte më të mirët.

Ajo e pa, pa folur. E dinte që gjyshja kishte diçka veçantë të tjerëve po nuk e kishte parë kurrë me kaq shumë vëmendje.

Kur doli, i dukej sikur kishte lënë pas një version të rregulluar të saj.

...

Nuk e ftoi brenda menjëherë. Një fytyrë nevrike dhe pa jetë po i bënte pyetje me një ton çuditërisht të ftohtë sikur ta kishte njohur prej vitesh.

-Çfarë janë këto?- e pyeti, duke parë bohçen.

-Rrobat e saj... ka dashur t'i ndani.

Gruaja i mori në dorë, por nuk i hapi. Mund t'i marrësh prapë me vete i tha, nuk kanë çfarë më duhen, as kam kujt t'ia jap.

- I ka lënë me emra, u mundua ta bindtte.

-E di,- e ndërpreu, po s'kam nevojë për to.

Pasoi një heshtje e shkurtër.

-Nuk ka qenë siç e mbani mend,- shtoi më pas. - Nuk di si të të them kishte një anë që nuk e donte askush. Për çudi fytyra iu zbut aq shumë sa sytë po i shkëlqenin.

-Më duket që nuk ke trashëguar asgjë prej saj,- i tha. -S'e di a po më kuptoni, i tha ishte mbizotëruese, në biseda, në takime, në gjithçka. Dukej më bukur se ne të gjitha dhe kjo më bën sot ta refuzojë. Jo ty, por atë.

Nuk i mbeti shumë veç ta merrte bohçen dhe të largohej.

....

Zgjodhi njërin nga fustanet dhe po i tregonte se atë ia kishte bërë dhuratë për martesë. U emocionua shumë gjersa po i tregonte. Të tjerat i pa pa shumë ceremoni.

Nuk foli shumë për gjyshen, iu kthye edhe njëherë fustanit. I tregoi për një njollë që i ishte bërë dhe nuk i hiqej. Duke e shpalosur e gjeti, ja kjo i tha.

-Mirë ka bërë që i ka ndarë vet, tha.

Nuk la hapësirë të bëhej pyetje.

-Se kështu nuk i mbeten askujt barrë, i tha ndërsa po mbyllte bohçen dhe dërgonte në dollap.

- Vdekja vjen. Nuk ke pse mendon për të.

E tha qetë, pa dramë.

Ajo e ndjeu se nuk kishte ç'të shtonte. Kur u ngrit për t'u larguar, gruaja ia mbajti pak dorën.

-Mos i mbaj shumë gjatë me vete, i tha.

....

Derën nuk e hapi askush.

.....

Mbeti edhe një bohçe. E mbajti me vete për disa ditë. Nuk nxitonte. Adresa ishte më larg.

Një mbrëmje, e vendosi mbi tavolinë. U ul përballë saj dhe qëndroi gjatë pa lëvizur.

I kujtohej se si dikur kishte veshur fshehurazi rrobat e gjyshes, si qëndronte para pasqyrës dhe përpiqej të gjente diçka të përbashkët.

Zgjati dorën. E hapi.

Brenda ishin disa nga ato rroba. Ato të kohës së nusërisë. I njohu menjëherë.

I mori një nga një. Pëlhura ishte më e hollë se sa e kujtonte. Më e brishtë.

U ngrit dhe shkoi te pasqyra, e veshi një fustan, nuk i rrinte si dikur, ose ndoshta ajo nuk ishte më e njëjta. Qëndroi për pak, duke parë veten. Nuk kërkoi më ngjashmëri. E hoqi me kujdes, e palosi dhe e vendosi përsëri në bohçe. E mbylli.

Në mëngjes, nuk shkoi te adresa.

Bohçen e la në katin e dytë, mbi shtrat, aty ku i kishte gjetur të tjerat.

Kur po zbriste shkallët, iu duk sikur shtëpia ishte më e qetë.

#RivetingReviews: Morelle Smith shkruan për romanin «SAGA E SARAJEVËS» të Stefan Çapalikut, përkthyer në anglisht nga Vlora Konushevci

Çapaliku të çon me mjeshtëri drejt një zgjidhjeje befasuese e të papritur

Nga Morelle Smith

Lekë Cukali, rrëfimtari i romanit «Saga e Sarajevës», është një shkrimtar që mbërrin në qytetin prej të cilit romani merr titullin, për të kaluar aty një muaj në një rezidencë letrare. Më vonë mësojmë se ka marrë pjesë edhe më parë në disa rezidenca të tilla, ndaj për të nuk është e pazakontë të kalojë një muaj në një vend të huaj për t'u përqendruar te të shkruarit. Por, thuajse menjëherë, kjo rezidencë i duket ndryshe. Një nga arsyet është se mbart me vete kujtime nga një album fotografish të vjetra, të cilin i ati e nxirrte dhe ia tregonte herë pas here. Një degë e familjes së të atit ishte larguar nga Shkodra, në Shqipëri, në fund të Luftës së Parë Botërore. Besohej se kishin shkuar në Bosnjë, por, me ardhjen e komunistëve në pushtet në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore, vendi ishte mbyllur pothuajse krejtësisht ndaj pjesës tjetër të botës dhe lidhjet me ta ishin ndërprerë.

Kujtimet e fotografive dhe të rrëfimeve të të atit i rikthehen Lekës teksa përpiqet të mësohet me mjedisin e ri. Por që në fillim ka gjëra në banesën e re që e acarojnë: ngrohja nuk punon, nuk ka ujë të ngrohtë, bën një të ftohtë të pazakontë për stinën, nuk ka një tavolinë të përshtatshme ku të punojë dhe as Wi-Fi, ndaj nuk mund të lidhet me Esmën, e cila ka për detyrë të merret me çdo problem që mund të dalë. Kur më në fund arrin të lidhet me të, duke shkuar në një kafene e duke përdorur Wi-Fi-n e saj, ajo përpiqet t'u japë zgjidhje ankesave të tij të shumta, por lë të kuptohet se ai po tregohet i paduruar e kërkues, ndërkohë që ajo po bën gjithçka mundet.

Përveç kohës që i duhet t'u kushtojë problemeve praktike, Leka e ka të vështirë t'i përmbahet edhe projektit letrar që kishte parashikuar dhe, çuditërisht, ndien se i kanë shteruar idetë. Nis ta përndjekë dëshira e të atit për të gjetur pasardhësit e të afërmve që ishin shpërngulur këtu, si edhe fotografitë e këtyre njerëzve. Historia e udhëtimit të tyre nga Shkodra në Sarajevë ia pushton gjithnjë e më shumë mendimet, sikur të jetë detyra e tij të zbulojë ç'u ka ndodhur.

Romani më pas ndahet në dy pjesë: e shkuara, në fund të Luftës së Parë Botërore, me historinë e udhëtimit të familjes nga Shqipëria në Bosnjë dhe të jetës së saj atje, dhe e tashmja, ku Leka interesohet gjithnjë e më shumë për të mësuar rreth këtyre të afërmve, gjurmët e të cilëve kanë humbur. Njëkohësisht, atij i duhet të merret me problemet praktike të banesës, me njerëzit e organizatës që supozohet ta ndihmojnë dhe me ata që takon në kafenetë e qytetit, të cilët nuk kanë dëgjuar për familjen e tij dhe nuk duken veçanërisht të interesuar për ta ndihmuar. Fillimisht, pyetjet që bën dhe marrëdhëniet e tij me të tjerët përshkohen nga njëfarë acarimi: duket se nuk arrin të krijojë lidhje as me njerëzit, as me vendin; ndihet i veçuar, sikur e mbajnë larg.

Në rrafshin tjetër kohor të romanit, të afërmit e Lekës ikin nga kaosi dhe rreziku në Shkodër, ndërsa ushtria austriake tërhiqet në fund të Luftës së Parë Botërore. Familja përbëhet nga nëna dhe katër fëmijët, pasi babai është vrarë në luftë. Edhe ky rrëfim është shkruar në vetën e parë, nga këndvështrimi i djalit më të vogël, Mikelit, i cili ishte rreth dhjetë vjeç kur u larguan nga Shqipëria. Pas vuajtjesh e rreziqesh, ata gjejnë strehë te një familje hebreje zemërmirë në Sarajevë, ku nëna punon si kuzhiniere dhe kujdeset për shtëpinë, ndërsa fëmijët rriten në kushte relativisht të mira e të sigurta – deri në trazirat e viteve 1930, kur një tjetër luftë mbërrin në Ballkan.

Dy historitë dhe dy rrafshet kohore gërshetohen. Në të tashmen, Leka nis të ndiejë se e shkuara i kalon fare pranë, nëpër kafene, në qëndrimet e fqinjëve, madje edhe në vetë banesën e tij. Arrin të gjejë disa gjurmë të të afërmve, por ende mbeten nyje që nuk mund t'i zgjidhë. Në zemër të misterit, ai përballet me çështjen e identitetit: çfarë është e ç'kuptim ka, sa lidhet me gjeografinë e vendin, sa me kohën dhe sa mund të përftohet duke zbuluar të fshehtat e së shkuarës.

Ka gjetje të bukura që e bëjnë të prekshme ndjenjën e tëhuajësimit që përjeton Leka. Mungesa e interesit të Esmës për problemet e tij e acaron gjithnjë e më shumë. Ai humbet vazhdimisht rrugën në labirintin e rrugicave të qendrës së qytetit. Personazhe «të zakonshme» rezultojnë të kenë një domethënie që ai e ndien, por nuk arrin ta rrokë plotësisht: pronari i një kafeneje sillet në mënyrë të dyshimtë, thuajse armiqësore; fqinji, i cili në fillim sillet miqësisht, madje shpreh admirim për të, më pas i lë shënime të koduara që e trazojnë. Leka nuk është i sigurt se kujt mund t'i besojë, nëse mund t'i besojë ndokujt.

Kjo është një histori vërtet rrëmbyese dhe emocionuese. Stefan Çapaliku është mjeshtër në krijimin e atmosferës, në shpërndarjen e hollësive të vogla dhe në mbjelljen e dyshimeve që, si një gur në këpucë, fillimisht shkaktojnë njëfarë bezdie, por më pas rriten në mendjen e rrëfimtarit, derisa nuk je më i sigurt nëse frikat dhe paranoja e tij janë të tepruara apo plotësisht të përligjura. Dhe, pasi të ka prirë nëpër labirintin e qytetit dhe të personazheve të tij, të vdekur e të gjallë, Stefan Çapaliku të çon me mjeshtëri drejt një zgjidhjeje befasuese e të papritur.

BEHAR JACAJ

Pas shembjes!

poezi

KTHIMI NË EDEN

U shkallmuan dyert nga trokitjet e
munguara.
Çatia shpellon nga ngrohtësia e flakur.
Puhiza e mbrëmjes, si ethe fantazmash,
valvit shaminë e lamtumirës
në gjethe manaferrash.
Qilim glasash ka shtruar dallëndyshet
në lavrën ku hodhëm hapat dhe ëndrrat e
para.
Myku, si pështymë verëmliu
ka triumfuar mbi maninë e dikurshme të
nënës
për të zbardhur muret me gelqele.
Nuk paska mbrojtur as veten
patkoi që do t'na mbronte nga e keqja.
I mundur kalbet nën peshën e ndryshkut.
Këtu, prej shekujsh asgjë nuk ndodhë.
Si duket asgjë nuk të grryen më keq se
asgjëja.
Cifla kujtimesh më ushtojnë në vesh si
zëra
që duan t'më bindin se në Eden
mund të shkelësh vetëm si fëmijë.
Ose si engjëll.
Koha arrixheshë,
mbledh rrangullat që solli vetë,
dhe ikën.
Harrimi ka dorën e lehtë.
Të rënda veç jargët e nostalgjisë
Dhe ingranazhet që na cysin përpara,
larg Edenit që shkelëm kur ishim fëmijë.
Larg parajsës që shkelëm kur ishim engjuj!

VONESA

Ti,
lotin më të madh se syrin.
lëmshin më të madh se lukthin,
ëndrrat më të mëdha se frymën.
dashurinë më të madhe se shtatin.
Unë,
mallin më të fortë se shpatullat,
trishtimin më të hekurt se gjunjët,
dalldinë më të madhe se shqisat,
mëkatin më të rëndë se lutjet,
Ti,
vishkull që lulëzon nën diellin gënjeshtar
të nëntorit.
Unë,
vjeshtë që nuk t'i mbush dot degët me
fruta!

iriq me gjemba kthyer kah vetja!

Mollat e pangrëna më shpallin mëkatar.
Nepërka e ankthit bishtin tund kobshëm.
Edeni i gjallimit një xhungël e marrë,
Ferrat rritën vrullshëm, lulet çelin
zorshëm.

Kotësia fluron nën mermerin e lëkurës
përgjunjem para Absurdit, t'vetmes
Përendi
Më nyjëzohen gjymtyrët në mes të udhës
Nuk bëj para, as prapa. As ndalur s'rri.

Iriq me gjemba kthyer kah vetja.
Ditët dhe ëndrrat më thyhen vazhdar.
Në lumin ku shkasin jeta dhe vdekja
Mollat e pangrëna më shpallin mëkatar!

SHALUAR!

Përtyp frerët që i kanë vënë në gojë.
Ia heqin veç kur ha bar.
Kapistra e qepur pas koke,
e sajuar me rripa,
zbukuruar me tufla, xhingla e zilka,
ia gardhon shikimin.
Që t'mos tërhuzet prej tundimit,
ia kanë cunguar shikimin.
Shikon veç përpara.
Që të meritojë një grusht krunde,
â, që t'i ikë kamzhikut,
nënshtrohet pa naze.
I bindet edhe fishkëllimës.
Gjithë ditën e lume
mes turfullimash.
mes djersësh dhe mizash,
tërheq karrocën, â plugun.
Gurin e Sizifit.
Natën, në grazhd, tek përtyp tagjinë,
kashtë dhe shpresa të thara,
lutet që pranvera,
kurdo që të vijë, (në ardhtë ndopak)
t'ia njomë ëndrrën për t'u bërë pegasus!

Pas shembjes!

Të shkosh fillikat në rrugë.
Të strukesh brenda palltos,
Si butak që mrrolet brenda zhguallit.
Mes njerëzve, të mos i flasësh askujt.
Mbi qepalla të ndiesh peshën e reve,
(atyre të errtave që mbjellin stuhinë).
Saharanë të ndjesh në buzë,
dhe në damarë gjakun e ngrirë.
Të mendosh se në thelb s'ndodh asgjë.
Koha boshtin ngulur në dhimbje.
Bota top ping-pongu hedhur në terr.
Gjallimi ngjitur shket si hije.
As nuk ikën, as nuk vjen.
Horizonti gri deri në palcë.
Zoti nuk i mban dot lotët.
Kushedi sa mërzitet.
I vetëm dhe I përjetshëm.
Punë e Tij.
Të ulesh në bar.
Të porositësh zehër në fixhan të bardhë.
Të ndezësh një cigare.
Të përgjosh shiun që sapo nisi kujen.
Po shëmbet qielli, -thotë dikush ngjitur.
Fjala '*shembje*' të kujton perandoritë.
Dhe dashurinë.
Perandoritë e mëdha janë si dashuritë e
mëdha,
Shemben veç nga pesha e tyre.
Pas shembjes,
me shekuj, kërkohen dhe vajtohen reliket
e humbura!

GUACKA!
Dallgë malli shkapeten mbi ty.
Të shembin.
Ti bie shakull.Mblidhesh fetus.
Guackë që përpin trazimin e detrave,
kujën e shekujve.
Kështu qendron një grimëherë
(një shekull).
Pastaj ngrihesh, i gjithi zguall.
Sajon një biçim buzëqeshje,
Më saktë, një të zgërdhirë
Hiqesh se nuk ndien.
Se nuk ndjeve kurrë
Je guacka e brishte që do të dukesh gurë!

DRU PËR ZJARR.

Mblidhja dru për zjarr
se ditët qenë të trishta.
Bryma frymën ma kthente në mjegull.
Balta zamohej në çizmet e grisura.
Trucmacë, njolla të përhime, më vinin
pranë,
për shoqëri, a për ndonjë thërrime.
I prisja me gurë,
Me llastik i vrisja
Dhe shokëve u mburresha për trimëri.
Mblidhja dru për zjarr.
Thellimi strukej n'fole të braktisura.
Era sajonte ninullë fantazmash.
Oxhakët vidhnin shamatën e mbledhur
gjatë natës
Të shkelmoja samarin pa breshkë
dehesha me endrra idilike,
për të ardhmen që më priste,
ose më saktë, e prisja.
Dimri u mardhej pemëve në gishta.
Misri, mbetur n'arë, nderte shami të
ndtyra.
Mblidhja dru për zjarr.
Shpandkoja gardhe, portare prishja.
Digjesha nga e ardhmja idilike,
që më priste, ose më saktë, prisja.
Tash nuk kërkoj më dru për zjarr.
Trumcakët janë tërhuzur.
S'ka më brymë, as baltë.
Ditët janë si janë,
barishte pa pranverë
rrathë pa prehje në një pellg ujë.
Tek prisnim të ardhmen që s'erdh
asnjëherë.
Na mbështolli e ardhmja që se pritëm kurr.

STINA E ZEHERIT

S'e tërheqim dot fillin e këputur,
as mërgatën e shpendëve s'mund ta
ndalim,
ndaj le të biem në gjum letargjik.
Kur shiu, breshëri dhe bora të vijnë
le të shikojmë ëndrra të Blerta.
Pas dekadash të zgjohemi si zvarranikë,
të pështirë, të rrudhur, të akullt.
Të plakur.
Shkoi si shkoi, më mirë që shkoi
dhe zeheri i mbetur ka për të shkuar,
Gjithçka do të avullojë.
Hiri do t'i mbysë thëngjijtë e pashuar.
Shkoi si shkoi, në djall le të shkojë.
Nuk çojnë heler ca ëndrra më pak,
as ca dhimbje më shumë.
Është çmenduri
të zhytesh me gur lidhur pas qafe,
këmbëzbathur të futesh në xhungël,
të digjesh në një flakë kashte.
Shkoi si shkoi, në djall le të shkojë.
E kam të qartë se çfarë më pret;
do jem ca kohë as në tokë, as në tra,
do filloj të flas përçart,
broçkullat do t'i shes si poezi.
tek-tuk ndonjë lot do më shkasë,
tek-tuk ndonjë qetësues do e pi,
Pastaj retë do të davariten,
stuhia do të kalojë
e do marrë me vete imazhin tënd.
Kështu do harrosh ti.
Kështu do të harrohem edhe unë.
Sepse nga të gjitha speciet,
koha, dështakët urren më shumë!

***
Kërkoj në qiell të gjej një çengel
Ku të var lëkurën time të qullur
nga lotët e paderdhur.
Kockat e mia le të bëhen ashkla
për fole skifterësh.
Frymën ua fal djerrinave,
le ta bëjnë fllad për grurin e pa mbjellur.
Nga çdo gjë heq dorë me dëshirë,
Kam blerë përjetësinë me monedhën e
harrimit.

KLEVISA BARDELI

“/5/2025”

tregim

Nata s’kishte râ e nën hijen e kâmbëve të lodhuna endeshin imazhe të ditëve të mungueme. Në duert e kryqzueme që mbanin peshën e mendimeve, Gega, mbante fort të shtrëngueme atë letër. “*Ka kalue koha e letrave!*” - tha ndër dhâmbë Gega. “*E kush shkruen ma letra. ?!*” Hidhte nji

hap e sikur shtrohej në mendime tue ia nxjerrë vedit ato pak gjâna që ia mbante kujtesa. “*Me më pasë ndigjue mue kishte ardhë vetë, po he! Mirë kjo po unë çka due me këtë letër?*”

“ A po ma çon két’ letër te ajo? Po vetëm me dorë. Mos e dërgo me postë, mos i ço foto, asnji screenshot. Due me e ditë që fjalët i mbërrijnë ashtu siç i kam shkrue”, - i pati thanë.

Gega i dyshuem në mendime gati desh u kthye mbrapsht, po i kishte dhanë fjalën se kishte me ia dorëzue në dorë. Vazhdoi rrugën, që sa vinte e bâhej gjithnji e mâ e lodhshme. Lodhja e tij sikur e kaplonte mâ shumë në mendime. U kujtue se pas dy orësh kishte lânë takimin me disa miq të tij në qendër të Shkodrës. Kishte tre javë pa ardhë. Zhvendosja në Tiranë për mâ mirë ia kishte vjedh nji pjesë të mirë të qetësisë shkodrane. Po siç thoshte Gega vetmevedi “*Ndryshe nuk jetohet në këtë vend!*”. Ajo çka e brente Gegen, ishte se nuk e kuptonte nga i kishte burue tânë ai besim atij njeriu, për me ia dhânë atë letër. Nji shkodrani të panjoftun. “*Pse a thue s’ka qëllue asnji shkodran këto ditë në Tiranë? A thue se nuk ekziston mundësia në këtë shekull me gjetë nji numër telefoni, po fill e tek, si në kohna të harrueme, me letra!*”

Qielli sa vinte e errësohej e Gega ecte tue fol me vedi. Pak njerëz kishin mbetë rrugëve, përveç atyne që mund të kishin planifikue ndonji takim, sikurse Gega.

“*Po qe do! Ndera* âsht *nderë*!” - pështpëriti Gega.

Tek nata kishte mbulue me tisin e saj pothuajse qytetin, Gega kur u gjend mes atyne rrugicave të ngushta filloi me u tundue dhe u mat me e hap atë letër që gati i ishte ujtisë sa në njânen dorë në tjetrën.

“Po sikur ta hapi njiherë, çka po më gjenë?! -tha me vedi. Tânë kjo rrugë Tiranë - Shkodër, pa ia hedh nji sy! Mos ndoshta ka qëllue që ai burrë i ka harrue tashma rrugët e Shkodrës? Mos ndoshta âsht i vetëm e s’ka njeri në Shkodër? Mos ndoshta s’ka telefon e nuk ka informacion mbi teknologjitë e fundit? Po mirë, po ai ku e di çka don me thânë screenshot!? A thue mos âsht maniak e me probleme mendore? Në 2025-n na u dërgoken letra! Çfarë mundet me qenë e shkrueme aty që s’mundet me u thânë në rrugë të zakonshme komunikimi? Në kohën e ekranit, dikush na paska zgjedhë me fol me bojë. Me laps. Me dorë. Mos ndoshta disa fjalë nuk i besohen sot teknologjisë, por vetëm njeriut? Ndoshta fjalët janë aq të rânda, sa duhen me u mbajtë prej dikujt, jo me u dërgue? Po sikur me qenë nji provë? Nji rreng? Nji rrëfim që don me u dëgjue prej kujtdo ? Mos ndoshta unë duhet me e lexue? A mundet nji letër me ndryshue diçka? A mundet me ndezë prapë diçka që ka vdekë? Mos ndoshta âsht nji “Nâdja e mirë!” apo “Mbrâmja e mirë!” e vonueme… nga nji kohë që s’ka mâ vend. Mos ndoshta, ky lexim kërkon jo sy… por zemër?”

Zhurma e hapave që i erdhi nga pas, ndaloi pytjet shtizë që bienin pingul mbi mendjen e Gegës. Ai ktheu kryet, por nuk u duk asgjâ. Në skutin e rrugicave të qytetit ndodhej shtëpia që dukej sikur nuk nxirrte asnji zâ mes natës së errët. Kur mori t’i biente derës ju kujtue dhe njiherë ai burrë në moshë. Kishte kohë që priste mes qytetit të Tiranës me takue nji shkodran që t’ia jepte atë letër.

- A bân me pvetë *diçka*?

-Po *mundeni*.

-A je tue u nis për *Shkodër*?

Gega e ngushtoi vedin sa desh me iu kthye me tânë energjinë e tij rinore me këto fjalë “*Po ku po e ditke se jam shkodran, mor zotni!?*” Po u tërhoq tue ditë se këto nuk janë brenda normave të komunikimit.

-Për Shkodër jam. Për çka kishe nevojë *zotëni*?

A po ma çon két’ letër te ajo? Po vetëm me dorë. Mos e dërgo me postë, mos i ço foto, asnji screenshot. Due me e ditë që fjalët i mbërrijnë ashtu siç i kam shkrue.

Kush asht ajo?

Aty Gega vuni re se i kishte râ ziles, edhe pse gjysmë i vetëdijesuem. I hodhi nji sy letrës mos kishte ngatërrue rrugicë, por jo, ishte po ajo siç ishte e shkrueme në nji çoshk të saj. Nuk vonoi e dikush po afrohej te dera. E hapi derën. Ishte nji grue. Ajo çka të biente në sy edhe pse në moshë ishte e qeshuna e saj. Gega ishte i pështjelluem në mendime se u gjend mes natës në shtëpinë e nji grueje shkodrane, pa e njoftë e pa e ditë. Kishte kohë që ishte shkëpuet nga Shkodra, por edhe kur kishte ndenjë gjatë, nuk ishte marrë shumë me njerëzit rreth e rrotull përveçse me disa miq të ngushtë. E me këtë rast ai kishte dalë nga strofulla e tij.

-Mirëmbrama *zonjë!*

-Mirëmbrama!

Ju kërkoj ndjesë se u gjenda si papritun në këtë orë në shtëpinë tuej, por kur po nisesha për në Shkodër nji burrë më dha këtë letër, me e dërgue në këtë rrugicë. Nuk më përmendi emër. Por tha me ia dhanë në dorë asaj...

Gegen e ngushtuen prapë mendimet e hershme mbi letrën. “Çka mundet me pasë brenda kjo letër, e unë vi ia jap kësaj grueje, pa qenë i vetëdijesuem. Si nuk e hapa! Si nuk e hapa! Po *sikur...!?*”

Unë jam vetëm në shpi, fëmit i kam në emigrim. A mâ kishe bâ nji nderë?

Gegës ju kujtuen fjalët e atij burrit. *“Çna paska qenë dita e nderave more Gegë”,* - tha me vete me ironi.

-Po zonjë, si mundem me ju *ndihmu*?

A po mâ lexon se nuk shoh mirë, edhe nata ka râ... Hajde këtu në dritë, afroju në verandë.

Gega u bâ gjak në fytyrë. Kujtoi përpjekjet me e hap atë letër. Po sikur ta kishte hap mâ përpara? Çka kishte ndodh? Po sikur ta kishte hap mu në sy të atij burri e mos të kishte pranue me bartë me vedi letra të panjoftuna? Pesha e hapjes në këto çaste rândonte mâ shumë se lodhja e rrugës.

Kur po afrohej në verandë, Gegës, i tërhoqi synin oborri. Lulet shumëngjyrëshe kishin shpërthye e lëshonin aroma që rrallëherë mund t’i kishte pâ Gega. Ishte fillim pranvere. Në shtëpinë ku rrinte në Shkodër nuk kishte ashtu lulesh. Në Tiranë as nuk bâhej fjalë. Ky oborr i vogël e bânte Gegen me fantazue. Fantazia nuk kishte qenë kurrë pjesë e Gegës. Qysh në kohën e gjimnazit kur mësuesja e letërsisë i detyronte në nji farë mënyre me shkrue ese letrare. Tashma Gega ishte rritë, kishte shkue me studiue në Tiranë për ekonomi. Bota e ekonomisë sido kudo nuk ia lejonte nji gjâ të tillë. Aroma e trândofiles i ngacmonte kujtesën e vegjëlisë, kur ngânin me fëmijët e lagjes, tue i këputë tinxisht ato lule me ia dhurue nânës në mbrâmje, në kthimet e vona nga loja. Por trândofilja çilte çdoherë gonxhe, edhe pse shumë duer ia këputshin ato në kalim. *A mos ndoshta, ishin lulet e kësaj grueje!?* - tha vetmevedi çuditshëm Gega.

-Hajde ulu, se ndoshta je i lodhun prej rruge, - i tha grueja.

-Falemnderës, por mos u mundo, - ia ktheu Gega.

Qe, hape, pa merak, se po të ndigjoj... - i tha grueja, që siç duket e pa sikletin e Gegës që tashma po i rridhte së bashku me djersët e rrugës.

Gega u përqëndrue dhe nisi me e hap me delikatesë letrën. Grueja përballë i kishte sytë si ujë i ngrime, në heshtje.

*** *.... /5/2025*

S’e di nëse kjo letër ka me të gjetë ende tue pritë, tue harrue ose të harruem. Zgjodha me u dukë qesharak me letër. Shpejtësia e mesazhit me telefon nuk e kishte ruejtë pastërtinë e fjalës teme. E ndoshta zâni jot që mund të ketë ndryshue, pas kaq shumë vitesh, kishte me ma rrëzu imazhin e ruejtun në krye. Kam dashtë me ardhë vetë, po jam betue që nuk kthehem mâ kurrë në Shkodër, qysh atëherë kur mâ s’u pamë. Kur fjala tu tjerrka në fyt, letra u bâka e vetmja rrugë që nuk të friksoka mâ. Ti m’ke mësue me heshtë për mos me lëndue, e unë heshta aq gjatë, sa fillova me u bâ nji njeri tjetër, nji hije që s’e njihte mâ as vedin. Por emni yt… ai s’ka heshtë kurrë brenda meje. Ka trokitë netëve, ka ujtë kujtesën teme si shi i hollë që s’ndalet. E tash, kur ndiej se pak gjâna janë mâ të vërteta se pendesa, po ta çoj këtë copë zemër me shkrim, se goja m’ asht lidhë. Më fal se kur u desht me të mbajtë, u bâna nji largim që nuk din me u shpjegue. Po due me e dorëzue këtë letër në duert e dikujt tjetër, se nuk guxova me e mbajtë mâ gjatë. Isha betue që kam me e dorëzue në duert e nji të riu shkodran, se, edhe po e hapi këtë letër mendoj se ka me më kuptue mâ së miri. Kam me e dorëzue tek ato sy që më kujtojnë sytë e mi. S’due me e marrë në vorr, bashkë me fjalët që ti meritove me i dëgjue me kohë. Nëse kjo letër ka me të prek sado pak zemrën… mjafton për mue. Unë s’kërkoj kthim, veç me e ditë se nuk jam harrue krejt. E se fjala, kur vjen me vonesë, nuk âsht për me ndryshue gjithçka – po për me shërue pak nga ato që nuk u thânë kurrë.

***

Ai e mbylli letrën. Grueja nuk foli. Por sytë i ishin lagë pa zâ, si me qenë fjalë, që i kishte pritë nji jetë, pa e ditë se po i mungonin. Në ajër mbeti nji heshtje që nuk kishte mâ nevojë për asgja tjetër. Gega u çue në kâmbë, pa orën. Kishte shkue aq vonë, saqë miqtë e tij duhet të kishin shkue nëpër shtëpitë e tyne. Këputi nji trândofil në oborr të grues, si dikur fëmi, pa kërkue leje dhe pa u trembë. Ku me e ditë për ke tash Gega e kishte atë lule?

SHËNIM I AUTORES

Ersi Sotiropoulos

ÇFARË MBETET NGA NATA

Përktheu nga origjinali:
Maklena F. Nika

Kur në vitin 2015 u botua romani im *Çfarë mbetet nga nata*, për tri ditët e Konstandinos Kavafisit në Paris, në qershor të vitit 1897, shumëkush më pyeste se çfarë ishte e vërtetë dhe çfarë e sajuar në këtë libër. Më pyesnin gjithashtu përse kisha zgjedhur këtë udhëtim në Paris në vitin 1897 dhe jo udhëtime të tjera të tij, për të cilat ekziston më shumë material, madje edhe poezi, si udhëtimi në Konstandinopojë (1882-1885) ose vizita e tij e parë në Athinë, në vitin 1901?

Udhëtimi në Paris më interesonte pikërisht sepse nuk kishte material, ose më saktë sepse ajo që ekzistonte ishte e mangët dhe e parëndësishme. Dukej sikur kishte mbetur një zbrazëti, diçka e paqartë dhe pezull, që i bënte thirrje letërsisë ta mbushte. Kjo zbrazëti ishte Kavafisi i ri. Kavafisi, poeti i paplotë dhe i panjohur, që përpiqet ta përcaktojë veten poetikisht.

Imazhi mbizotërues që kemi për të është ai i një poeti në pjekurinë e tij, një figurë e plakur, aforistike, e distancuar, sikur të mos kishte njohur kurrë moshë të re. Kur shkon në Paris në vitin 1897, është vetëm tridhjetë e katër vjeç. Deri atëherë, me disa përjashtime të vogla, kishte shkruar poezi më tepër të ngathëta, të pagdhendura, siç i quan ai, dhe kishte bërë disa botime në revista të vogla letrare. Ajo që më interesonte ishte kalimi nga poeti i ri te poeti i pjekur, si ishte bërë artist, se si, më në fund, Kavafisi u bë Kavafis dhe nëpër çfarë procese kaloi.

Në përgjithësi, në librat e mi nuk vendos kurrë të shkruaj për një temë, shkrimi vendos për mua. Është ngulmimi i një imazhi, ende i mjegullt, ose i një bisede kalimtare që rikthehet - si atëherë kur kemi përshtypjen se nuk e dëgjuam mirë diçka, e megjithatë ajo është regjistruar brenda nesh. Edhe kur jam e detyruar të shkruaj për diçka të caktuar, qoftë për një bashkëpunim, qoftë për një porosi për të shkruar një vepër, stigma do të jepet në njëfarë mënyre jashtë temës, ajo do t'i japë nuancën, një shije të veçantë që do të përshkojë tekstin, dhe ky proces më pëlqen, sepse kështu edhe unë zbuloj diçka ndërsa shkruaj. Për *Çfarë mbetet nga nata* u nisa nga pyetje.

Ideja për librin lindi shumë vite më parë, në vitin 1984, kur organizova, në emër të Ambasadës Greke në Romë, një ekspozitë të madhe kushtuar Kavafisit, së bashku me disa veprimtari paralele në *Palazzo Venezia*. Kisha qasje në Arkivin Savidhi, sot *Onassis Cavafy Archive*, dhe në Arkivën Greke Letrare dhe Historike; kisha studiuar gjithçka hollësisht, duke përzgjedhur materialin për ekspozitën. Atëherë konstatova se për udhëtimin e tij me të vëllanë, Xhonin, në Paris dhe Londër, në maj-qershor të vitit 1897, nuk kishte asgjë, përveç disa kujtimeve: programit të *Comédie Française*, disa numrave të revistës *L'Illustration*, kuponit të një këmisharie etj., kujtime që, me sa duket, dy vëllezërit i kishin ruajtur për t'ua treguar në Aleksandri nënës dhe të njohurve. Në arkivin e poetit nuk kishte asnjë shënim personal, asnjë referencë për udhëtimin.

Viti 1897 ishte një periudhë e jashtëzakonshme për Parisin. Qyteti rrezatonte në kulmin e *Belle Époque*. Aty rrihte pulsi i avangardës në art. Artistë nga e gjithë bota dyndeshin në Montmartre, ku lindnin rryma të reja poetike. Ishte Parisi i Marcel Proust-it, Edgar Degas-së, Toulouse-Lautrec-ut, Émile Zola-së dhe i aq shumë të tjerëve. Më bëri përshtypje se si Kavafisi nuk iu rikthye kësaj përvoje, se si nuk shkroi as edhe gjysmë rreshti për përshtypjet e tij nga Parisi i asaj kohe. Disa vjet më vonë, do të vizitonte për herë të parë Greqinë, por nuk udhëtoi më kurrë në një kryeqytet të madh europian. Më lindën pyetje të ndryshme. Më intrigoi kontakti, ose më saktë përballja e heshtur e Kavafisit, i cili vinte nga një Aleksandri kozmopolite, por e prapambetur dhe e vjetruar, me këtë botë të shkëlqyer, të rafinuar, në një qytet ku ndodhte gjithçka e rëndësishme që dikush mund të dëshironte të dinte për artin.

Disa vite pas ekspozitës në Romë, shkrova skenarin e një dokumentari kushtuar Kavafisit për serinë e televizionit francez "Një shekull shkrimtarësh". Sërish u zhyta në arkiva, sërish dolën në sipërfaqe të njëjtat pyetje. Kjo mungesë informacioni, kjo zbrazëti, më dha shtysën të filloja të mendoja për romanin. Zakonisht njeriu merr shkas nga ndonjë hollësi tronditëse dhe pastaj fillon të gërmojë. Këtu nuk kishte asgjë. Zbrazëti.

Kavafisi është poet i pjekurisë së ngadaltë. Deri në vitin e udhëtimit, përveç fare pak poezive që arrira, kishte shkruar poezi me cilësi mesatare apo jo të mirë. Përpiqej të imitonte poetët e mëdhenj të kohës, pa asnjë sukses. Por ishte këmbëngulës, i tërbuar nga këmbëngulja. Dhe pastaj, në një pikë të caktuar, ndodh një shndërrim i vrullshëm cilësor, sikur brenda një dhjetëvjeçari të bëjë një kërcim të jashtëzakonshëm. Kjo më ka intriguar gjithmonë. Si, pra, *Qyteti* nga një vepër e papërpunuar, e pasuksesshme, fillestare, bëhet ajo që njohim sot, një poezi estetikisht dhe krejtësisht e ekuilibruar.

Ajo që të magjeps, që besoj se na magjeps të gjithëve, është se si një artist, një poet në këtë rast, relativisht mesatar, pa një talent shpërthyes e të lindur, si për shembull Rimbaud, një tip disi i ndrojtur, i ngathët, i shtypur në jetën e tij personale, i torturuar nga kontradikta dhe dyshime të brendshme, siç ishte Kavafisi atëherë, në moshën tridhjetë e katërvjeçare, si arrin ta bëjë këtë kërcim? Si bëhet Kavafisi që njohim sot? Sikur papritur të ringjallet, të dallohet nga të tjerët dhe të hapë rrugën e vet në Art, një rrugë unike dhe të papërsëritshme - të kalojë përpara kohës së tij, duke përshkuar kohën - dhe këtu ndodh diçka interesante, sepse Kavafisi shkruan për të shkuarën, por na flet për të sotmen; këndvështrimi i tij, pika e zhdukjes së vargjeve të tij, mund të përqafojë të shkuarën dhe të ardhmen - dhe kjo është e vërtetë, sepse ai vazhdon të jetë më aktual se kurrë.

Besoj se kërcime të tilla cilësore nuk ndodhin rastësisht, nuk bien nga qielli. Përkundrazi, pas tyre fshihen shumë dështime, lodhje, shumë përpjekje shterpe, dëshpërim. Për shembull, *Qyteti* shfaqet në një variant të parë, me datën gusht 1894, ndërsa versioni përfundimtar është i vitit 1910. Gjashtëmbëdhjetë vjet për një poezi.

Kështu, kur fillova të shkruaja romanin, pothuajse 25 vjet pas ekspozitës në Romë dhe pyetjeve të para që më lindën në atë kohë, doja që dikush që do ta lexonte librin të mund të shihte se ajo që nga jashtë ngjan si një kërcim magjik, është një rrugëtim i dhimbshëm që kërkon sakrifica dhe merr shumë kohë, kohë të zymtë. U përpoqa që lexuesi im të hynte brenda aventurës së shkrimit dhe ta përjetonte atë pothuajse fizikisht.

Sfida për mua ishte të kapja zërin e Kavafisit të asaj kohe. Të flisja me zërin e atij të riu të panjohur, të pasigurt, por të pasionuar dhe ambicioz, i cili do të bëhej një poet i madh. Ishte hera e parë që shkruaja për dikë që kishte ekzistuar dhe që, për më tepër, ishte kaq i njohur. Në të njëjtën kohë, nuk më interesonte aspak të shkruaja një biografi të trilluar apo një roman historik.

Fillova të mendoja për këtë të ri, fatin dhe të ardhmen e të cilit i njohim të gjithë shumë mirë, për udhëtimin e tij në Paris në një epokë të veçantë, për pasionin e tij për të shkruar, ankthin për të gjetur zërin e tij, për mënyrën se si torturohej nga dëshira erotike, të ndaluara në atë kohë. Fillova ta shihja në këtë udhëkryq unik, me Aleksandrinë në sfond, më tej Greqinë e falimentuar, të poshtëruar edhe një herë pas një lufte tridhjetëditore, dhe më në fund Parisin, të ndriçuar nga dritat, në kulmin e shkëlqimit të tij intelektual, dhe dalëngadalë Kavafisi u bë personazh romanesk. Udhëtimi në Paris ishte një udhëtim kënaqësie dhe njëkohësisht një rrugëtim inicimi.

Filloi procesi i dokumentimit, i cili ishte si një pus pa fund - një dokument të çonte te tjetri. Studiova arkivin e Kavafisit, natyrisht, materialin arkivor nga Arkiva Greke Letrare dhe Historike, dhe më pas një bibliografi të gjerë, jo vetëm për Aleksandrinë dhe jetën e komunitetit grek atje, por edhe për Parisin, rrymat artistike të kohës, jetën e përditshme dhe fermentimet politike, Çështjen Dreyfus që kishte tronditur atëherë opinionin publik, si edhe atë që po ndodhte në Greqi në të njëjtën periudhë, për luftën greko-turke tridhjetëditore, Lojërat Olimpike të vitit të mëparshëm, 1896, për sistemin politik në Egjipt etj. Kërkimi arkivor nuk kishte fund, por dua të theksoj se, megjithëse shterues dhe kërkonte shumë kohë, nuk ishte ai që i dha vulën librit. I gjithë ky material shërbeu më tepër si bazë nisjeje. Bërthama e vërtetë e romanit u shfaq më pas, ndërsa shkruaja.

Gjatë punës paraprake për romanin arrita në dy përfun-dime, secili prej të cilëve lidhet me rëndësinë e vitit 1897 për zhvillimin artistik, por edhe personal të Kavafisit. I pari ka të bëjë me poetin: vetëm pas kësaj date Kavafisi bëhet poeti që njohim dhe admirojmë. Ai braktis lirizmin, çlirohet nga ndikimi i Hugo-së dhe Baudelaire-it, i largohet traditës poetike të fanariotizmit, e cila e kishte ushqyer deri atëherë, dhe zhvillon zërin e vet të dallueshëm, me të cilin kuptime komplekse mund të shprehen në një formë të thjeshtë, të pastër. Përfundimi i dytë lidhet me jetën e tij private.

ERSI SOTIROPOULOS



Përktheu: Maklena F. Nika Onufri

Në vitin 1897 Kavafisi e ka pranuar homoseksualitetin e tij, ndonëse në jetën shoqërore ishte një njeri formal, mjaft i mbyllur dhe konservator. Megjithatë, sado i dyzuar dhe i fshehtë të ishte si individ, po i afrohej pikës ku, si poet, do të ishte i aftë të shkruante për këtë dëshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa kërkuar falje, duke bashkuar pasionin e tij për të shkuarën, veçanërisht për periudhën helenistike, me pasionin e tij për burra të tjerë, në poezi që do t'u përgjigjeshin kritereve të tij të larta.

Përtej homoseksualitetit, elementi përcaktues në rastin e Kavafisit është ankthi i vazhdueshëm, obsesiv, për rezultatin estetik. Sepse çështja në art është se si e përfaqëson dëshirën, cilado qoftë ajo, si të tejkalon ajo dhe shndërrohet në diçka tjetër që mund t'i prekë thellë lexuesit që nuk kanë asnjë lidhje me të, të cilët nuk ndajnë aspak të njëjtën dëshirë. Kjo është ajo që dallon një poezi mesatare nga një kryevepër. Dëshira erotike bëhet te Kavafisi forcë shtytëse. Pra, Kavafisi në çastin e tij kulminant të vitit 1897, është njëkohësisht shkaku për të ndjekur marrëdhënien e dëshirës erotike me shprehjen artistike, përpunimin e një dëshire të fuqishme që nuk gjen rrugëdalje dhe një proces të brendshëm që çon në pjekurinë poetike. Lexuesi e ndjek në mjedisin kozmopolit, të zhurmshëm e plot jetë të Parisit, në një rrugëtim ku vështrimi dhe mendja e tij kthehen me këmbëngulje te këto të dyja: te dashuria dhe poetika.

Te *Çfarë mbetet nga nata*, rrëfimi është në vetën e tretë, por libri ruan gjithmonë një këndvështrim të brendshëm, sikur të ishte shkruar në vetën e parë. Është këndvështrimi i Kavafisit. Rrëfimtari është ai, Kavafisi, heroi romanesk. Desha ta ndiqja poetin si një hije e ngjitur pas tij, të bëhesha hija e tij dhe, bashkë me mua, ta ndiqte i ngjitur pas tij edhe lexuesi. Njëra hije e ngjitur pas tjetrës. Njëri soditës i tjetrit.

Dashuria dhe poetika. Te Kavafisi, stimuli më i vogël, aluzioni më i vogël erotik, shndërrohet në motiv për të shkruar, në frymë krijuese. Arka ku përfundon Konstandinosi i ri drejt fundit të romanit është pasqyrimi i hapësirës së frymëzimit, me materiale të përziera, disa të dukshme, të tjera të fshehura më pas, të rëndësishme, por edhe të parëndësishme, madje banale, qesharake, të pavlera. Është

nënshtresa e asaj që është jetuar dhe e asaj që është lexuar - sepse frymëzohemi edhe nga ato që kemi lexuar; në letërsi nuk ekziston partenogjeneza.

Sa i përket epokës, sfondit historik, hotelit ku qëndruan dy vëllezërit, datave të udhëtimit të tyre etj., nuk ka asgjë të sajuar. Të gjitha elementet faktike janë dokumentuar. Pjesa tjetër është trillim. Në fjalën e tij, në një veprimtari për prezantimin e librit, studiuesi i Kavafisit, Dimitris Daskalopoulos, tha se "shumëherë Kavafisi ishte alibi për Ersi Sotiropoulos". Më pëlqeu kjo alibi. Sepse, në mënyrë të tërthortë, ajo nënvizon lirinë e artit. Më kujtoi diçka që kishte thënë Brehti: se "Një vepër që nuk dëshmon pavarësi ndaj realitetit dhe që nuk i jep publikut pavarësi ndaj realitetit, nuk është vepër arti".

M'u deshën gjashtë vite të shkruaja librin. Ndërsa e shkruaja, kisha një fill Ariane, të cilin ma dha vetë Kavafisi. Ishin disa vargje nga poezia e tij "Gjysmë ore":

Nganjëherë, ne, shërbëtorët e Artit
me vrullin dhe forcën e mendjes
vetëm për pak, sigurisht
krijojmë kënaqësi pothuajse mishërore.

"Gjysmë ore" i përket poezive të fshehura të poetit, të cilat ai vetë refuzoi t'i botonte gjatë jetës së tij, dhe pikërisht këto vargje ishin fari im ndriçues për gjashtë vjet. Ajo që më digjte që në fillim ishte të kapja çastin, atë çast të jashtëzakonshëm, kur dëshira erotike shndërrohet në shtysë krijuese. Jeta dhe arti janë të pandashme te Kavafisi. Sa i përket dinamikës mes tyre, mund të thuash shumë gjëra dhe zakonisht gjëra të konsumuara. Fakti është, gjithsesi, se duket sikur pas artit dhe artistit fshihet një mangësi, një kompleks, një traumë; duhet të të mungojë diçka që të shkruash, të krijosh. E them këtë disi në mënyrë skematike, por e besoj. Përtej gëzimit që krijon një botë të re... Mungesa është një shtysë e fuqishme. Si në dashuri. Një dashuri e plotë që gjen përgjigje shuhet shpejt; përkundrazi, kur objekti i dëshirës erotike të largohet gjithnjë e më shumë, ti mendon se po e nënshtron, por ai mbetet i paarritshëm, flaka mbahet e gjallë.

Nga vjen arti?

Cili është burimi i tij? Kjo është pyetja në bërthamën e *Çfarë mbetet nga nata*. A mund të lindë arti nga diçka fare e vogël, nga një hollësi e parëndësishme? Nga një qime, pak më e fortë se të tjerat, mbi testikulin e butë të një balerini rus, e cila papritur përskuqet, merr flakë, i vë zjarrin ekzistencës sonë dhe derdhet dhunshëm në krijim?

Çfarë mbetet nga nata

Fragment nga romani

Sërish u dëgjua e njëjta gurgullimë.

Dikush po lahej brenda dhomës. Mbylli sytë, ngjiti veshin te vrima e çelësit. I bëri duart si hinkë. Asgjë. Mendja e tij prodhonte vetë zhurma.

Ishte e çuditshme. E tërhiqte mosha e pleqërisë. Jo, nuk e tërhiqte, sepse ndiente neveri për pleqtë - lëkura e tyre e lëvarur, shprehja e përhumbur në sytë e ujshëm. Diçka tjetër ishte. Ishte ende i ri, e megjithatë kishte nostalgji për rininë sikur të ishte plak. Ndoshta sepse ishte trembëlak, i ndrydhur? Frikanjos dhe njëherazi thurte ëndrra për pasione të forta. Ndihej i robëruar brenda një trupi që shumë shpejt do të plakej, që tashmë dobësohej çdo ditë, gërmuqej, dhe ato buzë, ende të trëndafilta, sikur të mos i përkisnin. Sa epsh kishte të puthte një gojë të re... si goja e tij! Sikur të ishte e ndaluar për të, sikur vetë atij t'i mungonin dhëmbët, mishrat e dhëmbëve t'i ishin bërë gri, fryma t'i mbante erën e qelbur të pleqërisë.

Kishte mall të ndjente mall. Dëshironte që ato që mund t'i shijonte tani, një trup të bukur mashkullor, dashurinë ashtu siç e kuptonte ai - që mund t'i shijonte nëse nuk tregohej trembëlak - të bëheshin të paarritshme, të pakapshme, që të mund t'i shijonte vetëm me fuqinë e kujtesës dhe të Artit. Apo ishte vetëm tremba e tij? Dhe gjithçka tjetër vetëm sofizma?

Shprehje e dobët.
Mungesë mjeshtërie

Sërish refreni i trishtë. Mendonte se e kishte harruar, por heraherë kthehej. Ishte vula që do t'i mbetej nga udhëtimi në Paris. Do ta kishte sqaruar po të kishte folur me Xhonin, po t'i ishte hapur. Por pas rrëfimit të natës në shkallë, diçka e tillë dukej e pamundur. Në këmbim, do t'i duhej të bënte lëshime.

E megjithatë... një minutë...

Vuri veshin. Ky me siguri ishte zhurma e ujit që rrjedh.

Dikush po lahej brenda dhomës. Uji rridhte nga broka, derdhej në lavamanin prej porcelani.

Dy duar fërkonin qafën e fuqishme, shpëlanin fytyrën.

Një dritë e zbehtë hynte nga dritarja. Ishte shtrirë dhe priste valltarin e ri në shtrat. Gjithçka që kishte ndodhur më parë mes tyre nuk ishte veçse fillimi, një meze e lehtë para vaktit kryesor. Tani shihte vithet e tij lakuriqe, të lara në dritë si në një pikturë, shpatullat e thanta, gropëzat e arta në lartësinë e veshkave. Djaloshi u kthye nga ai. Një kafshim i vogël mrekulliplotë. Mbylli sytë. Uji rridhte ende. Derdhej vrullshëm në lavamanin prej porcelani. Erëmimi i tij e magjepsi. I njomë, i papërcaktuar. Me një aromë djerse që i gudulisi vrimat e hundës. Zgjati dorën të ledhatonte një kaçurrelë të gështenjtë - ishte e njëjta që e kishte torturuar dje në kolltuk, që kërcente mbi brokadë dhe i shpëtonte. Shtrati kërciti. Djaloshi u shtri pranë tij. Sa i ngrohtë dhe i butë ishte trupi i tij. Muskujt të vizatuar bukur. Në gatishmëri... Sa dhunë çlirohej nga pjesa e fundit e barkut të butë. Kafshime. Puthje të egra thellë në gojë. Duar të lidhura, kapje të befta. Shuplaka. Goditje. Gojë që luftonin të bashkoheshin të penguara nga gjymtyrët që ishin lidhur si oktapodë. Mos lëviz, i tha. Djaloshi merrte frymë me vështirësi. Mos lëviz, i tha sërish. Zemra po i shpërthente. E kapi nga krahët, i përdrodhi kyçet, u përpoq ta mbante të palëvizshëm. I rrëshqiti. U përleshën. Tjetri u dorëzua. E puthi, e ledhatoi i pangopur. Atëkohë vuri re diçka. Një hollësi që i shkaktoi rrëqethje. Diçka fare të vogël, në kufijtë e imagjinatës. Dora e tij bënte një hark, kur majat e gishtërinjve i ceknin kokën e penisit, ndërsa testikujt e djaloshit mbështeteshin në pëllëmbën e tij dhe fërkoheshin lehtë. Aty kishte një qime të vogël... Një qime e vogël që i gërvishte dorën, një qime e vetme, më e fortë dhe ndoshta më e gjatë, që dallohej nga të tjerat - të gjitha të tjerat në atë zonë ishin të buta, foshnjarake - që i kruante lëkurën, që e bënte të kishte marramendje. Vetëm një qime e vogël. Fluturimi i kënaqësisë. Arti nuk është vetëm çfarë do të thuash, por si do ta thuash, i erdhi ndër mend ndërsa me një lëvizje të papritur trupi i djaloshit i hipi sipër dhe rëndoi me të gjithë peshën e tij.

Ishte mpirë krejt, e kishin zënë ngërçe. Nuk duronte dot më. Duhej të kthehej në dhomën e tij, të mbyllej shpejt brenda, duhej të çlirohej - për herë të tretë brenda njëzet e katër orësh! Ledhatoi kornizën e derës. Një qime e vogël. Dhe ndërsa ndiente peshën e valltarit të ri sipër tij, që e shtypte, i paralizuar siç ishte përpiqej të përqendrohej te qimja që të mos e humbiste, ta mbante në pëllëmbë deri në dhomën e tij, që ta gërvishte dhe ta ndizte për dhjetë apo pesëmbëdhjetë hapa, derisa të hapte derën, ta mbyllte me ngut pas vetes dhe të ulte pantallonat. Truri i digjej, sytë i shkaktonin dhimbje, ç'të bënte që të mos i ikte qimja, a ishte e mundur të mos e humbiste në korridor, si mund ta linte, t'i thoshte lamtumirë asaj ndjesie të shkëlqyer, ku do ta gjente forcën? Braktis, tha me vete, braktis, një fjalë nga Plutarku, si e gjen forcën të braktisësh atë që e do më shumë se gjithçka tjetër, cili është çmimi? Sytë i cuknin, i përvëlonin zgavrat, dhe pyeste veten si do të mund të thoshte jo, tri herë jo dhe të hiqte dorë nga kënaqësia e adhuruar.

U mbështet në mur, u mbështet te korniza e derës dhe u ngrit. Eci duke u lëkundur. Në dhomën e tij hapi dollapin dhe kërkoi dorezën prej leshi. Nuk e kishte përdorur që nga Aleksandria. Nxori kraharorin para pasqyrës, e zhyti dorezën në ujin e lavamanit dhe u fërkua me furi.

Hodhi ujë në veshë. Shpëlau gojën shumë herë.

Tri përkulje të thella.

Frymëmarrje.

Përkulje derisa iu morën mendtë.

Marrje fryme nxjerrje fryme.

Përkulje.

Tani ishte në rregull.

Nuk ishte dorëzuar. Jo këtë herë. E kishin ndihmuar Rregullat e tij. Pothuajse ndihej i këndellur. Do t'i pëlqente të lexonte një poezi të bukur, do t'i pëlqente të shkruante. Shkoi te dritarja, hodhi një vështrim jashtë. Po, kishte dëshirë të shkruante. Errësira shpërbëhej në masa të purpurta që dridheshin. Dita po vjen me galop, mendoi dhe buzëqeshi.

Përktheu nga origjinali: Maklena F. Nika

Kadareja është një figurë e madhe e letërsisë. Një nga romanet e mi më të dashur ka qenë 'Gjenerali i ushtrisë së vdekur'. Fakti që nuk e mori Nobelin nuk e zbeh aspak madhështinë e tij.

DAMIR KARAKAŠ:
Ballkani gjithmonë ka përjetuar një post-përvojë të tragjedisë greke

Intervistoi: Liridon Mulaj

Damir Karakaš është një shkrimtar me një jetë po aq të larmishme sa edhe letërsia e tij. Muzikant, piktor, ushtar, gazetar dhe shkrimtar, ai e ka ndërtuar veprën e tij mbi përvojën, kujtesën, luftën dhe njeriun e zakonshëm që përballet me historinë, shpesh edhe pa e kuptuar.

I lindur në Likë të Kroacisë, një trevë e njohur për peizazhin e ashpër, varfërinë dhe historinë e saj të trazuar, ai e ka kthyer këtë hapësirë në një nga burimet e letërsisë së tij.

Pjesë e Festivalit Ndërkombëtar të Letërsisë "Tirana Gate 2026", organizuar nga Instituti i Librit dhe Promocionit, ai vjen në Shqipëri për herë të parë me romanin "E kremtë" ("Proslava"), botuar në shqip nga shtëpia botuese Toena. Një histori ku jeta e një njeriu të zakonshëm, ushtarit Mijo, përplaset me mekanizmat e historisë, shpesh pa e kuptuar rolin e tij në të.

Në këtë intervistë për "ExLibris", ai flet për marrëdhënien e tij me Shqipërinë, kujtimin e shqiptarëve të Kosovës që njohu gjatë viteve të studimit në Zagreb dhe admirimin e tij për Ismail Kadarenë. Flet për Krležën dhe Andrićin, për letërsinë ballkanike dhe mungesën e përkthimeve mes dy vendeve, por edhe për luftën, nacionalizmin dhe përgjegjësinë e letërsisë për të kuptuar njeriun përtej etiketave të "heroit" dhe "fajtorit".

1. Pas pak ditësh do të vizitoni për herë të parë Tiranën dhe do të merrni pjesë në Tirana Gate, një festival letrar me një traditë 12-vjeçare. Në të njëjtën kohë, libri juaj "E Kremte" *("Proslava") do të botohet në shqip.* Çfarë prisni nga festivali? *A njihni shkrimtarë shqiptarë dhe cilat janë përshtypjet tuaja të përgjithshme për Shqipërinë?*

Pres me kënaqësi festivalin në Tiranë, përvojat e reja dhe faktin që më në fund do ta shoh këtë qytet, për të cilin të gjithë më flasin me shumë lavdërime. Nuk kam qenë kurrë në Shqipëri, por gjithmonë kam pasur një dëshirë të madhe për të ardhur. Në Jugosllavi, Shqipëria për ne ishte misterioze; në shkollë na mësonin se ishte plot me tela me gjemba dhe bunkerë, e përfytyronim si një lloj ishulli të mbuluar nga mjegulla. Dy miqtë e mi më të mirë, kur studioja në Zagreb, ishin shqiptarë nga Kosova. Prej tyre mësova shumë për kulturën shqiptare. Në atë kohë shoqërohesha shumë me studentë nga Kosova dhe e di që disa mendonin se edhe unë isha shqiptar. Një nga romanet e mi më të dashur të asaj kohe ishte romani i madh kundër luftës, "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", i Kadaresë. Edhe pse një koleg më paralajmëroi: "Mos e lavdëro shumë Kadarenë atje në Tiranë, sepse ka edhe nga ata që nuk e duan; e konsiderojnë të privilegjuar, mendojnë se ka lënë në hije shkrimtarët e tjerë, se ka menduar vetëm për veten", për mua ai është një figurë e madhe e letërsisë. Pasi nuk e mori Çmimin Nobel, ky çmim, përveç anës financiare, për mua nuk ka më ndonjë vlerë të madhe. Është bërë më shumë një çështje gjeopolitike sesa letrare. Në një intervistë të Kadaresë lexova se Hoxha vishej shumë bukur dhe se Titoja ishte shumë xheloz për këtë. Pastaj edhe Titoja filloi të vishej bukur, kështu që Elena Çaushesku, e zemëruar, i kërkoi burrit të saj që edhe ai të fillonte të vishej bukur, si Titoja. Ato uniformat e bardha të Titos, Mercedesët, purot kubane që pinte, filmat ëestern që shikonte, gjuetitë e arinjve që ia organizonin, dhe gruaja e tij Jovanka nga Lika, e cila, meqë ra fjala, kishte qenë bareshë dhe vishej si ylli më i shkëlqyer i Hollivudit; ndërsa socializmi... e gjithë kjo duket si një film qesharak. Tani është edhe më keq. Prandaj kemi nevojë për higjienë mendore në formën e filmave cilësorë, muzikës, shfaqjeve teatrale dhe, veçanërisht, letërsisë, e cila, sipas meje, nuk është vetëm e dobishme, por e domosdoshme për të kuptuar botën dhe veten, sepse libri është baza; prej tij fillon gjithçka dhe, kur të mos ketë më libra, nuk do të ketë as botë.

2. Kur flasim për letërsinë kroate, shpesh na vijnë në mendje dy emra të mëdhenj: Miroslav Krleža dhe Ivo Andrić. Megjithëse vendet tona janë gjeografikisht shumë pranë, ende ka pak përkthime mes letërsisë kroate dhe asaj shqiptare. Vizita juaj në Shqipëri dhe botimi i librit tuaj janë një mundësi e mirë që lexuesit shqiptarë të zbulojnë më shumë shkrimtarë bashkëkohorë kroatë. Si e shihni këtë mungesë të shkëmbimit letrar mes dy vendeve tona?

Krleža, i cili gjithashtu ishte pranë Nobelit, nuk e donte Andrićin. Mendonte se, nëse Andrići nuk do ta kishte marrë Nobelin, do të kishte mbetur i panjohur. Mendoj se e tepron. Andrići, në rininë e tij, ishte në Zagreb, por mendoj se edhe për shkak të Krležës u drejtua nga Beogradi, sepse mendonte se nuk do të mund të bëhej ai që u bë, përkrah Krležës, i cili që në vitet '20 ishte një yll i madh. Krleža e futi vendlindjen time, Brinjen në Likë, në letërsi që para Luftës së Dytë Botërore. Në shënimet e tij nga Hungaria shkroi se Franc Jozefi ishte "budalla si postieri nga Brinja". U zemërova shumë kur e lexova këtë. Por ai më mësoi se duhet shkruar me guxim dhe, nëse është nevoja, edhe me vrimat e hundës të zëna. Ndërsa Andrići dikur tha për këto treva tona se kjo është një tokë me shumë male, por me pak shpirt. Më parë, në Jugosllavi, nuk kishte përkthime sepse librat nga Shqipëria ishin të ndaluar tek ne. Miku im Augustin Palokaj, korrespondent i mediave kroate në Bruksel, përktheu rreth pesëmbëdhjetë vjet më parë romanin e Ben Blushit dhe më tha se i kishin thënë se, gjatë pesëdhjetë viteve të fundit, ky ishte i vetmi përkthim nga shqipja në kroatisht. Librat e Kadaresë në Jugosllavi përktheheshin nga frëngjishtja. Megjithatë, kohët e fundit situata po bëhet gjithnjë e më e mirë. Klubi letrar Booksa i Zagrebit botoi disa vite më parë një antologji të shkrimtarëve të rinj shqiptarë. Do të thosha se mungojnë edhe përkthyesit, sepse shpesh janë pikërisht ata që nisin botimin e librave të disa shkrimtarëve.

3. Jeta juaj ka përfshirë shumë pasione dhe përvoja të ndryshme: keni qenë muzikant, piktor, ushtar, gazetar dhe më pas shkrimtar. A mendoni se një shkrimtar mund të shprehet përmes formave të ndryshme të artit dhe përvojave të ndryshme jetësore? Apo letërsia, në fund të fundit, është një gjuhë krejtësisht më vete?

E gjithë kjo, në njëfarë mënyre, ka të njëjtin qëllim, vetëm se përdoren mjete të ndryshme. E rëndësishme është të punosh shumë me veten, dhe çdo përpjekje të çon në mënyrë të pashmangshme drejt një njohjeje. Por, në gjithë këtë, përvoja është gjithashtu shumë e rëndësishme, sepse ajo që nuk e përjetojmë brenda vetes nuk është aq e thellë. Mund të lexosh shumë libra, vagona me libra, por pervoja është tjetër gjë. Ke Dostojevskin, jeta e të cilit, siç e dimë, ishte një ferr i vërtetë. Ai i përjetoi të gjitha sprovat, jeta e tij ishte një varg fatkeqësish. Por ai është padyshim një shkrimtar që shkoi deri në kufijtë e fundit. Ka edhe shkrimtarë të tjerë që shkuan deri në fund, Niçe dhe Bodleri, të cilët gjithashtu kapërcyen të gjitha barrierat. Për shembull, unë e kam përjetuar luftën. Në luftë mund të vdesësh vetëm një herë, por në jetë mund të vdesësh disa herë, dhe kjo më ka ndodhur edhe mua. Ka pasur shumë fatkeqësi, por sa i përket fatkeqësisë, ajo mund të jetë edhe shumë frymëzuese. Sepse fatkeqësia është më e pasur se lumturia . Lumturia është qëllim në vetvete, ndërsa fatkeqësia duhet të shndërrohet në diçka tjetër, në një libër, film, shfaqje teatrale. Përveç kësaj, te "Odisea" thuhet se perënditë ua dhanë njerëzve fatkeqësinë që ata të kishin çfarë të këndonin.

4. Historia e Mijos në romanin tuaj "E Kremte" është, në njëfarë mënyre, edhe historia e një njeriu të zakonshëm ballkanas: i varfër, i shtypur dhe i përfshirë në ngjarje të mëdha historike, shpesh pa e kuptuar plotësisht se çfarë po ndodh. Ju e tregoni këtë histori në një mënyrë shumë të thjeshtë dhe të përmbajtur, por historia lokale bëhet shumë më e madhe. Pse mendoni se njerëzit në Ballkan kanë qenë kaq shpesh të gatshëm të sakrifikohen në emër të historisë?

Ballkani gjithmonë ka përjetuar një post-përvojë të tragjedisë greke. Luftëra brutale, grabitje të egra, ndarje mes të pasurve dhe të varfërve. Përveç kësaj, mënyra më e lehtë për të shkatërruar njerëzit është t'u mohosh kuptimin e së kaluarës së tyre, dhe te ne, në Ballkan, kjo ndodh vazhdimisht. Nuk duhet harruar as se në shoqëritë tona folklorike në Ballkan, armët kanë qenë gjithmonë rekuizita kryesore. Emil Cioran ndoshta e ka përshkruar më së miri këtë Ballkanin tonë, duke thënë se ai shkon nga humbja në humbje, por se edhe ky është një lloj përparimi.

*5. Romani ndjek një strukturë kronologjike të përmbysur. Fillimisht e shohim Mijon si ushtar që fshihet në pyll, i frikësuar nga autoritetet e reja, dhe vetëm në fund shohim se si ai, në mënyrë naive, hyri n*ë luftë. Pse zgjodhët ta rrë*feni*

historinë nga fundi? Si e ndryshon kjo strukturë mënyrën se si lexuesi e kupton dhe e gjykon Mijon?

Po kërkoja një mënyrë se si ta rrëfeja gjithë këtë sa më mirë dhe kronologjia e përmbysur m'u duk varianti më i mirë, veçanërisht sepse thelbi është se ne vazhdimisht sillemi në një lloj rrethi. Edhe sot jetojmë në një rreth nga i cili nuk kemi dalë prej njëqind vjetësh, dhe kam frikë se nuk do të dalim as për njëqind vitet e ardhshme. Dhe kjo nuk është vetëm çështje e Ballkanit, por edhe e botës. Lufta e viteve '90 që ndodhi tek ne nuk u prodhua në vitet '90; ajo u prodhua në Luftën e Dytë Botërore, madje edhe shumë më herët, sepse shumë gjëra gjithmonë janë shtyrë nën qilim. As tani situata nuk është më e mirë, sepse kudo në këto ish-shtete të Jugosllavisë mbizotëron një nacionalizëm serioz. Askush nuk dëshiron të shohë në mënyrë kritike veten. Dhe nëse i mohojmë krimet që janë kryer nga pala jonë në të kaluarën, hapim rrugë për krime të reja në të ardhmen. Kështu është në Ballkan, kështu është në Evropën Lindore, në Rusi, Ukrainë, Izrael, Palestinë, në Lindjen e Mesme... E gjitha është e njëjta matricë. Pandryshueshmëria, pikërisht si ajo pamja në roman kur ustashët joshin rekrutët duke i frikësuar me komunizmin, për të cilin fshatarëve analfabetë u thonë se është një sistem ku "vëllai kap motrën". Ndërsa të vegjlit grinden mes tyre, të mëdhenjtë pasurohen. Dikush përfiton shumë nga të gjitha këto luftëra dhe vuajtjet e të tjerëve. Ndërsa sot ndoshta më shumë se kurrë më parë duket se kjo as nuk i prek njerëzit; ata janë më të interesuar se çfarë do të jetë në trend nesër dhe ku ka ulje çmimesh në qendrat tregtare.

6. Titulli "Proslava" ("E Kremte") mbart një ironi të thellë dhe tragjike. Ai i referohet si ardhjes së regjimit të ri, ashtu edhe entuziazmit naiv të fshatarëve në fillim të luftës. Çfarë do të thotë kjo "kremte" për njerëzit e zakonshëm që jetojnë në varfëri dhe izolim? Çfarë po kremtojnë në të vërtetë?

Ideologjia dhe politika janë gjithmonë aty, janë edhe tani aty dhe, duam apo nuk duam, ato ndikojnë në mënyrë të pashmangshme në jetën tonë. Kështu ndodh edhe me historinë e ushtarit Mijo, i cili, ashtu si te Dostojevski, është njëkohësisht edhe xhelat edhe viktimë. Unë u përpoqa të hyj në labirintet e ndërgjegjes së një personi të tillë, por në mënyrën që na këshillon Montenji: për të kuptuar dikë, duhet ta ndjekim gjatë dhe me kureshtje gjurmën e tij. Meqë ra fjala, një historian i ri danez, Emil Kjerte, kohët e fundit bëri një studim në Kroaci se kush ishin ata që në ato vite shkonin te ustashët. Ai zbuloi se një pjesë e madhe e ushtarëve iu bashkuan për arsye shumë të thjeshta: për një vakt të ngrohtë, një shtrat, një palë çizme të reja. Romani im flet pikërisht për këtë: se si një i ri, që nuk ka arsimim të mjaftueshëm dhe që jeton me një pasiguri të caktuar ekonomike e jetësore, bie lehtësisht në një ideologji të tillë të ekstremit të djathtë. Edhe pse këtu bëhet fjalë për një histori se si fashizmi rritet mbi tokën e paditurisë, mendoj se pikërisht kjo po ndodh edhe sot, kudo në botë. Një ushtar i ri që sot ose nesër do të luftojë në ndonjë front përjeton një fat të ngjashëm, ashtu si një ushtar tjetër në anën kundërshtare, i cili është rritur në varfëri dhe që regjistrohet në ushtri për të pasur mundësi arsimimi dhe, për shembull, sigurim shëndetësor. Janë interesante edhe ato "Kremte" që zhvilloheshin në atë kohë, në fillim të luftës, në Likë. Pas krijimit të Shtetit të Pavarur të Kroacisë, në zonat rurale dhe fshatrat e largëta organizoheshin kremtime që shërbenin për rekrutimin e të rinjve në ushtri. Organizonin një panair të madh dhe gjithçka ishte falas, ushqimi, pijet, diçka si një fushatë PR.

7. Në pjesën e fëmijërisë, skena me qenin e familjes tregon ashpërsinë e mbijetesës, ku uria lë pak hapësirë për mëshirë. Ku e shihni kufirin mes moralit njerëzor dhe instinktit të mbijetesës në kushte të tilla ekstreme rurale? A mund ta gjykojmë një njeri me të njëjtat standarde morale kur mbijetesa bëhet shqetësimi kryesor?

Sigurisht që duhet të kemi kritere të ndryshme, por është interesante gjithashtu se si, në këtë botë të ndërtuar sipas modelit kapitalist, edhe kjo është përmbysur në mënyrë të shëmtuar: njerëzit do t'ia falin më shpejt abuzimet e mëdha korporative një tipi elegant me kostum, sesa do të kenë mirëkuptim për një hajdut të vogël e të varfër.

8. Mijo nuk udhëhiqet nga ndonjë ideologji e madhe politike. Ai përfshihet në luftë pothuajse pa e kuptuar atë, i shtyrë nga rrethanat, frika dhe mungesa e njohurive. A mendoni se letërsia duhet t'i shohë figurat historike jo vetëm si "heronj" ose "fajtorë", por edhe si qenie njerëzore të zakonshme që, në një moment të caktuar, thjesht gjenden brenda historisë dhe duhet të zgjedhin një krah?

Shumë njerëz si Mijo as nuk e dinin për çfarë po luftonin. Shkuarja e njerëzve te partizanët në vitet e mëvonshme në territorin e ish-Jugosllavisë dhe lufta kundër fashizmit ishte disi më e qartë, sepse lufta tashmë kishte filluar, por në atë fillim njerëzit nuk e dinin se çfarë do të ndodhte. Dhe këtu në histori hyjnë uria, varfëria, patriarkalizmi. Para se të fillonte xhirimi i filmit bazuar në roman, për skenarin e të cilit ndihmoi edhe fituesi i Oskarit, Pavel Pavlikovski, ekipi i filmit kërkonte një fshat në Likë që do të paraqiste me besnikëri arkitekturën e njëqind viteve më parë. Kishin frikë se nuk do ta gjenin dhe se një pjesë e madhe e buxhetit do të shkonte për ndërtimin e skenografive. Por pastaj e gjetën, jo vetëm një, por qindra të tillë. Me dysheme prej dheu nëpër shtëpi, me stalla, me kafshë të kequshqyera. Të gjitha këto vetëm 50 minuta larg kryeqytetit të një shteti evropian. Në libër është edhe episodi i vrasjes së gjyshit, anëtarit më të vjetër të familjes, të cilin e lënë në pyll që të ketë një gojë më pak për të ushqyer. Ishte diçka e përcaktuar nga rregullat patriarkale. Edhe babai i Mijos vërtet duhet të marrë disa vendime që jeta të vazhdojë, që fëmijët të kenë çfarë të hanë. Uria dhe varfëria përcaktonin gjithçka. Prandaj arsimi është i rëndësishëm, prandaj librat janë të rëndësishëm. Njerëzit duhet të ndërgjegjësohen për modelet që çojnë drejt luftërave, në mënyrë që luftërat të mos ndodhin më, që të mos ketë këmbësorë dhe ushtarë që vdesin për interesat e dikujt, duke e ditur se këto interesa në të vërtetë nuk janë të tyret. Ndoshta atëherë nuk do të kishte as luftëra.

Stili juaj është shumë minimalist, me fjali të shkurtra dhe përshkrime të përmbledhura të emocioneve dhe shqisave. Sa ka ndikuar vendlindja juaj, rajoni i Likës, me peizazhin e ashpër dhe jetën e izoluar rurale, në mënyrën se si u zhvillua gjuha juaj letrare dhe stili juaj narrativ? A mendoni se një peizazh mund të formësojë edhe mënyrën se si shkruan një autor?

Kam lindur në rajonin malor kroat të Likës; ajo, si topos, është një kornizë e fuqishme formuese e identitetit dhe punës sime. Ajo ka qenë gjithmonë e njohur për varfërinë, dimrat e ashpër, ujqërit, por edhe për shpikësin e famshëm botëror Nikola Tesla. Ashtu si në Ballkan, edhe në Likë, gjatë historisë, gjaku ka qenë gjithmonë ai që ka lulëzuar më fuqishëm. Njerëzit në Likë kryesisht ishin ushtarë që luftonin për zotërinj të ndryshëm dhe e gjithë kjo në mënyrë të pashmangshme ndikoi edhe në mentalitetin e tyre. Ata ishin fshatarë, bujq, por në çdo çast ishin të gatshëm të merrnin armët dhe të shkonin në luftë. Gjyshi im, stërgjyshi im, babai im, të gjithë kanë qenë ushtarë. Edhe unë, i ri, kam qenë ushtar në luftën e kaluar, edhe pse nuk e dua luftën, për të cilën Majakovski thotë se është një marrëzi horizontale dhe vertikale. Në romanin tim të fundit, "Sunčanik", kur nipi dhe gjyshi udhëtojnë përmes malit për të parë djallin që, gjoja, e kanë kapur barinjtë dhe duan ta pyesin diçka, kalojnë pranë një vendi ku janë varrosur ushtarët. Kur nipi e pyet gjyshin nëse ata ushtarë nën tokë janë tanët apo të tyre, gjyshi i përgjigjet: "Të gjithë ushtarët janë tanët, vetëm shenjat në kapele i kanë të ndryshme." Meqë ra fjala, kur fillova të merresha me letërsi tridhjetë vjet më parë, e dija se, nëse letërsia është e vërtetë, ajo nuk duhet të ketë mëshirë për askënd, e aq më pak për autorin. Sigurisht, një lloj i tillë letërsie krijon edhe armiq. Dhe vërtet kam kaluar shumë gjëra gjatë karrierës sime letrare, e cila ndonjëherë ka qenë një luftë për jetë a vdekje. Më e keqja ishte padyshim kur u sulmova, u plagosa rëndë dhe humba edhe një organ jetësor. Por mirë, ndoshta është pozita e natyrshme e shkrimtarit të jetë në konflikt me mjedisin përreth. Në përgjithësi, sot jetojmë në një gjendje të pafundësisë së keqe, në një shoqëri të gjymtuar, pa empati. Njerëzit janë të mbushur me zbrazëti të brendshme, të kalbur nga politika; në sytë e tyre shihet çdo libër i palexuar. Sistemi arsimor ka dështuar, prandaj gjithçka rreth nesh është plot me injorantë, dhe injorantët dinë më së miri nga të gjitha të urrejnë. Por, sido që të jetë, letërsia është shumë e rëndësishme për mua. Siç thotë Floberi, e vetmja mënyrë për ta përballuar këtë jetë është të hysh në letërsi si në një orgji të përhershme. Ajo është gjithashtu territori i lirisë, dhe për lirinë duhet të luftojmë dhe të mos lejojmë që jeta të na burgosë në asnjë mënyrë.

Martina Hefter – Fituese në Panairin e Frankfurtit 2024 e Çmimit Gjerman të Librit vjen në Tiranë në festivalin Tirana Gate 2026.

MARTINA HEFTER

Zero

fragment nga romani | Përktheu nga gjermanishtja Anna Kove

Jeton në Lajpcig. Në vitet '90 studioi në Berlin vallëzim bashkëkohor dhe më vonë në Institutin Gjerman të Letërsisë pranë Universitetit të Lajpcigut. Krahas punës së saj si shkrimtare, realizon performanca skenike, shpesh në bashkëpunim me artiste dhe artistë të tjerë.

Romani i saj Hey guten *Morgen, wie geht es dir? / Hej, mirëmëngjes, si je?* fitoi në Panairin e Frankfurtit në vitin 2024 Çmimin Gjerman të Librit (Deutscher Buchpreis) dhe me çmimin evropian Prix Grand Continent. Për krijimtarinë e saj letrare, Martina Hefter ka marrë gjithashtu Çmimin e Madh të Fondit Gjerman të Letërsisë, si edhe Çmimin e Letërsisë së Visbadenit, veçanërisht për punën e saj ndërdisiplinore në letërsi.

Ndër botimet e saj më të fundit janë vëllimet me poezi Es könnte auch schön werden / Mund të bëhet edhe bukur dhe In die Wälder gehen, Holz für ein Bett klauen / Të shkosh në pyll, të vjedhësh dru për një shtrat, të botuara, gjithashtu nga shtëpia botuese Klett-Cotta. Në tetor 2026, po aty do të botohet romani i saj i ri Nach der Sonne schauen / Të vështrosh nga dielli.

Kishte kohë që nuk e zinte më gjumi. Por, edhe kur flinte, shihte në ëndërr gjëra të marra, qenushë të vegjël, që i vërshonin me qindra nëpër apartament dhe lehnin si të tërbuar. Edhe ajo vetë u kthye shpejt në kafshë; nuk e pastronte më apartamentin. Natën kafsha rrinte syçelë, por nuk ishte kushedi sa aktive.

Shtrihej mbi një dyshek gjimnastike në dysheme, bënte ndonjë ushtrim të rastësishëm për muskujt e barkut dhe kaq. Në të vërtetë, pjesën më të madhe të kohës e kalonte duke vështruar tavanin. Atje ishte një reliev stukoje, disa rrathë koncentrikë, mbi të cilët lundronin ca lule. Aq shpesh ishin lyer me bojë, sa dukeshin si planetë. Rrotulloheshin në orbitat e tyre, ditë e natë. Ishte krejt bukur t'i shihje planetët dhe asgjë tjetër.

Ndonjëherë Xhuni dëgjonte mekanizmin e shtratit të përkujdesit në dhomën e Jupiterit që uturinte; atëherë e kuptonte se ai ishte ende zgjuar dhe po rregullonte pjesën e shtratit ku mbështetej koka. Ai duhej ta vinte re kur ajo shkonte në tualet ose në kuzhinë për të marrë ndonjë gotë ujë. Por Jupiteri nuk i bënte kurrë pyetje; e çfarë do t'i kishte thënë ajo? *Nuk mund të fle më, sepse gjithçka po bëhet e tepërt për mua.*

Diçka e tillë. Së pari, nuk ishte e vërtetë dhe, së dyti, kjo nuk do të shpjegonte aspak asgjë.

Ndonjëherë merrte telefonin dhe hapte Instagramin. Në *feed* nuk shihte fare; zakonisht ai ishte i mërzitshëm. Më me qejf shkonte menjëherë te mesazhet private. Një kureshtje vezulluese e hovte përpjetë. A kishte ardhur sërish ndonjë mesazh nga ndonjë i panjohur? Në këtë rast, fjala *kërkesë* ishte me shkronja të trasha dhe blu.

Në të vërtetë, pothuajse çdo natë ishte me shkronja të trasha dhe blu.

Hi, më e bukura / Përshëndetje, bukuroshe / Hi, ti rreze dielli, si je?

Ata që i shkruanin quheshin Jimmy Taylor_354 ose Marcus DeBuonaventura. Quheshin Phil Gibson1973. William Smith dhe Dr. Antonio Alessandro. Tipa të nxirë nga dielli para jahteve me vela, burra të bardhë, flokëthinjur, me kapele bejsbolli dhe mjekër treditëshe. Një kauboj me çizme që pozonte para një ferme. Një gjeneral i ushtrisë amerikane me uniformë ushtarake. Një i ve me dy fëmijë; në një kuzhinë luksoze po bënin petulla.

Në të vërtetë, djem të rinj, që rrinin në një internet-kafe diku larg dhe shtypnin gënjeshtra kiç në kompjuter ose në telefon. Xhuni kishte parë dikur një dokumentar në *YouTube*; me titullin *Love-Scamming*. Dukej se ishte biznes i mirë. Ata u shkruanin grave më të mëdha në moshë, që dukeshin beqare, përmes një profili të rremë:

Pashë foton e profilit tënd dhe menjëherë u magjepsa pas teje.

Pastaj mashtruesit e dashurisë nisnin të ndërtonin një marrëdhënie.

Mirëmëngjes, e dashura ime.

Çfarë ke ngrënë sot? Kujdesu për veten.

I love you.

Stikersa me trëndafila të kuq. Stikersa me filxhanë kafeje, ku shkruhej *love*.

Një djalë i ri filmohej teksa lexonte një libër mbi manipulimin psikologjik.

Sa shumë më mungon! Ëndërroj ta kaloj jetën me ty.

Në një moment të caktuar, mashtruesit e dashurisë u kërkonin grave para.

Jam në një udhëtim pune dhe më ndodhi një aksident, tani jam në burg dhe nuk mund të hyj në llogarinë time bankare, a mund të më ndihmosh pak?

Xhuni ishte njëkohësisht e tronditur dhe e magjepsur nga numri i madh i grave që u besonin gjërave të tilla. Në dokumentar ato tregonin hapur se çfarë shumash kishin transferuar në fund, në vende të largëta me *Western Union*.

E tani edhe ajo kishte rënë në radarët e tyre, pikërisht ajo, Xhuni Isabela Flok. Xhuni, gruaja e Jupiterit, por këtë mashtruesit e dashurisë nuk e dinin. Pa u shqetësuar aspak, ata vazhdonin t'i dërgonin kërkesa. Dhe Xhunit i pëlqente t'u përgjigjej.

Në euforinë e errët e vezulluese të zgjimit, shumë kohë pas mesnate, nga dhoma e saj me planetët në tavan.

Hi, grua e bukur.

Hi.

Si je, si është moti atje tek ju?

Jam mrekullisht mirë, faleminderit.

Këtu kemi temperaturën 45 gradë, të bëhet truri qull. Çfarë pune bën?

Punoj në një kompani ndërtimi, ARCO, por jam edhe këshilltar financiar.

Po ti, çfarë bën?

Ushqej skifterët e mi, kam tre, secili kushton 20 000 dollarë. Quhen Leo, Bubo dhe Lukas.

Uau, sa interesante duket!

Burrë i bardhë, në moshë të mesme, me flokë të thinjur, kishte veshur pantallona të shkurtra dhe qëndronte nën një palmë.

Burrë i bardhë, me flokë të thinjur, mbështetur te një kabriolet.

Burrë i bardhë, i puthur nga dielli, përqafonte një qen të bardhë, leshatak.

Një marinar kalifornian, një ushtarak me flokë paksa të thinjur, me identitet të vjedhur.

Ejani te Xhuni. Ajo dëshiron të luajë me ju.

Hi, faleminderit, jam mirë.

Unë jetoj në Gjermani, një vend me pishina gjigante fokash në kopshtet zoologjike.

Çfarë bëj? Shtrihem në banjë, pi liker, si të gjithë në Gjermani.

Pi kartëmonedha, a ke provuar ndonjëherë?

E martuar? Aspak, jetoj me tre shërbëtorë, dy burra dhe një grua, shajmë njëri-tjetrin ndërsa pimë një arkë me birra.

Po ti?

Për një kohë të gjatë, mashtruesit e dashurisë i besonin thjesht çdo gjëje që ajo thoshte.

Në fillim ishte argëtuese: të gënjeje një tip pas mesnate.

Ajo zgjaste dorën: *Eja.*

Ishte qesharake në një mënyrë të ligë.

Ndonjëherë ata ngurronin.

Are you serious?

Smiley

Sa hezitonin, sa të pasigurt bëheshin!

Si përplasej diçka në botën e tyre, në rrënojat nga Xhuni Isabela Flok, e cila nuk pinte kartëmonedha, por jetonte në një dhomë pranë Jupiterit, i cili natën rrinte shtrirë në një shtrat përkujdesi. Ky shtrat përkujdesi mjeksor dukej si një shtrat spitali, vetëm se ishte i veshur me një shtresë që duhej të imitonte rimeson e drurit. Gjatë ditës, Jupiteri ulej në një karrocë me rrota. Karroca ishte lyer me bojë të kuqe metalike; e kishte zgjedhur vetë Jupiteri dikur. Tani kishte disa gërvishtje në bojë. Çdo mëngjes ai duhej të ngrihej nga shtrati dhe të kalonte në karrocën me rrota; kjo zgjaste pesë minuta. Jupiteri afrohej te buza e shtratit, me këmbët përpara, lëshonte mbi ndenjëse fillimisht njërën, pastaj tjetrën anë të trupit dhe, ndërkohë, mbërthehej me duar në mbështetëset e krahëve.

"Duhet vetëm ta ngresh pak përpjetë tokën", i kishte thënë njëherë Jupiteri, "nuk është aq e vështirë."

Ndoshta burrat që i shkruanin e meritonin të binin kaq lehtë në grackën e Xhunit. Ashtu siç binin në marrëzitë e tyre gratë që ata mashtronin.

Mos vallë donte të hakmerrej për këto gra? Mbase jo.

Atë nuk e zinte më gjumi natën, kaq ishte e gjitha.

Mashtruesit e dashurisë, në vendet e tyre në zhvillim, nuk dinin absolutisht asgjë për të, përndryshe ndoshta nuk do t'i shkruanin. Asaj, që natën rrinte zgjuar dhe vështronte tavanin.

Hej, grua e bukur, çfarë bën?

Xhuni u përgjigjej shpejt dhe saktë. Si ishte dhe çfarë bënte. Se kishte qenë e martuar dy herë dhe tani mërzitej me një mjek internist.

Se rriste qen luftarakë.

Se i donte qentë – prit, kjo nuk ishte gënjeshtër.

Dikur kishte vënë re se në gënjeshtrat e saj po depërtonin të vërteta të vogla. Diçka që ishte e vërtetë. Kjo më shumë e habiste Xhunin sesa e shqetësonte. Ndonjëherë ndihej mirë të thoshte të vërtetën.

Përshëndetje, bukuroshe!

Si është moti atje tek ti?

Moti është gri dhe i ftohtë, nëntor, muaj i keq.

Dje pashë një film, Melancholia, e ke parë? Një planet përplaset me Tokën, nuk përfundon mirë.

Janë dy motra, Klera dhe Justina. Një herë Justina thotë se është mirë kur bota merr fund, ndërsa Klera mbetet e shtangur.

Si mund të jesh kaq e ftohtë, Justina, o njeri, ne po vdesim këtu, dhe ti thua se nuk ka gjë?

Klera kupton se nuk mund t'i besojë

Xhonit. Xhoni është burri i Klerës, një astronom amator. Xhoni thotë se Melancholia do të kalojë pranë Tokës, mos ki frikë. Xhoni gabon, planeti kthehet, merr kthesë. Paniku i Klerës, qetësia e Justinës pak para përplasjes së planetit, Klera shtrëngon në kopsht djalin e saj pranë vetes, për ta mbrojtur.

Melancholia, a nuk është ky një emër i bukur për një planet të humbur? E dëgjoj shpesh muzikën e filmit kur shëtis. Ndonjëherë mendoj si Justina, një përplasje e tillë me një planet ose kometë, kjo do të ishte ç'do të ishte.

Mashtruesi i dashurisë nuk përgjigjet.

Klera merr nga Xhoni një lak prej teli, me të cilin mund ta mbajë Melancholia-n në kopsht. Melancholia qëndron në qiellin e ndriçuar nga dita si një hënë e madhe. Klera sheh se si ajo, brenda lakut, bëhet gjithnjë e më e vogël; mendon sikur po largohet sërish në hapësirë, është e lumtur. Por një ditë më vonë: Melancholia shfaqet shumë më e madhe se laku. Melancholia ishte kthyer.

Si bien zogjtë përtokë! Breshëri gjëmon në ajër.

Kërcënimi që vjen nga hapësira gjithmonë më trishton shumë, sepse përmasat janë shumë më të mëdha.

Mashtruesi i dashurisë nuk e lexoi mesazhin.

Hej, më shkruaj pak, mirë?

Është bukur t'i shkruaj të gjitha këto.

Mashtruesi i dashurisë nuk e lexoi mesazhin.

Hej, mirëmëngjes, si je?

Mashtruesi i dashurisë nuk iu përgjigj më.

Tjetri, vazhdojmë.

Më pëlqejnë filmat e dashurisë që nuk kanë fund të lumtur, për shembull Open Water, e ke parë? Një çift përfundon në det; kishin prenotuar një udhëtim në det të hapur për t'u zhytur, në varkë ishin disa njerëz, ekuipazhi i numëron gabim, varka kthehet dhe harron t'i marrë. Ata lundrojnë në Paqësor, ai sulmohet nga një peshkaqen. Ajo duhet të jetë e fortë, ta ngushëllojë, por ai vdes në krahët e saj. Ajo merr edhe një herë frymë, pastaj zhytet me kokë poshtë dhe nuk del më në sipërfaqe.

Gjithmonë e kam parë këtë si një histori dashurie të pamëshirshme në vrullin e saj.

Si e shohin njëri-tjetrin, si kapen pas njëri-tjetrit, si mbajnë njëri-tjetrin. Ai e mban atë që të mund të flejë, dhe pikërisht atëherë vjen peshkaqeni.

Më pëlqen konsekuenca dhe fakti që filmi nuk e zbukuron realitetin.

Vetëm kështu bëhet vërtet një film dashurie.

Mashtruesi ishte bërë i parëndësishëm, ndërkohë që ajo shkruante, edhe pse në fillim ai ishte përpjekur të futej në bisedë.

Po, e dashura ime,

dashuria e vërtetë është diçka e mrekullueshme!

zemër e kuqe

Më pëlqen gjithmonë, kur dashuria e vërtetë e tregon të vërtetën e saj vetëm në vdekje.

Të lutem, mos thuaj gjëra të tilla,

e dashura ime!

Por pikërisht gjëra të tilla dua të them.

Është vdekja ajo që në fund na bashkon.

Më vjen mirë që po e ndaj këtë me ty, meqë ra fjala.

Bitch.

Kështu përfundonin gjithmonë bisedat.

Mashtruesit, herët a vonë, nuk përgjigjeshin më, dhe ky i fundit u bë agresiv. Xhuni nuk u zemërua as me të. Edhe ajo fliste pikërisht kështu, me një agresivitet të përmbajtur, kur ishte e sinqertë.

Ndonjëherë i dukej se ky ishte qëndrimi i saj më i sinqertë.

Në bisedat e saj, ndoshta ishte Xhuni e vërtetë.

Fragment nga romani "Hej, mirëmëngjes, si je?"

PSE FLASIM KAQ PAK PËR PËRKTHIMIN E LETËRSISË JOARTISTIKE?

Nga Jola Tasellari

Nga veprimtaritë që ndoqa në kuadër të 30 shtatorit, Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit, më vrau veshët përsëritja e vazhdueshme e togfjalëshit "përkthimi i një vepre letrare". Një përsëritje që risillte jehonën e thirrjes së njohur për ta shpëtuar letërsinë nga përkthimet e dobëta, sikur kokëçarjet e një kulture leximi të mund të zgjidheshin brenda kohëzgjatjes së parashikuar të një takimi. U fol gjerësisht për përkthimin e letërsisë artistike dhe poezisë – *po, po, muzikës së shpirtit në fjalët e Volterit* –, ndërsa filozofia, estetika, historia, biografia dhe veprat studimore mbetën kryesisht jashtë diskursit. Poezia dhe proza e patën bindshëm përfaqësinë e tyre në kuvendin e 30 shtatorit. Letërsia joartistike, me sa duket, jo dhe aq. Përshtypja ime vjen kryekëput nga veprimtaritë që arrita të ndiqja; ajo nuk pretendon të përmbledhë gjithçka që u tha atë ditë. Megjithatë, kjo mungesë më duket e mjaftueshme për të shtruar një shqetësim kulturor: çfarë vendi i japim përkthimit të veprave përmes të cilave formojmë konceptet, ndërtojmë arsyetimin dhe mësojmë të lexojmë vetë letërsinë?



Përmes përkthimit, në shqip mbërrijnë tradita mendimi, nocione që kanë formësuar dijen dhe një fjalor me të cilin përshkruajmë marrëdhëniet shoqërore e ndërtojmë argumentet. Pas çdo libri të tillë është puna e një përkthyesi; dhe në secilin prej tyre kuptimi mund të humbasë, të zhvendoset, madje të marrë një trajtë që as nuk e kishte në origjinal. Në veprat studimore, filozofike, historike, pasaktësia nuk mbetet vetëm në faqe. Ajo mund të kalojë nga shënimet e një studenti në auditor, prej andej në një punim e më pas në ligjërimin publik, ku përsëritja i jep një autoritet që origjinali nuk ia kishte dhënë.

Scripta manent: shkrimet mbeten. Bashkë me to, nëse nuk i dallojmë në kohë, mbeten edhe gabimet në përkthim. Historia e vetë 30 shatorit na ofron një rikujtesë të dobishme. Kjo datë lidhet me Shën Jeronimin, i njohur për punën në përkthimin e Biblës në latinisht dhe i konsideruar shenjti mbrojtës i përkthyesve. Po ta ftonim sot në një tryezë diskutimi, do të duhej t'i linim hapësirë të fliste për doktrinën, konceptet dhe interpretimin. Pyetjet për bukurinë e frazës dhe figuracionin poetik vështirë se do ta shteronin përvojën e tij. Bibla përmbledh poezi, rrëfime, ligje, proverba dhe mësime me karakter fetar; kjo shumësi formash kërkon edhe një shumësi qasjesh në përkthim. Nuk kemi nevojë ta vendosim të gjithën brenda kategorisë moderne *nonfiction* për të kuptuar se tradita me të cilën lidhet 30 shtatori përfshin edhe bartjen e mendimit, të normës dhe të argumentit.

Jeronimi na ka lënë pas një reflektim të drejtpërdrejtë mbi këtë punë. Në letrën e 57-të, drejtuar Pamakiut, ai përdor formulimin *"non verbum e verbo, sed sensum exprimere de sensu"*: të shprehësh kuptimin përmes kuptimit, pa u kufizuar te bartja fjalë për fjalë. Në të njëjtin pasazh bën një përjashtim të posaçëm për Shkrimet e Shenjta, ku, sipas tij, edhe renditja e fjalëve mbart mister. Dallimi është domethënës: vetë përkthyesi që e kujtojmë si figurë mbrojtëse të profesionit e shihte metodën të pandarë në raport me natyrën e tekstit.

Përkufizimi institucional i ditës është po aq i qartë. Rezoluta 71/288 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, e miratuar më 24 maj 2017, shpalli 30 shtatorin Ditën Ndërkombëtare të Përkthimit, duke përmendur shprehimisht veprat letrare, shkencore e teknike, interpretimin dhe terminologjinë. Filozofia, historia apo eseistika e kanë ftesën. Ne na mbetet vetëm t'u bëjmë vend në tavolinë.

Veprimtaritë kulturore mund të zgjedhin fare mirë të përqendrohen te poezia ose romani. Por kur diskutimi zhvillohet në emër të përkthimit në përgjithësi, kufizimi i tyre te letërsia vetëm artistike lënë në hije një pjesë të rëndësishme të punës intelektuale. Përkthimi i veprave studimore rrezikon të përfytyrohet si një veprimtari që kryhet diku në prapaskenë: hapet fjalori, gjendet sinonimi, rregullohet sintaksa, sistemohen citimet dhe libri është gati. Po të mjaftonte kjo procedurë, Dekarti, Niçe, Platoni e Fuko do të na kishin kursyer shumë mundime.

Në ligjërimin e përditshëm, sinonimia mund të shmangë përsëritjen. Në një vepër filozofike, përsëritja mund të jetë pikërisht ajo që mbart kuptimin themelor të frazës. Nëse "vetëdija", "ndërgjegjja" dhe "ndërgjegjësimi" ndërrohen mes tyre vetëm për ta bërë faqen më të larmishme, rrezikojmë që larmia e shprehjes të prodhojë paqëndrueshmëri të mendimit. Kjo nuk nënkupton se çdo term duhet të ketë mekanikisht një sinonimi të vetme. Kjo nënkupton se çdo ndryshim duhet të shoqërohet me një arsye të lexueshme brenda tekstit. Kështu, kur thua *"të thuash gati të njëjtën gjë"*, njohur edhe si titull i veprës së Umberto Ecos – një mjeshtër i vërtet në teoritë e interpretimit dhe të përkthimit - fiton një peshë të veçantë. Sa hapësirë mund t'i lejojmë këtij "gati" kur përkthejmë një koncept filozofik? Çfarë mund të ndryshojë në formë, por që të ruhet e paprekur marrëdhënia e mendimeve? Dhe deri ku e ka kufirin përshtatja përpara se të fillojë të bëhet ndërhyrje?

Në veprat filozofike, studimore e historike, rrjedhshmëria e gjuhës është e domosdoshme, por cilësia kërkon edhe saktësi konceptuale, qëndrueshmëri terminologjike dhe njohje të lëndës. Ka vështirësi që burojnë nga përkthime të dobëta, po aq sa ka edhe vështirësi që burojnë nga vetë ndërlikime të mendimit të autorit. T'i trajtosh njësoj do të thotë të rrezikosh që, bashkë me pengesën gjuhësore, të largosh edhe kompleksitetin me të cilin lexuesi duhet të përballet për të kuptuar betejën në të cilën ka shkuar. Një fjali e përpunuar artistikisht shumë, mund të fshehë një argument të humbur në përpunim. Eleganca është dëshmi e së bukurës, por jo detyrimisht e besnikërisë. Në letërsi ndërthuren këndshëm përvoja estetike dhe historia e ideve, imagjinata dhe kujtesa kulturore, figuracioni dhe koncepti. Një metaforë mund të mbartë një botëkuptim të tërë, një dialog mund të përmbajë një polemikë teologjike, absurdi i një rrëfimi mund të lidhet me pyetje mbi ekzistencën, përgjegjësinë dhe vdekjen. Përkthyesi ka nevojë për mjete që ta dallojë këtë ndërthurje, përpara se t'i japë trajtën që kërkon në gjuhën pritëse.

Edhe receptimi i veprës kushtëzohet nga këto mjete. Një kulturë leximi që njeh më mirë traditat filozofike dhe estetike ka më shumë mundësi të dallojë se çfarë sjell një roman, çfarë rishkruan një poet dhe me cilat ide polemizon një dramaturg. Përkthimet studimore të përgatitura me kujdes ushqejnë edhe punën e përkthyesit letrar, edhe horizontin interpretues të lexuesit. Kritika letrare varet po aq nga qartësia e kësaj gjuhe. Nëse konceptet na mbërrijnë të paqëndrueshme, edhe diskutimi mbi veprat bëhet i paqëndrueshëm. Mund të përdorim të njëjtën fjalë për gjëra të ndryshme, ose fjalë të ndryshme për të njëjtën gjë. Dhe pastaj habitemi pse ligjërimi kulturor prodhon kaq shumë fjali dhe bën kaq pak sens. Prandaj edhe mungesa e zërit të përkthyesve të letërsisë *non-fiction* më shqetëson edhe si mungesë brenda kulturës letrare. Përkthimi i tyre zgjeron mundësitë e shprehjes të shqipes, ushqen kritikën dhe krijon burime për një lexim më të vëmendshëm të poezisë e prozës. Këto fusha zhvillohen në marrëdhënie me njëra-tjetrën.

Në Ditën e Përkthimit do të doja të dëgjoja edhe për udhëtimin e një koncepti nga një gjuhë në tjetrën: si merr trajtë në shqip një nocion filozofik, si bartet një kategori historike, ç'ndodh me një term estetik kur hyn në një traditë tjetër mendimi. Do të doja të dëgjoja për argumentin që e ka detyruar përkthyesin t'i kthehet një kapitulli të tërë, e për redaktorin që ka dalluar, pas shumë leximesh, se fjalia më elegante ishte larguar tërësisht nga kuptimi i origjinalit. Çfarë ruhet në këto kalime, çfarë ndryshon dhe çfarë kërkon nga shqipja një mendim i lindur në një gjuhë tjetër?

Dekarti dhe bashkudhëtarët e tij mund të na presin, patjetër që munden. Kanë pritur disa shekuj. Lexuesi shqiptar ka arsyet e veta për të qenë pak më i paduruar.

INTERNATIONAL YOUTH LITERARY FESTIVAL

TIRANA GATE 2026

12th edition 7 - 8 - 9 October

When Silence Speaks: Literature That Crosses Borders, Challenges Narratives, and Restores Excluded Voices

FESTIVALI LETRAR NDËRKOMBËTAR PËR TË RINJ

TIRANA GATE 2026

edicioni i 12të 7 - 8 - 9 tetor

Kur flet heshtja: Letërsia që tejkalon kufijtë, sfidon narrativat dhe rikthen zërat e përjashtuar

VILA 31 ART EXPLORA

Organizator

ILP INSTITUTI I LIBRIT DHE I PROMOCIONIT

Mbështetës

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

MINISTRIA E ARSIMIT

BASHKIA TIRANE

BOTIMET TOENA

EMBASSY OF GREECE IN ALBANIA

GreekLit.

BIBLIOTEKA KOMBËTARE

traduki

EUROPEAN UNION PRIZE FOR LITERATURE

YUNUS EMRE ENSTITUSU

ExLibris

rtsh

ama Il mio amato caffè